



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e Ushtruar në Autoritetin Rrugor Shqiptar

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI
MBI PËRPUTHSHMËRINË
NË
AUTORITETIN RRUGOR SHQIPTAR

KORRIK 2023

Përmbajtja	faqe
I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3
1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit	3
2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	3
3. Konkluzioni dhe Opinioni i auditimit	12
II. HYRJA	14
1. Objekti i auditimit	14
2. Qëllimi i auditimit	14
3. Identifikimi i çështjes:	15
4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese:	15
5. Përgjegjësitë e Audituesve:	15
6. Kriteret e vlerësimit.....	15
7. Standardet e auditimit.....	16
8. Metodot e auditimit	17
9. Dokumentimi i auditimit	17
III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	18
1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM MBI SUBJEKTIN NËN AUDITIM.....	18
2. PËRSHKRIMI I REZULTATEVE SIPAS DREJTIMEVE TË AUDITIMIT	18
2.1 Mbi zbatimin e ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e strukturave drejtuese (Bordi i Menaxhimit dhe Drejtori i Përgjithshëm), vendimet e marra dhe zbatimi i tyre	18
2.2 Mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit	23
2.3 Organizimi dhe mbajtja e kontabilitetit:.....	27
2.3.1 <i>Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve të kryera nëpërmjet arkës, bankës në lekë dhe në valutë, blerjet e vogla për periudhën objekt auditimi</i>	27
2.3.2 <i>Nxjerrja e bilancit kontabël në afat, plotësimi i pasqyrave financiare sipas udhëzimeve të Ministrisë së Financave.</i>	31
2.3.3 <i>Mbi administrimin e pronës shtetërore dhe zbatimi i dispozitave për dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare</i>	31
2.4 Mbi organizimin e strukturës organizative, dhënien e pagave dhe shpërblimeve në përputhje me dispozitat ligjore. Zbatimi i ligjshmërisë gjatë procesit të rekrutimit dhe largimit të punonjësve nga puna.	37
2.5 Mbi zbatimin e ligjshmërisë në prokurimet e fondeve publike dhe ankandet, lidhjen dhe zbatimin e kontratave.	39
- <i>Vlerësimi i kërkesave dhe nevojave për punë, mallra dhe shërbime;</i>	39
- <i>Argumentimi dhe përlllogaritja e fondit limit sipas nevojave konkrete për punë, mallra e shërbime;</i>	39
- <i>Analizimi dhe vlerësimi i zbatimit të procedurave të prokurimit nga momenti i nxjerrjes së urdhrin të prokurimit deri në lidhjen e kontratës;</i>	39
2.6 Mbi zbatimin e ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e sistemit të MFK si dhe auditit të brendshëm	64
IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET	68
V. ANEKSE	Error! Bookmark not defined.

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

KLSH në periudhën nga data 23.01.2023 deri më datë 12.05.2023 kreu auditimin mbi përputhshmërinë e veprimtarisë ekonomike dhe financiare të Autoritetit Rrugor Shqiptar për periudhën nga data 01.10.2020 deri në 31.12.2022, duke u përqendruar në auditimin e ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e strukturave drejtuese (Bordi i Menaxhimit dhe Drejtori i Përgjithshëm), vendimet e marra dhe zbatimi i tyre, hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit, organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit, organizimin e strukturës organizative, dhënien e pagave dhe shpërblimeve në përputhje me dispozitat ligjore. Zbatimi i ligjshmërisë gjatë procesit të rekrutimit dhe largimit të punonjësve nga puna, ligjshmërinë në prokurimet e fondeve publike dhe ankandet, lidhjen dhe zbatimin e kontratave si dhe zbatimin e ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e sistemit të MFK si dhe auditit të brendshëm.

Grupi i Auditimit të KLSH shqyrtoi, analizoi dhe arriti në konkluzione mbi secilën prej drejtimeve të Auditimit, në bazë të dokumentacionit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion, me zgjedhje, për të arritur në një siguri të arsyeshme në dhënien e opinionit të auditimit.

Gjatë gjithë procedurës së këtij auditimi, janë mbajtur në konsideratë Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI), Manuali i auditimit të përputhshmërisë të KLSH, Rregullorja funksionimit organizativ dhe administrativ të KLSH, Rregullorja e procedurave të auditimit, Kodi i etikës, si dhe praktikat më të mira audituese të fushës.

Në arritjen e konkluzioneve dhe përfundimeve mbi përputhshmërinë e veprimtarisë ekonomike dhe financiare me kuadrin ligjor dhe rregullator përkatës, krahas njohjes së detajuar të tyre të cilat kanë shërbyer si burim i kriterëve të auditimit, ne kemi përdorur metoda dhe teknika efikase si verifikimi i transaksioneve, intervistimi, raporte dhe informacione, verifikime në terren etj.

Gjetjet e këtij auditimi të karakterit organizativ i janë nënshtruar skepticizmit profesional dhe gjykimit objektiv të audituesve, duke i dhënë mundësi KLSH në dhënien e rekomandimeve përkatëse për përmirësimin e gjendjes si dhe për të evidentuar përgjegjësitë nëpërmjet rekomandimit të masave disiplinore.

Bazuar në rezultatet e auditimit të kryer në Autoritetin Rrugor Shqiptar (ARRSH) për periudhën 01.10.2020 – 31.12.2022, grupi i auditimit me një siguri të arsyeshme ka dhënë **opinion të kualifikuar mbi përputhshmërinë** e veprimtarisë ekonomike dhe financiare.

Për gjetjet e konstatuara janë mbajtur 22 akte, të cilat tyre janë dorëzuar në protokollin e subjektit të audituar brenda afateve.

2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve

NR.	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA NË RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
1	Anëtarët e Bordit të Menaxhimit janë emëruar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 28, datë 17.01.2018 “Për emërimin e anëtarëve të bordit të menaxhimit të Autoritetit Shqiptar Rrugor”. Nëpërmjet Vendimit nr. 350, datë 16.06.2021, Këshilli i Ministrave vendosi përfundimin e mandatit të z. E. H. dhe nëpërmjet Vendimit nr. 455, datë 29.06.2022, vendosi zëvendësimin e tij me z. E. Ll.. Si rrjedhojë, për një vit, qershor 2021-qershor 2022, Bordi ka funksionuar me gjashtë anëtarë.	18 – 22	E lartë	Kryetari i Bordit, nëpërmjet sekretariatit/sekretarit të bordit, të tregojë kujdes maksimal në mënyrë që në asnjë rast në vazhdim, Bordi të mos ushtrojë funksionimin e tij pa numër të plotë të anëtarëve, sikurse e përcakton ligji nr. 10164, datë 15.10.2009 “Për Autoritetin Rrugor Shqiptar”.
2	Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me	23 – 26	E lartë	- Nga ana e Drejtorit

	<p>buxhetin rezultojnë shpenzime publike të paplanifikuara në fillim të vitit dhe jashtë vitit buxhetor për të cilin janë parashikuar. Konkretisht, procedura e hapur e thjeshtuar e prokurimit me numër REF-98245-06-16- 2021 me objekt <i>“Për mirëmbajtjen rutinë me performancë e segmentit rrugor Kryqëzim Qafa e Buallit-Fillim Rruga e Arbërit, me gjatësi 4.5 km”</i> është kryer si rrjedhim i riallokimit të buxhetit të vitit 2021 për të cilën është lidhur kontrata nr. 5807 prot., datë 30.07.2021 në vlerën totale 744,000 lekë me TVSH, për periudhën 01.08.2021-31.12.2021. Segmenti rrugor i sipërcituar ka qenë i përfshirë në projektin e Bankës Botërore <i>“Mirëmbajtje dhe siguri rrugore bazuar në rezultate”</i> deri në tetor të vitit 2020. Po për të njëjtin objekt prokurimi, me urdhrin e prokurimit nr. 328 prot., datë 17.12.2021 dhe fond limit në vlerën prej 673,069.⁵⁰ lekë pa TVSH, është kryer procedura me vlerë të vogël në datën 21.12.2021 për mirëmbaje për periudhën 01.01.2022-31.03.2022. Për këtë procedurë është lidhur kontrata nr. 11476/2 prot., datë 30.12.2021, pa mbaruar kontrata e mëparshme për të njëjtin objekt prokurimi. Me shkresën nr. 9295/1 prot., datë 15.10.2021 është miratuar riallokimi i fondit prej 161,600 lekë, ose afërsisht 20 % nga kontrata e sipërcituar. Nga sa më sipër rezultojnë se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - është vepruar në kundërshtim me VKM nr. 285 datë 19.05.2021 RrPP, neni 106 pika 1 dhe 2, e ndryshuar, pasi procedura e prokurimit në vlerë të vogël duhet të jetë bazuar në fondin e vitit buxhetor 2021; - nuk është respektuar e drejta për të kryer shpenzime brenda kufirit të fondeve të miratuara, e cila skadon ditën e fundit të vitit buxhetor, pavarësisht nëse kontrata njëvjeçare ose shumëvjeçare mund të vazhdojë edhe në vitin buxhetor pasardhës; - angazhimi i ri buxhetor (nënshkrimi i kontratës) për kontratën e dytë është kryer më vonë se data 15 Tetor e vitit buxhetor 2021, pra përtej afateve që parashikon udhëzimi nr. 9, datë 20.03.2018 i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë <i>“Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”</i>, pikat 41, 69, 71, 79, 83. - stafi i ARRSH nuk është plotësisht i qartë dhe i informuar për të drejtat dhe detyrimet gjatë zbatimit të buxhetit dhe nëpunësi i autorizuar nuk provon se ka deleguar rregullat dhe procedura të miratuara në bordin e ARRSH për përgjegjësitë individuale gjatë zbatimit të buxhetit. 			<p>të Përgjithshëm të ARRSH, në cilësinë e nëpunësit të autorizuar të merren të gjitha masat e nevojshme për analizën e nevojave të domosdoshme dhe planifikimin në kohën e duhur të shpenzimeve publike, me qëllim realizimin e shpenzimeve me eficiencën e duhur.</p> <p>- Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të ARRSH, në cilësinë e nëpunësit të autorizuar të merren të gjitha masat e nevojshme për hartimin, miratimin në bord dhe delegimin e rregullave specifike dhe procedurave që duhet të ndiqen në procesin e zbatimit të buxhetit, me qëllim që çdo individ të jetë i qartë dhe i informuar plotësisht mbi përgjegjësitë e tij.</p>
3	<p>Në 4 raste, operatorët ekonomikë fitues rezultojnë me oferta me vlerë më të ulët nga oferta e paraqitur gjatë verifikimit në treg për vlerësimin e fondit limit. Ofertat e mësipërme janë prezantuar me vlera të ndryshme për të njëjtin objekt prokurimi dhe praktikisht në të njëjtën kohë, si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Procedura e prokurimit me objekt <i>“Blerje materiale pastrimi”</i> me numrin e referencës REF-89466-09-03-2021 dhe fond limit në vlerën prej 407,633 lekë pa TVSH. Në SPE, në datën 10.03.2021, është shpallur oferta fituese, operatori M. V. në vlerën prej 338,300 lekë pa TVSH. Në procesverbalin e llogaritjes së fondit limit nr. 2199/2 prot, datë 08.03.2021, operatori M. V. është prezantuar me ofertën në vlerën prej 403,375 lekë pa TVSH. - Procedura e prokurimit me objekt <i>“Blerje goma për automjete”</i> me numrin e referencës REF-00769-12-07-2021 dhe fond limit në vlerën prej 625,000 lekë pa TVSH. Në SPE, në datën 14.07.2021, është shpallur oferta fituese, OE P... I... SHPK në vlerën prej 459,000 lekë pa TVSH. Në procesverbalin e llogaritjes së fondit limit nr. 6197/1 prot, datë 09.07.2021 OE P... I... SHPK është prezantuar me ofertën në vlerën prej 590,000 lekë pa TVSH. - Procedura e prokurimit me objekt <i>“Blerje tonera dhe dramer të ndryshme”</i> me numrin e referencës REF-13778-02-12-2021 dhe fond limit në vlerën prej 296,340.3 lekë pa TVSH. Në SPE, në datën 03.12.2021 është shpallur oferta fituese, OE “S... C...” SHPK në vlerën prej 293,980 lekë pa TVSH. Në procesverbalin e llogaritjes së fondit limit nr. 9855/2 prot, datë 02.12.2021, OE “S... C...” SHPK është prezantuar me ofertën në vlerën prej 289,112 lekë pa TVSH. 	27 – 36	E lartë	<p>Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të sigurohet që proceset e prokurimeve të përfshihen në një manual për prokurimin, me qëllim identifikimin e përgjegjësiave individuale, dokumentacionin përkatës të miratuar për hapat e procesit, vendimmarrjen individuale, të drejtat dhe detyrimet, që duhet të ushtrohen gjatë zbatimit të këtyre procedurave me qëllim orientimin e komisioneve me dispozitat e aplikueshme në kuadrin ligjor dhe rregullator.</p>

	<p>- Procedura e prokurimit me objekt "Blerje goma për automjetet" është kryer në zbatim të Urdhrit të Prokurimit nr. 265 datë 03.11.2022 dhe fond limit në vlerën prej 998,933.3 lekë pa TVSH.</p> <p>Në SPE, në datën 04.11.2022 është shpallur oferta fituese, OE "A... T..." SHPK në vlerën prej 719,000 lekë pa TVSH.</p> <p>Në procesverbalin e llogaritjes së fondit limit nr.9026/1, datë 26.10.2022, OE A... T... SHPK është prezantuar me ofertën në vlerën prej 1,016,800 lekë pa TVSH.</p> <p>Në zbatim të pikave 1 dhe 3 të Udhëzimit Nr.11 datë 30.05.2018 të Agjencisë Prokurimit Publik, komisioni i prokurimit në vlerë të vogël, ka detyrimin të krahasojë ofertat e paraqitura nga OE^{ke} në sistemin elektronik të prokurimeve me fondin limit të përcaktuar më parë me qëllim që oferta e OE të jetë sa më reale.</p> <p>Për arsye që, fondi limit të jetë një bazë krahasuese reale, ky fond llogaritet përpara urdhrit të prokurimit dhe i shërben vetëm komisionit të prokurimit.</p> <p>Ofertat e operatorëve fitues, nga dekurimi në sistemin elektronik, kanë rezultuar në një vlerë më të ulët se ofertat që ata kanë depozituar për llogaritjen e fondit limit, praktika e së cilës është vënë në dispozicion të komisionit të prokurimeve.</p> <p>Pranimi nga ana e komisionit të prokurimeve, të ofertave të operatorëve fitues në SPE, ka sjellë deformimin e procesit të krahasimit të këtyre ofertave me fondin limit, për arsye se këta ofertues kanë ndryshuar praktikisht në të njëjtën kohë të njëjtën ofertë në një vlerë më të ulët.</p> <p>Veprimet e mësipërme të komisionit të prokurimeve të vogla bien në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, neni 63 pika 3, i ndryshuar, dhe në kundërshtim me, VKM nr. 285, datë 19.05.2021, neni 13 pika 4, neni 79 pika 4.</p> <p>Ekzistenca 2 ofertave të sipërcituara për OE^{et} fitues, për të njëjtën objekt prokurimi dhe praktikisht në të njëjtën kohë, ka sjellë si pasojë deformimin e vlerësimit dhe të konkurrencës gjatë kryerjes së procedurës të prokurimit.</p>			
4	<p>Autoriteti Kontraktor (ARRSH) në momentin e hartimit të regjistrave të parashikimit, për përcaktimin e procedurës së blerjes në vlerë të vogël nuk ka marrë parasysh grupin e mallrave apo shërbimeve të ngjashme, sipas natyrës, sasisë dhe llojit të kontratës, të cilat kanë të njëjtin funksion kryesor apo kanë të njëjtin emërtim në planin e shpenzimeve.</p> <p>Në 6 raste, gjatë hartimit të regjistrave të parashikimeve në prokurime është evidentuar shmangie nga procedurat përkatëse të prokurimit, duke shkaktuar copëzimin e fondeve apo të kontratave si më poshtë:</p> <p>-Procedura me objekt prokurimi "Blerje tonera dhe drame të ndryshëm" - tonera për makina fotokopjuese, me fond limit në vlerën prej 800,000 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 23.04.2021 dhe realizuar në vlerën prej 699,000 lekë pa TVSH.</p> <p>Procedura me objekt prokurimi "Blerje tonera dhe drame të ndryshëm" - tonera për printer dhe fax, me fond limit në vlerën prej 361,200 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 03.12.2021 dhe realizuar në vlerën prej 293,980 lekë pa TVSH.</p> <p>Të dy procedurat e ngjashme të sipërcituara, gjatë planifikimit rezultojnë së bashku në vlerën 1,161,200 lekë, duke tejkaluar në këtë mënyrë me 161,200 lekë pragun e procedurës së prokurimit në vlerë të vogël.</p> <p>-Procedura me objekt prokurimi "Shpenzime për mirëmbajtjen e objekteve ndërtimore (lyerje ambientesh dhe zyrash, riparime hidraulike etj.)" me fond limit 800,000 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 12.04.2021 dhe realizuar në vlerën 276,525 lekë pa TVSH.</p> <p>-Procedura me objekt prokurimi "Shpenzime për mirëmbajtjen e zyrave të laboratorit të ARRSH (lyerje ambientesh dhe zyrash, riparime hidraulike, elektrike pllakash etj.)" me fond limit në vlerën prej 1,000,000 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 16.07.2021 dhe realizuar në vlerën 780,000 lekë pa TVSH.</p> <p>Të dy procedurat e ngjashme të sipërcituara, gjatë planifikimit rezultojnë së bashku në vlerën 1,800,000 lekë,</p>	27 – 36	E lartë	<p>Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Përputhshmërisë së Standardeve si dhe Përgjegjësi i Sektorit të Prokurimeve, të merren masat e nevojshme, që në procesin e hartimit të regjistrave të parashikimeve të prokurimeve të përfshihen linja të qarta bashkëpunimi, raportimi dhe përgjegjësi të përcaktuara, me qëllim që të shmangët kufizimi i procedurave konkurruese të prokurimit dhe copëzimi i fondeve publike.</p>

	<p>duke tejkaluar në këtë mënyrë me 800,000 lekë pragun e procedurës së prokurimit në vlerë të vogël.</p> <p>-Procedura me objekt prokurimi “Shpenzime për blerje Software Autocad” me fond limit 1,000,000 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 06.12.2022 dhe realizuar në vlerën 959,000 lekë pa TVSH.</p> <p>-Procedura me objekt prokurimi “Shpenzime për mirëmbajtjen e pajisjeve kompjuterike dhe elektronike” me fond limit në vlerën prej 1,000,000 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 13.10.2022 dhe realizuar në vlerën 915,600 lekë pa TVSH.</p> <p>Të dy procedurat e ngjashme të sipërcituara, gjatë planifikimit rezultojnë së bashku në vlerën 2,000,000 lekë, duke tejkaluar në këtë mënyrë me 1,000,000 lekë pragun e procedurës së prokurimit në vlerë të vogël.</p> <p>Nga auditimi, rezultojnë se janë emëruar personat përgjegjës për prokurimin për hartimin e regjistrave të prokurimit, megjithatë mungojnë linja të qarta raportimi, përfshirje e aktorëve të domosdoshëm, vendimmarrje dhe përgjegjësi të përcaktuara. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me Udhëzimin nr. 03, datë 08.01.2018, pikat 3, 4, me Udhëzimin nr. 05, datë 25.06.2021, pikën 3, në kundërshtim me Vendimin nr. 285 datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, nenin 56, pika 2 dhe 11, duke shkaktuar copëzimin e fondeve apo kontratave, për pasojë kufizimin e procedurave konkurruese të prokurimit.</p>			
5	<p>Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se Regjistri i Aktiveve të ARRSH, përfshihen: tag numri, emërtimi, njësia matëse/targa e mjetit, çmimi, gjendja në fund të vitit paraardhës (31.12.2021) e shprehur në sasi dhe vlefë, fletë hyrje dhe fletë dalje (numër, datë, sasia, dhe vlefë), si dhe gjendja në fund të vitit korrent (31.12.2022). Pra në këtë regjistër nuk paraqiten të dhëna lidhur me vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.</p>	27 – 36	E lartë	Nga Sektori i Financës të përditësohet Regjistri i Aktiveve, pasi të jenë kryer vlerësimet lidhur me vlerën e mbetur dhe jetën e dobishme të aktiveve me vlera materiale të cilat ndikojnë në rezultatin financiar.
6	<p>Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se lidhur me shitjen e skrapit janë realizuar dy procedura ankandi, të cilat janë anuluar, si më poshtë:</p> <p>Ankandi 1: -Me procesverbalin e hapjes të ankandit nr. 2, datë 23.06.2021 ka rezultuar se nuk është paraqitur asnjë ofertues.</p> <p>-Me shkresën nr. 4579/5 prot, datë 28.06.2021 “Raport përmbledhës për procedurën e ankandit publik me objekt ‘Automjete dhe makineri të tjetërsuara skrap, të Autoritetit Rrugor Shqiptar dhe Drejtorive Rajonale Tiranë, Gjirokastër, Shkodër”, drejtuar Titullarit të Autoritetit Shitës z. E. B., nga komisioni i sipër përmendur, është propozuar ndërprerja e kësaj procedure ankandi.</p> <p>-Me Urdhrin e Titullarit të ARRSH nr. 4579/6 prot, datë 28.06.2021 është anuluar procedura e ankandit.</p> <p>-Me shkresën nr. 4579/7 prot, datë 28.06.2021 është njoftuar Agjencia e Prokurimit Publik lidhur me anulimin e procedurës.</p> <p>Ankandi 2: Me procesverbalin nr. 2, datë 09.09.2021 “Hapja e ankandit publik” ka rezultuar se nuk është paraqitur asnjë ofertues.</p> <p>- Me shkresën nr. 7015/3 prot, datë 16.09.2021 “Raport përmbledhës për procedurën e ankandit publik me objekt ‘Automjete dhe makineri të tjetërsuara skrap, të Autoritetit Rrugor Shqiptar dhe Drejtorive Rajonale Tiranë, Gjirokastër, Shkodër”, drejtuar Titullarit të Autoritetit Shitës z. E. B., nga komisioni i sipër përmendur, është propozuar ndërprerja e kësaj procedure ankandi.</p> <p>-Me Urdhrin e Titullarit të ARRSH nr. 7015/4 prot, datë 27.09.2021 është anuluar procedura e ankandit.</p> <p>-Me shkresën nr. 7015/6 prot, datë 29.09.2021 është njoftuar Agjencia e Prokurimit Publik lidhur me anulimin e procedurës.</p> <p>Nga kjo periudhë e në vazhdim rezulton se nga ana e ARRSH nuk janë marrë masa lidhur me kryerjen e mëtejshme të procedurave të ankandit, në mënyrë që të</p>	27 – 36	E lartë	Sektori i Financës dhe Sektori Juridik të marrin masa lidhur me realizimin e procedurës së ankandit lidhur me shitjen e skrapit dhe ndjekjen me përgjegjshmëri të hapave lidhur me plotësimin e dokumentacionit përkatës.

	realizohet shitja e skrapit.			
7	Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se nuk janë evidentuar në kontabilitet “Rrugët dhe rrjetet rrugore”. Për pasojë, nuk ka një vlerë të saktë dhe të drejtë të zërave të mësipërm dhe vlerës së konsoliduar në pasqyrat financiare të shtetit. Deri në fund të vitit 2021 mungon një inventar i plotë e i azhurnuar i rrjetit rrugor, me të dhëna për gjatësinë e rrugëve të përfunduara dhe të kolauduara (me të dhëna të plota mbi gjatësitë, kategoritë e rrugës dhe vlerën kontabël respektive që referuar planit duhej të pasqyroheshin në analiza të veçanta sipas ndarjes së përcaktuar në “Kodin Rrugor Shqiptar”), të analizuar në llogarinë 213 “Rrugë, rrjete dhe vepra ujore”.	27 – 36	E lartë	Drejtori i Përgjithshëm, Sektori i Financës dhe Sektori Juridik të marrin masa lidhur me realizimin e inventarizimit dhe plotësimit të regjistrit të rrugëve dhe rrjeteve rrugore.
8	Autoriteti Rrugor Shqiptar, në cilësinë e subjektit në favor të së cilit bëhet shpronësimi ka paraqitur pranë Agjencisë Shtetërore për Shpronësim kërkesat për shpronësim të cilat janë finalizuar duke u miratuar me Vendime të Këshillit të Ministrave në vlerën 3,312,523,392 lekë, nga të cilat rezultojnë të jenë shlyer 39 % e kësaj vlere. Diferenca e mbetur e mos likuidimit është për shkak se pronarët e pasurive të shpronësuara nuk kanë depozituar pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar dokumentacioni ligjor për likuidim.	27 – 36	E lartë	Nga Sektorit i Financës dhe Sektori i Sigurimit të Tokës të merret në analizë situata e mos likuidimit të pronarëve të pasurive të shpronësuara, si dhe të merren masa lidhur me likuidimin e tyre.
9	Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion për periudhën objekt auditimi, duke ju referuar vendimeve të Gjykatave, ARRSH rezultojnë të jetë palë debitore në 18 raste me subjekte të ndryshme në vlerën 373,116,044 lekë . Në dy nga këto raste, nga ana e debitorëve është vendosur urdhër sekuestro në llogaritë e Thesarit me vlerën 41,942,661 lekë. Sa më sipër, situata e krijuar lidhur me detyrimet ndaj palëve të treta dhe urdhër sekuestrot e llogarive të Thesarit, rrezikojnë performancën e ARRSH, përmeshjen e funksioneve primare, pagesën e punonjësve e të detyrimeve të tjera, në kushtet e bllokimeve të vazhdueshme të llogarive të saj, gjë e cila mund të rezultojë në pezullim të detyrimeve operacionale.	27 – 36	E lartë	Drejtori i Përgjithshëm dhe Sektori i Financës të analizojnë efektin financiar negativ me vlerë 373,116,044 lekë , shkakët të cilat kanë sjellë këtë situatë dhe të marrin masa lidhur me likuidimin e këtyre detyrimeve, të cilat sjellin si pasojë sekuestrim të llogarive thesarit të ARRSH.
	Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me rekrutimet e punonjësve rezultojnë se: - Për mënyrën e përzgjedhjes së kandidatëve për punë nga Burimet Njerëzore gjatë periudhës objekt auditimi, janë rekrutuar 24 punonjës, nga të cilët në 15 raste është shpallur vakanca e vendit të punës në faqen web dhe janë kryer procedurat e rekrutimit, pra në 62,5 % të tyre. - Nga auditimi rezultojnë se konstatohet se në asnjë rast nuk ka patur konkurrencë, pra ka patur vetëm një kandidat për çdo pozicion pune. - Gjatë periudhës objekt auditimi në total janë dhënë 39 masa disiplinore, nga këto 28 “Vërejtje”, 4 masa “Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna”, 1 masë “Kalim në një detyrë të një niveli apo klase më të ulët” dhe 6 masa “Pushim nga puna”. Nga auditimi i procedurës së dhënies së masave disiplinore konstatohet se nuk ka procedura transparente, pasi nuk ka të dhëna lidhur me mënyrën e marrjes të këtyre masave dhe nuk ka komision apelimi.	37 – 38	E lartë	- Nga Drejtori i Përgjithshëm dhe Sektori i Burimeve Njerëzore, të merren masa për ndjekjen me përgjegjësi të procedurave të rekrutimit të punonjësve të rinj, dhe hartimi dhe miratimi i rregulloreve për emërimin dhe procedurat e lëvizjeve të stafit të ARRSH. - Nga Drejtori i Përgjithshëm dhe Sektori i Burimeve Njerëzore, të merren masa për ndjekjen me përgjegjësi dhe transparencë të procedurave të dhënies së masave disiplinore, si dhe ngritjen e komisionit përkatës të apelimit.
	Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet se procedura e largimeve nga puna është e parregullt, konstatim ky i cili mbështetet edhe nga argumentimi si më poshtë. Konkretisht rezultojnë se në proceset gjyqësore në të cilat ARRSH është palë, për periudhën objekt auditimi janë në proces 7 çështje gjyqësorë Gjykatën e Shkallës të Parë	37 – 38	E lartë	Nga Drejtori i Përgjithshëm, Drejtorja Juridike dhe Përputhshmërisë së Standardeve dhe Sektori i Burimeve

	<p>Tiranë dhe në Gjykatën e Apelit Tiranë, ku 4 çështje janë humbur dhe 3 janë në proces. Për periudhën objekt auditimi, lidhur me këto procese ARRSH ka paguar ish – punonjësit e saj në vlerë prej 3,233,034 lekë si dëmshpërblim për ndërprerje të paligjshme të marrëdhënieve të punës dhe shpenzime përmbarimore, duke shkaktuar kështu efekt financiar negativ.</p>			<p>Njerëzore të Autoritetit Rrugor Shqiptar, të merren masa për analizimin e efektit negativ në vlerën 3,233,034 lekë dhe për ndjekjen me përgjegjësi të procedurave të shkëputjes të marrëdhënieve të punës me punonjësit e saj, dhe të procedurave gjyqësore për dëmshpërblimet që mund të vijnë si rezultat i zgjidhjes së kontratës së punësimit pa shkaqe të arsyeshme, humbje të cilat janë në vlera të konsiderueshme për ARRSH.</p>
	<p>Sipas DT rezultojnë se kriteri i përzgjedhjes së fituesit është përcaktuar oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto duke përdorur sistemin me pikë. Në fakt, referuar nenit 87 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, pika 4 citohet se: “Kriteret për shpalljen e kontratës fituese nuk i japin autoritetit ose entit kontraktor një liri të pakufizuar zgjedhjeje. Ato garantojnë mundësinë e konkurrencës efektive dhe shoqërohen nga specifikime, të cilat lejojnë që informacionet e dhëna nga ofertuesit të verifikohen për të vlerësuar nëse ofertat përmbushin kriteret për shpalljen e kontratës fituese ...”. Gjithashtu, referuar VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 45 Kriteret për shpalljen e ofertës fituese, pika 3 citohet se: “Për punët/mallrat/shërbimet, që kanë specifikime të thjeshta, standarde teknike të mirënjohura dhe janë lehtësisht të gjendura në treg, oferta ekonomikisht më e favorshme bazohet në çmimin si i vetmi element i ndryshueshëm ndërmjet ofertave”.</p> <p>Përzgjedhja e metodës bazuar në kosto nuk është në përputhje me parimet kryesore të Ligjit të Prokurimit Publik.</p> <p>Kjo do të thotë se nga ana e AK do të duhet të ishin përcaktuar vetëm kriteret e veçanta të kualifikimit dhe oferta ekonomikisht më e favorshme të përzgjidhet në bazë të çmimit dhe jo të koston pasi punimet e ndërtimit janë me standarde të njohura kombëtare e ndërkombëtare e përveç çmimit OE pjesëmarrës, praktikisht nuk kanë se me çfarë të konkurrojnë tjetër.</p>	39 – 64	E lartë	<p>Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të ARRSH të merren masa të menjëhershme për rishikimin në procedurat e prokurimeve të zhvilluara nga ana e ARRSH, përfshirë ato në proces, të kriterit të vlerësimit të ofertës fituese me pikë si më sipër pasi kjo metodë nuk rrit efikasitetin dhe procedurave, nuk arrin të sigurojë mirë përdorim të fondeve publike dhe ulje të shpenzimeve procedurale, nuk nxit pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë, nuk nxit konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë dhe si e tillë krijon kushte për përdorim pa EEE të fondeve publike.</p>
	<p>Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me procedurat e prokurimit të zhvilluara rezultojnë se janë vendosur kriteret të paargumentuara teknikisht dhe ligjërishit për sa i takon numrit të punonjësve të kërkuar, numrit dhe kualifikimeve të stafit kryesor teknik dhe atij mbështetës si dhe numrit dhe kapacitetit të mjeteve në disa raste. Konkretisht janë vendosur kriteret si më poshtë:</p> <p>Kriteri: “Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë fuqi punëtore minimalisht ... persona.”</p> <p>NJP në këtë rast, përveçse ka cituar bazën ligjore (nenin 77, pika 4 të Ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”) është shprehur ndër të tjera se: “Numri i punonjësve është përcaktuar bazuar në afatin, orët e punës dhe pagën minimale të lejuar, që duhen për të përmbushur zbatimin e kontratës ...”</p> <p>Në fakt, sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, konkretisht procesverbaleve të argumentimit të kriterëve rezultojnë se nuk ka ndonjë llogaritje analitike në raport me</p>	39 – 64	E lartë	<p>Nga ana e ARRSH të merren masa për vendosjen në procedurat e prokurimit të kriterëve të argumentuara teknikisht dhe ligjërishit si dhe në raport me nevojat e investimit me qëllim përdorimin e fondeve me efektivitete, efikasitet dhe ekonomikitet.</p>

<p>grafikun e punimeve, kapacitet e mjeteve si dhe normativat përkatëse se prej nga ka rezultuar një numër të punësuarish në lidhje me këtë kontratë pavarësisht faktit nëse ky numër mund të jetë ose jo i mjaftueshëm.</p> <p>Kriteri: “Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, si më poshtë: ..</p> <p>Kriteri: “Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe stafin mbështetës (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë: ...</p> <p>Konstatohet se argumentimi i bërë për stafin në cilësinë e drejtuesit teknik është i njëjtë me atë të dhënë edhe për stafin mbështetës (copy – paste) dhe gjithashtu nuk është e argumentuar kërkesa për diferencimin mes stafit të kërkuar si pjesë e licencës së shoqërisë dhe atyre si staf mbështetës me kontratë, jo domosdoshmërisht në licencën e shoqërisë.</p> <p>Kriteri: “Operatoret ekonomike duhet te paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ...</p> <p>Në fakt, referuar preventivit dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion nuk rezulton i argumentuar teknikisht në çdo rast domosdoshmëria e disponimit të niveleve të kërkuara të kategorive të licencave.</p> <p>Kriteri: “Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:</p> <p>Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, konkretisht procesverbaleve të argumentimit të kriterëve rezulton se nuk ka një sqarim konkret për të argumentuar numrin llojin dhe kapacitetet e mjeteve të vendosura.</p> <p>Kriteri: “Operatori ekonomik duhet të disponojë programin “PLS CADD and TOWER”, për projektimin e linjave elektrike.</p> <p>Në lidhje me këtë kriter NJP nuk ka argumentuar domosdoshmërinë që lidhet me disponimin e këtij programi pasi programi i kërkuar është një software i cili, sipas citimit të bërë nga ana e NJP, është për projektimin e linjave elektrike, kur kontrata në fjalë është e llojit Punë.</p> <p>Kriteri: “Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:</p> <p>Kriteri: “Operatori ekonomik duhet të ketë realizuar gjatë 5 (pesë) viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së përllogaritur për QMT, sipas relacionit teknik. Ku përfshihet edhe qendër monitorimi trafik (ndërtimi dhe pajisja, kontrolli dhe monitorimi në rrugë, tunele dhe autostrada të kësaj kategorie) të realizuara në një kontratë të ngjashme.”</p> <p>Në fakt vendosja e këtij kriteri është në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ‘Për miratimin e rregullave të prokurimit publik’, neni 39, pika 5 pasi kjo dispozitë ligjore ka parashikuar saktësisht se cilat janë dëshmitë që do të merren në shqyrtim nga Autoritetet Kontraktore për të vlerësuar përvojën e mëparshme. Në lidhje me punët e ngjashme AK duhet të kishte kërkuar të tilla në raport vlerën e parashikuar të kontratës që prokurohet, pra në raport me fondin limit dhe jo për kategori të veçanta zërash në preventiv, apo për një zë i cili sipas relacionit teknik ka një vlerë prej 306,752,162.48 lekë, ose gati 13 % të gjithë vlerës së parashikuar të kontratës.</p>			
<p>Sipas dokumentacionit të ngarkuar në SPE nga ana e OE fitues rezulton se në 2 raste, konkretisht në procedurat me objekt:</p> <p>1. <u>Ndërtimi i Unazës së jashtme Tiranë, Loti 2</u></p> <p>Nga ana e BOEnuk përmbushet kriteri në lidhje me disponimin e licencave sipas përqindjes së punimeve të marra përsipër, kjo pasi sipas kontratës së bashkëpunimit të përkohshëm mes shoqërive me nr. 5428 rep. 1206 kol., datë 15.09.2021, nga ana e OE L... K... janë marrë përsipër të kryhen 95 % e punimeve nën kategorinë e licencës NS-19 Sisteme kundër zhurmës për të cilën NJP ka përllogaritur shumën prej <u>121,541,840 lekë</u>. Referuar vlerës përkatëse, OE L... K... i takon një vlerë punimesh</p>	39 – 64	E lartë	Nga ana e ARRSH të merren masa për kualifikimin e operatorëve të cilët përmbushin plotësisht dhe saktësisht kriteret e vendosura me qëllim shmangien e përdorimit pa efektivitet, eficientë dhe ekonomicitet të fondeve.

	<p>prej 115,464,748 lekë (0.95 x 121,541,840), ose kategoria D e licencës NS-19. Në fakt kjo shoqëri disponon kategorinë C të NS-19 e si e tillë kjo kompani nuk përmbush kriterin në lidhje me disponimin e licencës profesionale në raport me punën e marrë përsipër dhe si e tillë duhet të ishte s'kualifikuar.</p> <p>2. <u>Përmirësimi i sinjalistikës horizontale, vertikale dhe pajisjeve të sigurisë rrugore në akset e Rajonit Verior, Loti 1</u></p> <p>Në përfundim të procedurës së prokurimit është shpallur fitues OE J... me të cilin sipas shkresës me nr. 4122/6 prot., datë 31.05.2022 është lidhur kontrata përkatëse e sipërmarrjes së punimeve me vlerë 217,200,000 lekë me TVSH. Sipas dokumentacionit të ngarkuar në SPE si dhe atij të ndodhur në dosje, OE D... është deklaruar si nënkontraktor në fazën e ofertës me një angazhim në drejtim të realizimit të kontratës prej 40 %. Pas shpalljes fitues, me aktin nr. 3558 rep. 1695 kol., datë 20.05.2022 është lidhur kontrata e sipërmarrjes (Kontratë sipërmarrje për kryerje punimesh) mes OE J... dhe OE D... sipas të cilës palët kanë ndarë mes tyre edhe zërat e punimeve. Nisur nga volumet dhe vlerat përkatëse të punimeve të marra përsipër nga ana e nënkontraktorit të punimeve, rezultojnë se ky i fundit nuk plotëson kriterin në lidhje me disponimin e licencave sipas zërave respektivë të marrë përsipër në kontratën e sipërmarrjes. Konkretisht OE D... nuk disponon licencën NS-6/D <i>Sinjalistika rrugore jo ndriçuese</i>, pasi sipas përqindjes dhe volumeve të marra përsipër rezultojnë një vlerë në diapazonin e punimeve mes 51,000,000 – 100,000,000 lekë.</p>			
	<p>Nga krahasimi i zërave të likuiduar e me ato të situacionuara e të pasqyruara në librezën e masave rezultojnë diferenca në volume me pasojë përdorim pa efektivitet, eficientë dhe ekonomikitet fondet në shumën prej 10,376,373.5 lekë pa TVSH si rrjedhojë e përdorimit të çmimeve të preventivit të hartuar nga ana e projektuesit mbi ato të parashikuara nga manuali teknik i çmimeve të punimeve të ndërtimit në fuqi. Nga auditimi rezultojnë se projekti i hartuar nga ana e projektuesit të kontraktuar nga BOE G... C... & G... L... nuk i është referuar parashikimeve ligjore në drejtim të hartimit të preventivit të punimeve. Konkretisht, vlerat e mësipërme pasqyrohen të detajuara në Aneksin nr. 3.2.</p>	39 – 64	E lartë	<p>Nga ana e ARRSH, në rastet e kontratave të llojit <i>Me çelësa në dorë</i>, përpara miratimit të projektit nga ana e institucionit, të merren masat e nevojshme për respektimin, nga ana e projektuesve të të gjitha detyrimeve që parashikon kuadri ligjor e rregullator i projektimit, kjo me qëllim shmangien e përdorimit pa efektivitet, eficientë dhe ekonomikitet i fondeve.</p>
	<p>Nga auditimi rezultojnë se nga ana e OE G... janë përfshirë në situacionin përfundimtar, zëra të pakryera në fakt dhe/apo të pakryera sipas zërit të përshkruar në situacion. Konkretisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Gërmimi i dheut me ekskavator nuk është kryer me mjet të pajisur me kovë 0.25 m³; - Zërat <i>Spërkatje me emulsion bituminoz 1 l/m²</i> dhe <i>Spërkatje me emulsion bituminoz 0.5 l/m²</i> <p>Sasitë përkatëse të nevojshme për realizimin e ljerjeve me prajmer janë parashikuar nën zërat për realizimin e vetë shtresave asfaltike. Për rrjedhojë rezultojnë se janë përfutuar tepër nga ana e sipërmarrësit vlera prej 925,435 lekë pa TVSH ((563 lekë/m² + 402 lekë/m²) x 959 m²);</p> <ul style="list-style-type: none"> - Zëri <i>Mbushje me çakëll pas mureve</i> <p>Referuar detajeve të projektit të zbatimit rezultojnë se në lidhje me këtë ka një mbivendosje mes volumit për mbushjen me çakëll dhe zërit mbushje me çakëll e gur gurorje në trupin e rrugës përhapur e ngjeshur me makineri. Konkretisht volumi i likuiduar dy herë për të njëjtën hapësirë është në masën prej 200 m³ duke bërë që të përfitohet tepër nga ana e sipërmarrësit të punimeve vlera prej 617,200 lekë pa TVSH (200 m³ x 3,086 lekë/m³)</p> <ul style="list-style-type: none"> - Zëri <i>Shpim me sonda në tokë të zakonshme φ 1000 mm, thellësia 20 – 30 m</i> 	39 – 64	E lartë	<p>Nga ana e ARRSH, në rastet e kontratave të llojit <i>Me çelësa në dorë</i>, përpara miratimit të projektit nga ana e institucionit, të merren masat e nevojshme për respektimin, nga ana e projektuesve të të gjitha detyrimeve që parashikon kuadri ligjor e rregullator i projektimit, kjo me qëllim shmangien e përdorimit pa efektivitet, eficientë dhe ekonomikitet i fondeve.</p>

<p>Referuar detajeve të projektit të zbatimit si dhe vizatimeve të librezës së masave rezultojn se shpimi me sondë nuk është bërë më këto të dhëna por me diametër 800 mm dhe në thellësi 16 ml. Pra në këtë rast do të duhet të ishte ndryshuar zëri në preventiv sipas zërit të kryer në fakt. Konkretisht ky zë duhet të ishte ndryshuar në zërin sipas atij me nr. Analize M.3 An SD2 me çmim 4,906 lekë ml, ose vlera totale prej 3,610,816 lekë pa TVSH (46 copë pilota x 16 ml x 4,096 lekë/ml). Për rrjedhojë rezultojn se janë përfituar tepër nga ana e sipërmarrësit vlera prej 3,379,316.4 lekë pa TVSH (6,990,132.4 lekë – 3,610,816 lekë);</p> <p>- Zëri <i>Beton C 30/37 për pilota dhe traun e pilotave</i></p> <p>Sipas situacionit përfundimtar në lidhje me këtë zë është paraqitur volumni prej 588.8 m³, kjo vetëm për sa i takon betonit për pilotat. Libreza e masave pasqyron të njëjtin volum pune. Në fakt, referuar detajeve të projektit të zbatimit si dhe vizatimeve të librezës së masave, kjo e fundit ka paraqitur gabim sipërfaqen e seksionit tërthor të pilotës prej 0.8 m² kur në fakt sipërfaqja e seksionit tërthor për pilotë me diametër 0.8 m është 0.5024 m². Nga kjo volumni total i realizuar vetëm për pilotat është 369.8 m³ (0.5024 m²/ml x 46 pilota x 16 ml). Për rrjedhojë rezultojn se janë përfituar tepër nga ana e sipërmarrësit vlera prej 4,605,570 lekë pa TVSH ((588.8 m³ – 369.8 m³) x 21,030 lekë/m³).</p>			
<p>Në objektin “Ndërtim Rruga mbikalimi TEG dhe rrugët lidhëse të tij” sipas kontratës të lidhur midis Autoritetit Rrugor Shqiptar dhe OE A... B... me nr. 1130 prot. datë 03.02.2021 në lidhje me zbatimin e punimeve me 1,402,652,826.75 lekë pa TVSH ose 1,683,183,392.10 lekë me TVSH me afat përfundimi të punimeve 15 muaj dhe ky afat i ndryshuar me amendimin e kontratës nr. 3091/2 prot. datë 18.03.2022, deri më 02.11.2022, nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion, konkretisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Projekti fillestar;</i> • <i>Projekti i Zbatimit pjesor (Vizatimet sipas faktit);</i> • <i>Pagesat pjesore nga Situacioni nr. 1 deri Situacioni nr. 4;</i> • <i>Librezat e masave pjesore deri në situacionin përmbledhës nr. 4 ;</i> • <i>Ndryshimet e miratuara me Vendimet e Këshillit Teknik;</i> • <i>Korrespondencat mes Autoritetit Rrugor Shqiptar (ARRSH) dhe Kompanisë konsulate që kryen supervizionimin BOE “P... C...” sh.p.k & E... C... G...” sh.p.k & “E....G” sh.p.k & “L...S” sh.p.k</i> <p>si dhe nga verifikimi i kryer në terren në prezencë të përfaqësuesve shtetërorë të KLSH dhe Konsulentit (supervizori i punimeve) rezultuan se janë përfshirë në librezat e masave volume pune të pakryera në fakt në vlerën prej 12,131,741 lekë pa TVSH.</p>	39 – 64	E lartë	ARRSH në bashkëpunim me mbikëqyrësin e punimeve të marrë masa për zbritjen e punimeve të certifikuar më tepër dhe rakordimin e tyre, të vlerës 12,131,741 lekë pa TVSH që përbën dëm ekonomik, në situacionet pasardhës deri në atë përfundimtar, përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve OE A... B... me të cilin është lidhur kontrata nr. 1130 prot., datë 03.02.2021 për zbatimin e punimeve.
<p>Në objektin “Rehabilitimi i Segmentit Rrugor Mbikalimi Pallati me Shigjeta – Rreth rrotullimi Shqiponja Loti I” sipas kontratës të lidhur midis ARRSH dhe S... & B... N... me nr. 5469/7 prot., datë 22.10.2019 në lidhje me zbatimin e punimeve me vlerë 1,776,111,282 lekë pa TVSH ose 2,129,438,058 lekë me TVSH me afat përfundimi të punimeve 24 muaj dhe ky afat i ndryshuar me amendimin e kontratës nr. 9300/2 prot., datë 15.10.2021, deri më 16.04.2022, nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion, konkretisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Projekti fillestar;</i> • <i>Projekti i Zbatimit pjesor (Vizatimet sipas faktit);</i> • <i>Pagesat pjesore nga Situacioni nr. 1 deri Situacioni nr. 16;</i> • <i>Librezat e masave pjesore deri në situacionin përmbledhës nr.16 ;</i> • <i>Ndryshimet e miratuara me Vendimet e Këshillit Teknik;</i> • <i>Korrespondencat mes ARRSH dhe Kompanisë konsulate që kryen supervizionimin OE A... E... E....</i> <p>si dhe nga verifikimi i kryer në terren rezultuan se janë përfshirë në librezat e masave volume pune të pakryera në fakt në vlerën prej 8,490,090 lekë pa TVSH.</p>	39 – 64	E lartë	ARRSH në bashkëpunim me mbikëqyrësin e punimeve, të verifikojnë dokumentacionin e plotë të dosjes teknike si dhe punimet faktike të realizuara në terren për volumnet e përmendura, në kontratën e sipërmartjes së punimeve të lidhur mes BOE “S...” sh.p.k & “B... N...” sh.p.k sipas aktit me nr. 5469/7 prot. datë 22.10.2019, për zbatimin e punimeve civile.

3. Konkluzioni dhe Opinioni i auditimit

Në vlerësimin tonë, rezultati i auditimit për çështjet e përputhshmërisë së veprimtarisë ekonomike dhe financiare të Autoritetit Krugor Shqiptar për periudhën 01.10.2020 deri më 31.12.2022¹ nuk është në përputhje me të gjitha aspektet materiale me kriteret e përcaktuara në këtë auditim, që kanë të bëjnë me kuadrin ligjor, nënligjor dhe rregullator.

Grupi i auditimit në dhënien e opinionit ka marrë në konsideratë dhe gabime/parregullsi të caktuara të natyrës cilësore, pavarësisht vlerës së tyre.

Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion kemi konstatuar se në veprimtarinë e ARRSH, janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin”, që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale, jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinionit të kualifikuar.

Baza për opinionin e kualifikuar të përputhshmërisë.

Ne jemi përpjekur të sigurohemi që konkluzionet dhe opinionet tona të kenë një siguri të arsyeshme, si rrjedhojë e punës sonë audituese, si dhe për shkak të kufizimeve të vetvetishme të një auditimi, pasi normalisht nuk mund të jepet një siguri në shkallën maksimale. Konkluzionet dhe opinionin ynë janë të bazuara në kompetencën për vlerësim objektiv dhe profesional të evidencës së auditimit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion nga ARRSH, e cila konsiderohet nga ana jonë përfaqësuese, e mjaftueshme, e përshtatshme dhe e besueshme. Ne kemi përdorur gjykimin objektiv dhe kemi zbatuar skepticizmin profesional në vlerësimin e sasisë dhe cilësisë së evidencave dhe në këtë mënyrë kemi kontribuar në garantimin e mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë së tyre me qëllimin e dhënies së një opinionit me siguri të arsyeshme. Auditimi është kryer sipas standardeve të cilat bazohen në Parimet Themelore të Auditimit niveli 3 (ISSAI 100 - 999) të Standardeve Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit. Procedurat e auditimit të bazuara në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit: ISSAI 400 “Standardet e Auditimit të Përputhshmërisë”, ISSAI 1500 (ISA 500)² dhe ISSAI 1530 (ISA 530)³; Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë, si dhe dokumentimi i auditimit kanë shërbyer si bazë për arritjen e konkluzioneve dhe dhënien e opinionit në këtë auditim përputhshmërie. Ne kemi mbledhur dhe vlerësuar evidencën e auditimit, si dhe kemi konkluduar me gjetje dhe rekomandime në lidhje me fushën/objektin e auditimit, qasjen, kohën dhe burimet, me qëllim për të kryer një punë audituese që redukton në një nivel të ulët të pranueshëm, riskun e një konkluzioni ose opinionit të gabuar rreth objektivit të auditimit. Si bazë për dhënin e opinionit të kualifikuar mbi përputhshmërinë kanë shërbyer gjetjet si më poshtë:

- Vendosja e metodës së vlerësimit jo në përputhje me nevojat e investimit nuk ka rritur eficiencën dhe efikasitetin e procedurave, nuk ka arritur të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe ulje të shpenzimeve procedurale, nuk ka nxitur pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë si dhe nuk ka nxitur konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë për të gjitha procedurat e prokuruar;
- Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion për periudhën objekt auditimi, duke ju referuar vendimeve të Gjykatave, ARRSH rezulton të jetë palë debitore në 18 raste me subjekte të

¹ Për periudhën objekt auditimi, opinionin është dhënë pa përfshirë zbatimin e ligjshmërisë në prokurimet e fondeve publike, lidhjen, zbatimin dhe ndjekjen e kontratave për mirëmbajtjen e rrugëve, për të cilat është kryer auditim i sipas programit me nr. 385/1, datë 04.05.2022, i ndryshuar, për periudhën 01.10.2020 deri më 31.12.2022 ku edhe është dhënë opinion i kundërt mbi përputhshmërinë.

² Objektivi i audituesit është të hartojë dhe të kryejë procedurat e auditimit në mënyrë të tillë që të mundësojë marrjen e evidencës së mjaftueshme për të nxjerrë konkluzione të arsyeshme në të cilin do të bazojë opinionin e tij.

³ Objektivi i audituesit është të kryejë procedura të përshtatshme auditimi në funksion të këtij objekti.

ndryshme në vlerën **373,116,044 lekë**. Në dy nga këto raste, nga ana e debitorëve është vendosur urdhër sekuestro në llogaritë e Thesarit me vlerën **41,942,661 lekë**;

- Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me zbatimin e kontratave rezultoi se janë përdorur pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet fonde në shumën prej **104,130,025 lekë pa TVSH** si dhe janë përfituar tepër nga ana e sipërmarrësve të kontratave si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera në fakt në shumën totale prej **12,131,741 lekë pa TVSH**;

Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të ARRSH:

Strukturat drejtuese të ARRSH, janë përgjegjëse për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e aplikuara (kriteret e vlerësimit), përfshirë ato për zbatimin e gjithë kuadrit rregullator në prokurimin e fondeve publike. Strukturat drejtuese të ARRSH janë përgjegjëse për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, hartimin e procedurave, aktiviteteve të kontrollit, gjurmës së auditimit dhe hartës së proceseve. Gjithashtu, është përgjegjësi e drejtuesve të njësisë publike të përgjigjen dhe të jenë transparentë për veprimtarinë e tyre, si edhe të sigurojnë se i administrojnë këto fonde në pajtim me kriteret ligjore e rregullatore.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH mbi Auditimin e Përputhshmërisë:

Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme⁴, nëse veprimtaria e subjektit të audituar është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer të mundësojë identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesit e KLSH, gjithashtu aplikojnë edhe gjykimin dhe skepticizmin e tij profesional në punën audituese. Auditimi ka identifikuar çështjet më të rëndësishme lidhur me zbatueshmërinë e kriterëve të vlerësimit, kuadrin ligjor dhe rregullator nga ana e subjektit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë. Audituesit e KLSH janë përgjegjës për të siguruar cilësinë e auditimit, duke zbatuar procedurat e kontrollit të cilësisë gjatë gjithë procesit të auditimit, me synim marrjen e sigurisë, se auditimi është në përputhje me standardet e aplikueshme dhe se raporti i auditimit, konkluzionet dhe opinionin i auditimit janë të përshtatshme.

⁴ISA 200-ISSAI 1200 Objektivi i audituesit është të ofrojë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat si një e tërë nuk përmbajnë anomali materiale, raste mashtrimi ose gabime, si edhe të raportojë mbi këto pasqyra për sa i takon gjetjeve të tij/saj.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 1201/1, datë 18.01.2023, i ndryshuar, miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 23.01.2023 deri me datë 12.05.2023, në subjektin “Autoriteti Rrugor Shqiptar”, për periudhën 01.10.2020 deri më 31.12.2022, u krye “Auditim mbi Përputhshmërinë” nga Grupi i Auditimit me përbërje:

J. H., Përgjegjës Grupi,
S. H., Auditues,
I. B., Audituese,
E. S., Auditues,
M. M., Audituese.

OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA

1. Objekti i auditimit

Në objektivat dhe qëllimet e auditimit përfshihet vlerësimi objektiv i evidencave, dokumentacionit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion, për të përcaktuar nëse të dhënat e raportuara për periudhën objekt auditimi nga data 01.10.2020 deri më datë 31.12.2022 përputhen me kriteret përkatëse të kuadrit ligjor dhe rregullator. Objektivi i Auditimit është dhënia e opinionit mbi përputhshmërinë nëse në të gjithë aspektet materiale, aktiviteti ekonomik dhe financiar, transaksionet dhe informacioni janë në përputhje ose jo me dispozitat ligjore dhe rregulloret përkatëse. Në funksion të përmbushjes së misionit/angazhimit, objektivat kryesore të kësaj veprimtarie audituese janë:

1. Nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar të sektorit publik dhe të sjelljes së zyrtarëve të sektorit publik;
2. Vlerësimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm, menaxhimit të riskut dhe proceseve të drejtimit;
3. Dhënia e një sigurie të arsyeshme nëse:
 - Informacionet e rëndësishme financiare, të drejtimit dhe operacioneve janë të sakta, të besueshme dhe në kohën e duhur;
 - Burimet janë përdorur me kursim, dobi dhe frytshmëri;
 - Asetet janë ruajtur dhe mirë administruar;
 - Veprimtaria e ARRSH është në pajtueshmëri me politikën, procedurat, ligjet dhe rregulloret e miratuara për këtë qëllim;
 - Kërkesat nga organet ligjvënëse, agjencitë financuese ose organizatat donatore janë respektuar sipas kushteve të marrëveshjeve të financimit.
4. Vlerësim mbi shkallën e zbatimit të kuadrit rregullator përkatëse të prokurimit, si dhe zbatimi i detyrimeve kontraktore;
6. Dhënia e Opinionit dhe rekomandimeve për marrjen e masave për përmirësimin e veprimtarisë së subjektit të audituar.

2. Qëllimi i auditimit

Qëllimi i këtij auditimi përputhshmërie është evidentimi i devijimit nga standardet e pranuar të shkeljeve të parimeve të ligjshmërisë, të menaxhimit financiar me synim ndërmarrjen e masave dhe veprimeve korrigjuese nga ana e subjektit të audituar.

Nëpërmjet kryerjes së këtij auditimi KLSH synon të promovojë:

- Transparencën, duke ofruar raport të besueshëm për fondet nëse janë administruar sipas një procesi të rregullt dhe është respektuar kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi;
- Përgjegjshmërinë ndaj devijimeve të raportimit dhe ndaj shkeljeve të kuadrit ligjor rregullator, në mënyrë që të mund të merren veprime korrigjuese dhe personat përgjegjës të përgjigjen për veprimet e tyre;

- Qeverisjen e mirë, duke identifikuar dobësitë dhe duke vlerësuar rregullshmërinë aty ku kuadri ligjor rregullator rezulton i pamjaftueshëm dhe/ose i papërshtatshëm, si dhe duke marrë parasysh riskun e mashtrimit në lidhje me përputhshmërinë.

3. Identifikimi i çështjes:

Raporti i Auditimit mbi përputhshmërinë e veprimtarisë ekonomike dhe financiare të ARRSH për periudhën nga 01.10.2020 - 31.12.2022 ka identifikuar sipas kritereve specifike të vlerësimit, shqyrtimin dhe vlerësimin e fushave në vijim:

- Ligjshmërinë për emërimet dhe funksionimin e strukturave drejtuese (Bordi i Menaxhimit dhe Drejtori i Përgjithshëm)
- Vendimet e marra dhe zbatimi i tyre, hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit
- Organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit
- Organizimin e strukturës organizative, dhënien e pagave dhe shpërblimeve në përputhje me dispozitat ligjore
- Zbatimin e ligjshmërisë gjatë procesit të rekrutimit dhe largimit të punonjësve nga puna
- Ligjshmërinë në prokurimet e fondeve publike dhe ankandet, lidhjen dhe zbatimin e kontratave
- Zbatimin e ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e sistemit të MFK si dhe auditit të brendshëm

4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese:

Strukturat drejtuese kanë për detyrë që të përgjigjen për garantimin e sistemeve të përshtatshme dhe efektive të menaxhimit financiar dhe kontrollit, në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor dhe rregullator përkatës. Strukturat drejtuese janë përgjegjëse për realizimin e objektivave dhe zbatimin e përgjegjësive të caktuara në kuadrin ligjor dhe rregullator, për të menaxhuar fondet publike në mënyrë të ligjshme, me ekonomicitet, efektivitet dhe eficiencë. Gjithashtu, strukturat drejtuese janë përgjegjëse për vënien në dispozicion të dokumenteve zyrtare, shkresore apo elektronike, si dhe informacionit të kërkuar, në kushtet, afatet dhe strukturën e vendosur prej grupit të auditimit të KLSH.

5. Përgjegjësitë e Audituesve:

Audituesit e KLSH kanë përgjegjësi në dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, nëse aktiviteti ekonomik dhe financiar përputhet, në të gjitha aspektet materiale, me kriteret e aplikuara si: rregullat, ligjet, kodet e vendosura apo termat dhe kushtet, mbi të cilat është rënë dakord, ku mund të përmendim si burim të këtyre kritereve: standarde, ligje, vendime të Këshillit të Ministrave, rregullore, buxhete, kontrata, marrëveshje financimi, instrumente të tjerë që përmbajnë rregulla se si duhet të menaxhohen dhe zbatohen etj.;

- njëherësh aspektet e rregullshmërisë (respektimi i kritereve formale siç janë ligjet përkatëse, rregulloret dhe marrëveshjet) dhe ligjshmërisë (respektimi i parimeve të përgjithshme që rregullojnë menaxhimin e shëndoshë financiar dhe sjelljen e zyrtarëve publik);
- promovimin e një qeverisje të mirë, duke identifikuar dhe raportuar devijimet nga kriteret, në mënyrë që të merren veprime korrigjuese si dhe të identifikojë personat përgjegjës për veprimet e tyre.

6. Kriteret e vlerësimit

- ✓ Kushtetuta dhe Ligji nr. 154/2014 “Mbi Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.
- ✓ Ligji nr. 10164, datë 15.10.2009 “Për Autoritetin Rrugor Shqiptar”.
- ✓ Rregullorja e Brendshme e ARRSH, miratuar me Vendim nr. 10, datë 04.09.2018, “Mbi miratimin e rregullores së brendshme të Autoritetit Rrugor Shqiptar”.
- ✓ Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- ✓ Ligji nr. 88/2019, datë 18.12.2019 “Për buxhetin e vitit 2020”, i ndryshuar.
- ✓ Ligji nr. 137/2020 “Për buxhetin e vitit 2021”, i ndryshuar.

- ✓ Ligji nr. 115/2021, datë 25.11.2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, i ndryshuar.
- ✓ Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.
- ✓ Ligji nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"
- ✓ Legjislacioni mbi prokurimin publik;
- ✓ Ligji nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar / shfuqizuar.
- ✓ VKM nr. 276, datë 16.05.2018 “Për miratimin e mënyrës së organizimit, të strukturës, organikës dhe statutit të Autoritetit Rrugor Shqiptar”.
- ✓ VKM nr. 717, datë 23.06.2009 “Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore”, i ndryshuar.
- ✓ VKM nr. 83, datë 03.02.2016, “Për miratimin e kritereve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar.
- ✓ UMF nr. 14, datë 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore për institucionet Qendrore, organet e pushtetit vendor...”, i ndryshuar.
- ✓ UMF nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.
- ✓ Urdhër i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, nr. 108, datë 17.11.2016 “Për miratimin e manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit”.
- ✓ Urdhër i MF nr. 89, datë 28.12.2015 "Për Miratimin e Metodologjisë së Monitorimit të Performancës së Njësive Publike" .
- ✓ Udhëzimi i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore të Njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”.
- ✓ Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standard të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar,
- ✓ Udhëzimi nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.
- ✓ Udhëzimi nr. 8, datë 17.02.2003 “Për evidencimin, regjistrimin, përdorimin dhe raportimin e financimeve të huaja në kuadrin e projekteve dhe marrëveshjeve me donatorë të huaj”.
- ✓ Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “ Për prokurimin publik” i ndryshuar.
- ✓ VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, VKM nr. 918 datë 29.12.2014 “Për kryerjen e procedurave të prokurimit publik në mënyrë elektronike”, Udhëzimi i APP nr. 2, datë 27.01.2015 “Për hartimin e regjistrit të parashikimeve të prokurimit publik dhe regjistrit të realizimeve të prokurimit publik”, etj.
- ✓ Udhëzimi i buxhetit 2019 me Nr. 1/1, datë 06.03.2019 dhe Udhëzimi Plotësues nr. 1/3, datë 11.09.2019.
- ✓ Udhëzimi Plotësues për buxhetin Nr. 2 datë 20.01.2020 dhe Udhëzimi Plotësues Shtesë Nr. 26 datë 08.07.2020.
- ✓ Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 50, datë 05.02.2014, “Për miratimin e Strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e planit të veprimit”.
- ✓ Udhëzim nr. 01, datë 04.06.2014, për “Ekzekutimin e Detyrimeve Monetare të Njësive të Qeverisjes së Përgjithshme në Llogari të Thesarit”.
- ✓ Udhëzim nr. 22 datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes Qendrore”.
- ✓ Udhëzimi MF nr. 10 datë 28.02.2017 “Për përgatitjen e PBA 2018 – 2020”, etj.

7. Standardet e auditimit

Raporti i Auditimit është hartuar në përputhje me kërkesat e Rregullores së Procedurave të Auditimit në KLSH, si dhe mbështetur në:

- Kërkesat e Kushtetutës së Shqipërisë (Pjesa XIV, nenet 162 – 165);
- Ligjin nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- ISSAI 100 - Parimet themelore të auditimit të sektorit publik;

- ISSAI 400 - Standardet e Auditimit të Përputhshmërisë;
- ISSAI 4000 - Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë”;
- ISSAI 1500 (ISA 500) - Objektivi i audituesit është të hartojë dhe të kryejë procedurat e auditimit në mënyrë të tillë që të mundësojë marrjen e evidencës së mjaftueshme për të nxjerrë konkluzione të arsyeshme në të cilin do të bazojë opinionin e tij;
- ISSAI 1530 (ISA 530) - Objektivi i audituesit është të kryejë procedura të përshtatshme auditimi në funksion të këtij objektivi;
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve IFAC;
- Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve;
- Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI “Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë”.

8. Metodot e auditimit

Metodat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit në funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, në procedurat bazë dhe në procedurat analitike pas testeve të kryera me qëllim arritjen e objektivave të auditimit. Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të Audituesve janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodat dhe teknikat e mëposhtme:

- a. *Verifikimi i transaksioneve* – mbi bazën e informacionit në dokumentet e bankave me të cilët subjekti kryen transaksione;
- b. *Intervistimi* - duke marrë informacion nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit dhe atij të përfshirë për një çështje të caktuar, e kombinuar kjo me shqyrtimin e evidencave përkatëse;
- c. *Raportet dhe informacionet* - shfrytëzimi i raporteve/informacioneve relevante dhe të që kanë lidhje me objektivat e auditimit dhe specifikisht me drejtimit e auditimit;
- d. *Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm* - duke marrë informacionet e funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit financiar të subjektit;
- h. *Verifikimi në sistem dhe në terren*- me përzgjedhje të çështjeve të veçanta të auditimit, sipas drejtimeve të auditimit;
- g. *Të kombinuara*, sipas rastit dhe vlerësimit të Audituesve.

Audituesit e KLSH janë përpjekur në çdo rast në përzgjedhjen e arsyeshme dhe të mjaftueshme të metodave dhe teknikave veçmas dhe/ose të kombinuara, si dhe shtrirjen e tyre për të dhënë siguri të arsyeshme në arritjen e konkluzioneve të auditimit në tërësi, dhe sipas drejtimeve në veçanti.

9. Dokumentimi i auditimit

Audituesit e KLSH, mbi bazën e evidencave të kërkuara dhe të vëna në dispozicion, si dhe intervistave, takimeve, konsultave dhe komunikimeve me nëpunësit e ARRSH kanë përgatitur dokumentacionin e mjaftueshëm të auditimit, si rezultat i kuptimit të qartë të kriterëve të përdorura, të fushë-veprimit të auditimit, të gjykimeve, të përfundimeve të arritura mbi bazën e programit të auditimit dhe natyrën, kohën, shtrirjen dhe rezultatet e procedurave të kryera, arsyetimin pas të gjitha çështjeve të rëndësishme që kërkohet për ushtrimin e gjyqimit profesional si dhe konkluzioneve lidhur me to. Në këtë mënyrë, dokumentimi i auditimit është kryer nëpërmjet letrave të punës, shënimeve, pyetësorëve, të finalizuara me akt-konstatimet dhe më pas shqyrtimin e observacioneve të subjektit, takimeve ballafaqese në subjekt, të cilat kanë shërbyer si bazë për hartimin e këtij Raporti Përfundimtar Auditimi.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM MBI SUBJEKTIN NËN AUDITIM

Autoriteti Rrugor Shqiptar (ARRSH) është krijuar me Ligjin Nr. 10164, datë 15/10/2009, “Për autoritetin rrugor shqiptar”. Qëllimi i Ligjit ishte krijimi i Autoritetit Rrugor Shqiptar me kompetencat, përgjegjësitë dhe detyrat e tij si dhe shndërrimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve në Autoritetin Rrugor Shqiptar. Misioni i kësaj drejtorie ishte organizimi, zhvillimi, shfrytëzimi mirëmbajtja, ri-veshja dhe realizimi i programit të investimeve në rrjetin rrugor kombëtar.

Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve është krijuar në vitin 1993 (VKM. nr. 614, datë 29/12/1993 “Për krijimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve”). Organika dhe struktura e kësaj drejtorie gjatë viteve ka pësuar transformime. Numri i punonjësve ka pësuar ndryshime në vite duke filluar nga 800 punonjës deri në 169 punonjës.

Institucioni i ARRSH-së, ka pësuar ndryshime në strukturë sipas VKM nr. 276, datë 16.05.2018 “Për miratimin e mënyrës së organizimit, të strukturës, organikës dhe statutit të Autoritetit Rrugor Shqiptar”, sipas të cilit marrëdhëniet e punës së Drejtorit të Përgjithshëm, nëpunësve të tjerë dhe punonjësve të Autoritetit në nivel Qendror dhe rajonal rregullohen në bazë të dispozitave të Ligjit 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punësi RSH”, i ndryshuar.

Misioni i kësaj strukture është organizimi, zhvillimi, shfrytëzimi mirëmbajtja, ri-veshja dhe realizimi i programit të investimeve në rrjetin rrugor kombëtar. ARRSH, si një institucion i akredituar për administrimin e fondeve nga Buxheti i Shtetit si dhe nga donatorë të huaj si: Banka Botërore, Banka Evropiane për Zhvillim dhe Ndërtim, Banka Evropiane e Investimeve, Qeveria Italiane, Qeveria Kuvajtiane, Banka Islamike etj., ka realizuar disa objekte të rëndësishme në rrjetin rrugor nacional.

2. PËRSHKRIMI I REZULTATEVE SIPAS DREJTIMEVE TË AUDITIMIT

2.1 Mbi zbatimin e ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e strukturave drejtuese (Bordi i Menaxhimit dhe Drejtori i Përgjithshëm), vendimet e marra dhe zbatimi i tyre

Autoriteti Rrugor Shqiptar është krijuar me Ligjin nr. 10164, datë 15.10.2009 “Për Autoritetin Rrugor Shqiptar”. Në nenin 7 të këtij ligji përcaktohet se organet drejtuese të Autoritetit janë:

- Bordi i Menaxhimit
- Drejtori i Përgjithshëm

Bordi i Menaxhimit është përgjegjës për menaxhimin e veprimtarisë së Autoritetit. Bordi përbëhet nga 7 anëtarë, të cilët emërohen nga Këshilli i Ministrave me propozimin e institucioneve përkatëse. Mbledhja e bordit zhvillohet kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të tij dhe merr vendimet me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të tij. Bordi është organi i vetëm përgjegjës për:

- a) përcaktimin e politikave të biznesit të Autoritetit
- b) vendimet që rregullojnë veprimtarinë e Autoritetit
- c) miratimin e rregullores së brendshme të Autoritetit
- d) miratimin e programeve të brendshme vjetore dhe të buxhetit korrespondues të Autoritetit.

1. Titulli i gjetjes:	Funksionimi i Bordit të Menaxhimit me 6 anëtarë nga 7 që përcakton ligji.
Situata:	Anëtarët e Bordit të Menaxhimit janë emëruar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 28, datë 17.01.2018 “Për emërimin e anëtarëve të bordit të menaxhimit të Autoritetit Shqiptar Rrugor”. Nëpërmjet Vendimit nr. 350, datë 16.06.2021, Këshilli i Ministrave vendosi përfundimin e mandatit të z. E. H. dhe nëpërmjet Vendimit nr. 455, datë 29.06.2022, vendosi zëvendësimin e tij me z. E. Ll.. Si rrjedhojë, për

	një vit, qershor 2021-qershor 2022, Bordi ka funksionuar me gjashtë anëtarë.
Kriteri:	Ligji nr. 10164, datë 15.10.2009 “Për Autoritetin Rrugor Shqiptar”, neni 8, pika 5, <u>ku përcaktohet se</u> : “Në rast largimi të anëtarëve të bordit, zëvendësimi i tyre bëhet në përputhje me pikat 2 dhe 7 të këtij neni”.
Ndikimi:	Funksionimi me 6 anëtarë rrezikon të cenojë procesin e vendim marrjes.
Shkaku:	Mos parashikimi i qartë i detyrave të sekretarit të bordit në Rregulloren e Brendshme të ARRSH si dhe mungesa e monitorimit të procesit.
Rëndësia:	E lartë.
1.1 Rekomandimi:	Kryetari i Bordit, nëpërmjet sekretariatit/sekretarit të bordit, të tregojë kujdes maksimal në mënyrë që në asnjë rast në vazhdim, Bordi të mos ushtrojë funksionimin e tij pa numër të plotë të anëtarëve, sikurse e përcakton ligji nr. 10164, datë 15.10.2009 “Për Autoritetin Rrugor Shqiptar”.

2. Titulli i gjetjes:	Anëtarët e Bordit mungojnë në më shumë se në 1/3 e mbledhjeve të zhvilluara.
Situata:	Gjatë vitit 2021, Bordi është mbledhur 12 herë dhe ka marrë 16 vendime, ndërsa gjatë vitit 2022 është mbledhur 10 herë dhe ka marrë 10 vendime. Nga shqyrtimi i pjesëmarrjes së anëtarëve të Bordit në mbledhjet e zhvilluara, rezulton se: Gjatë vitit 2021, Kryetari i Bordit z. A. Sh. nuk ka marrë pjesë në 5 mbledhje, ose 42 % të mbledhjeve të zhvilluara dhe z. F. K., përfaqësues i Shoqatës Shqiptare të Inxhinierëve Konsulentë, nuk ka marrë pjesë në 8 mbledhje, ose 67 % të tyre. Gjatë vitit 2022, rezulton se z. J. H., përfaqësues i Ministrisë së Brendshme, nuk ka marrë pjesë në 8 mbledhje, ose 80 % të mbledhjeve të zhvilluara; dhe z. A. Sh. nuk ka marrë pjesë në 3 mbledhje nga 4 të zhvilluara, deri në zëvendësimin e tij me z. E. N. nëpërmjet Vendimit nr. 455, datë 09.06.2022 të Këshillit të Ministrave.
Kriteri:	Ligji nr. 10164 datë 15.10.2009 “Për Autoritetin Rrugor Shqiptar”, neni 10 mbi largimin nga detyra të anëtarëve të bordit, pika c, <u>ku përcaktohet se</u> : “Anëtari i bordit lirohet nga detyra, me vendim të organit që e ka emëruar, kur mungon brenda një viti në më shumë se në 1/3 (33%) e mbledhjeve të Bordit”.
Ndikimi:	Mungesa e vazhdueshme e disa anëtarëve të bordit, rrezikon të cenojë procesin e vendim marrjes.
Shkaku:	Mos parashikimi i qartë i detyrave të sekretarit të bordit në Rregulloren e Brendshme të ARRSH, dhe si rrjedhojë mungesa e monitorimit të procesit.
Rëndësia:	E lartë.
2.1 Rekomandimi:	Sekretari/sekretariati i Bordit të ndjekë me përgjegjshmëri pjesëmarrjen e anëtarëve të Bordit, në mënyrë që të respektohet kriteri i pjesëmarrjes minimale në 2/3 e mbledhjeve të zhvilluara gjatë vitit. Në rastet kur konstatohet tejkalim i këtij kriteri, të njoftohet Kryetari i Bordit, me qëllim marrjen e masave për të vënë në dijeni organin që e ka emëruar.

3. Titulli i gjetjes:	Anëtarët e Bordit paguhen për numër vendimesh dhe jo për numër mbledhjesh.
Situata:	Nga shqyrtimi i pagesave të kryera për kryetarin dhe anëtarët e Bordit, rezulton se pagesa e tyre është bërë për numër vendimesh të marra dhe jo për numër mbledhjesh të zhvilluara.
Kriteri:	VKM nr. 656, datë 31.10.2018 <i>“Përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të përhershme të njëjësive të qeverisjes qendrore”</i> .
Ndikimi:	Kjo mënyrë llogaritje dhe likuidimi, rrezikon trajtim financiar të pabarabartë të anëtarëve të bordit.
Shkaku:	Gabime në mënyrën e llogaritjes së pagesës dhe mungesë kontrolli nga Drejtoria e Financës mbi saktësisë e dokumentacionit përpara se të ekzekutojë pagesën.
Rëndësia:	E lartë.
3.1 Rekomandimi:	-Sekretari/sekretariati i Bordit të ndjekë me përgjegjshmëri pjesëmarrjen e anëtarëve të bordit dhe pagesa të llogaritet për numër takimesh dhe jo për numër vendimesh. -Drejtoria e Financës të kontrollojë saktësinë e dokumentacionit përpara kryerjes së pagesave.

4. Titulli i gjetjes:	Vendimet e Bordit nuk kanë një rend dite të përcaktuar nga Kryetari si dhe nuk janë të shoqëruara me procesverbalet e mbledhjes.
Situata:	Vendimet e Bordit nuk kanë një rend dite të përcaktuar nga Kryetari si dhe nuk janë të shoqëruara me procesverbalet e mbledhjes. Në këtë rast, grupi i auditimit e kishte të pamundur të vlerësonte rendin e ditës, çështjet e diskutuara, vendimet që u morën, si dhe formën dhe rezultatin e votimeve. Pra në këtë rast mungon gjurma e auditimit.
Kriteri:	Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 <i>“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”</i> , të ndryshuar, neni 16 <u>ku përcaktohet se:</u> <i>“Titullarët e njëjësive publike miratojnë gjurmët e auditimit, për procedura që lidhen me veprimtari kryesore të njësisë dhe sigurojnë që të gjitha operacionet e njësisë publike dokumentohen në atë formë, që u mundëson Audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit. Gjurma e auditimit arkivohet sipas dispozitave ligjore në fuqi”</i> . Ligji nr. 8480, datë 27.5.1999 <i>“Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore”</i> , neni 7 <u>ku përcaktohet se:</u> <i>“Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe me ligj, kryetari vendos për rendin e ditës së çdo mbledhjeje. Rendi i ditës duhet të përfshijë ato çështje që i janë propozuar atij nga anëtarët e organit kolegjial me të drejtë vote dhe që janë në kompetencë të këtij organi. Kërkesa për ta futur një çështje në rendin e ditës duhet të bëhet me shkrim, të paktën 5 ditë përpara datës së vendosur për mbledhjen. Rendi i ditës duhet t'i shpërndahet të gjithë anëtarëve, të paktën 48 orë përpara datës dhe kohës së mbledhjes.”</i> Ligji nr. 8480, datë 27.5.1999 <i>“Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore”</i> , neni 16 <u>ku përcaktohet se:</u> <i>“Në çdo mbledhje mbahet një procesverbal, ku bëhet një përmbledhje e gjithçka u tha në mbledhje, data dhe vendi i mbledhjes, anëtarët që morën pjesë, çështjet që u diskutuan, vendimet që u morën, si dhe forma dhe rezultati i votimeve.”</i>

	<p><i>Procesverbali mbahet nga sekretari dhe duhet t'u paraqitet për miratim të gjithë anëtareve në fund të mbledhjes ose në fillim të mbledhjes pasardhëse. Pas miratimit procesverbali nënshkruhet së bashku nga kryetari dhe sekretari.</i></p> <p><i>Në rastet kur vetë organi e shikon të arsyeshme dhe mbledhja është e ndarë në seanca, procesverbali miratohet menjëherë pas përfundimit të seancës përkatëse.</i></p> <p><i>Vendimet jonormative të organeve kolegjiale hyjnë në fuqi vetëm pasi të jetë miratuar procesverbali përkatës.”</i></p>
Ndikimi:	Mungesa e procesverbaleve të mbledhjes nuk mundëson gjurmë auditimi dhe si rrjedhojë cenon vlerësimin e transparencës së marrjes së vendimeve.
Shkaku:	Mungesa e përshkrimit të detyrave të sekretarit të Bordit. Mungesa e Kryetarit të Bordit në mbledhje i cili duhet të vendoste rendin e ditës.
Rëndësia:	E lartë.
4.1 Rekomandimi:	-Kryetari i Bordit të përcaktojë rendin e ditës për çdo mbledhje të zhvilluar. -Sekretari/sekretariati i Bordit të mbajë procesverbalet e mbledhjes në të cilat të përmbledhë gjithçka që thuhet dhe diskutohet në mbledhje, anëtarët që morën pjesë, çështjet që u diskutuan, vendimet që u morën, si dhe formën dhe rezultatin e votimeve.

5. Titulli i gjetjes:	Rregullorja e brendshme e ARRSH nuk përmban rregullat për mënyrën e funksionimit të bordit dhe përshkrimin e detyrave të sekretarit të bordit.
Situata:	Sekretari i Bordit është propozuar nga Drejtori i Përgjithshëm dhe është miratuar nga Bordi por nuk ka zbatuar kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore, pasi në Rregulloren e Brendshme të ARRSH nuk ka përshkrim të detyrave të tij. Rregullorja e brendshme, edhe pse është miratuar nga vetë Bordi, me Vendimin nr. 10, datë 04.09.2018, nuk përmban rregullat për mënyrën e funksionimit të bordit.
Kriteri:	VKM nr. 276, datë 16.5.2018 “Për miratimin e mënyrës së organizimit, të strukturës, organikës dhe statutit të Autoritetit Rrugor Shqiptar” pika III/3 ku përcaktohet se: “Drejtori i Përgjithshëm ngarkon një punonjës të autoritetit, i cili miratohet nga bordi, që të kryejë funksionin e sekretarit të bordit. Detyrat e hollësishme të sekretarit të bordit përcaktohen në rregulloren e brendshme të Autoritetit”. VKM nr. 276, pika III/3/ç “Rregullat për mbledhjet, kuorumin dhe vendimet e bordit përcaktohen në rregulloren e brendshme të Autoritetit”.
Ndikimi:	Mungesa e përcaktimeve të detyrave të sekretarit të bordit si dhe të mënyrës së funksionimit të bordit në rregulloren e brendshme, rrezikon të cenojë funksionimin efektiv të tij.
Shkaku:	Mos zbatimi i kërkesave ligjore për të paraqitur në rregulloren e brendshme përshkrimin e detyrave të sekretarit të bordit dhe mënyrën e funksionimit të bordit.
Rëndësia:	E lartë.

5.1 Rekomandimi:	Drejtori i Përgjithshëm të marrë masa për rishikimin e rregullores së brendshme të institucionit në të cilën të përshkruhen me detaje detyrat e sekretarit/sekretariatit të bordit, mënyra e funksionimit të bordit, hallkat e komunikimit dhe raportimit brenda dhe jashtë institucionit.
-------------------------	--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

6. Titulli i gjetjes:	Disa nga Vendimet e Bordit nuk kanë bashkëlidhur asnjë dokumentacion shpjegues.
Situata:	Disa nga Vendimet e Bordit, që i janë vënë në dispozicion grupit të auditimit, nuk kanë bashkëlidhur asnjë dokumentacion shpjegues në mënyrë që të kuptohet se mbi bazën e çfarë dokumentacioni apo informacioni është marrë vendimi. Edhe pse grupi i auditimit kërkoi vazhdimisht praktikën që duhet të ishte bashkëlidhur këtyre vendimeve, deri në përfundim të auditimit nuk u vu në dispozicion asnjë dokument. Konkretisht: Vendim nr. 18, datë 13.10.2020, <i>“Mbi vazhdimin e procedurave të mëtejshme për mjetet, makineritë dhe pajisjet e vlerësuara në vitin 2018”</i> Vendim nr. 20, datë 10.11.2020, <i>“Mbi vazhdimin e procedurave të mëtejshme për kalimin kapital nga Autoriteti Rrugor Shqiptar tek Bashkia Pogradec”</i> . Vendim nr. 2, datë 04.02.2021, <i>“Mbi vazhdimin e procedurave të mëtejshme për kalimin kapital nga Autoriteti Rrugor Shqiptar tek Bashkia Gjirokastrë”</i> . Vendim nr. 3, datë 04.02.2021 <i>“Mbi vazhdimin e procedurave të mëtejshme për vlerësimin e gjendjes teknike të mjeteve të Autoritetit Rrugor Shqiptar”</i> . Vendim nr. 9, datë 29.07.2021 <i>“Mbi miratimin e pagesës së shpenzimeve të punonjësve të ARRSH për periudhën maj 2021-qershor 2021”</i> .
Kriteri:	Detyrat e sektorit të Arkiv Protokollit në Rregulloren e Brendshme të Funksionimit të Autoritetit Rrugor Shqiptar, miratuar me Vendimin e Bordit nr. 10, datë 04.09.2018. Përcaktimet në normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, në mbështetje të ligjit nr. 9154 datë 06.11.2003 <i>“Për arkivat”</i> , neni 15, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave.
Ndikimi:	Mungesa e dokumenteve bashkëlidhur vendimeve, nuk mundëson gjurmë auditimi dhe si rrjedhojë cenon vlerësimin e transparencës së marrjes së vendimeve.
Shkaku:	Mos zbatimi i kërkesave ligjore.
Rëndësia:	E lartë.
6.1 Rekomandimi:	-Sekretari/sekretariatit i Bordit të marrë masa që vendimet e Bordit të kenë të gjithë dokumentacionin shpjegues dhe justifikues bashkëlidhur. -Sektori i protokoll arkivës në asnjë rast të mos pranojë Vendimet e Bordit pa dokumentacionin e plotë bashkëlidhur.

Në lidhje me këtë pikë të programit të auditimit, sipas shkresës së administruar në KLSH me nr. 1201/15 prot., datë 28.07.2023, janë bërë observacione nga ana e Titullarit z. E. B. të cilat në përmbajtje janë të njëjta me ato të paraqitura për aktin e konstatimit e për rrjedhojë edhe qëndrimi i Audituesve Shtetërorë të KLSH është i njëjtë me atë të sqaruar në Projektraportin e Auditimit.

2.2 Mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit

Për përmbushjen e misionit të saj, Autoriteti Rrugor Shqiptar (ARRSH) planifikon, drejton, dhe organizon punën që lidhet me planifikimin dhe realizimin e buxhetit për përdorimin me efikasitet, efektivitet dhe ekonomi të fondeve publike.

Gjithashtu, ARRSH harton detajimin e buxhetit vjetor, në përputhje me programin strategjik të qeverisë dhe sipas tavanëve të miratuara nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE), dhe i miraton ato në Bordin Drejtues të saj.

Ministria Infrastrukturore dhe Energjisë (MIE), është ministria përgjegjëse në kuadrin e programit të buxhetit të shtetit “Për Transportin Rrugor”, dhe për këtë arsye autorizon për çdo vit financiar përdorimin e fondeve buxhetore për ARRSH.

Struktura e buxhetit të ARRSH, sipas artikujve buxhetor, është e përbërë nga dy grupime kryesore, shpenzimet korentë (paga, sigurime shoqërore, shpenzime operative, transfertë për buxhet familjar & individë) dhe shpenzimet kapitale (me financim të brendshëm dhe me financim të huaj).

Për periudhën objekt auditimi, shpenzimet për investime kapitale me financim të brendshëm (buxheti i shtetit) përbëhen nga investime direkte (Ndërtim, emergjenca, supervizion, studime, projekte); kosto lokale dhe TVSH; investime jo-direkte (vendime gjyqësore, shpronësime, dhe rikonstruksioni i godinave të selive të ARRSH).

Shpenzimet kapitale me financim të huaj janë kryer për projektet në zbatim të marrëveshjeve të qeverisë shqiptare me donatorët, nëpërmjet njësive të zbatimit të projekteve, të cilat raportojnë vetëm detyrimin e qeverisë shqiptare për pagesën e TVSH. Procedurat e zbatimit të fondeve buxhetore, për ARRSH, evidentohen në sistemin informatik financiar të qeverisë (SIFQ) të administruar nga ministria përgjegjëse për financat.

Shpenzimet për paga dhe sigurimet shoqërore janë parashikuar dhe realizuar në zbatim të strukturës të përcaktuar me VKM nr. 276, datë 16.05.2018 “Për miratimin e mënyrës së organizimit, të strukturës, organikës dhe statutit të Autoritetit Rrugor Shqiptar”.

Për vitin 2021

Shpenzimet operative (Llog. 602) janë realizuar gjithsej në vlerën prej 2,632,510,139 lekë ose 96.4 % e parashikimit të buxhetit. Në përbërjen e këtyre shpenzimeve 92 % prej tyre ose 2,425,302,640 lekë e zënë kontratat e mirëmbajtjes, ndërsa 8 % ose 207,207,499 lekë janë shpenzimet administrative.

Shpenzimet për investime kapitale (Llog. 230/231) gjithsej në vlerën 26,993,827,000 lekë, nga ku 74.7 % ose 20,154,026,238 lekë përbëhen nga shpenzime kapitale me financim të brendshëm dhe 25.3 % ose 6,839,867,000 lekë janë shpenzime kapitale me financim të huaj.

Struktura e shpenzimeve për investime kapitale me financim të brendshëm është treguar si më poshtë:

Emërtimi	Buxheti 2021	Financimi 1 Janar-31 Dhjetor 2021	Realizimi 2021 në %	Diferenca të pafinancuara
Gjithsej	20,212,009,896	20,154,026,238	99.7	57,983,658
Ndërtim rrugësh	15,801,523,156	15,801,511,907	100	11,249
Emergenca	192,814,572	188,840,171	98	3,974,401
Supervizion punimesh	69,041,456	67,673,673	98	1,367,783
Sinjalistikë dhe siguri rrugore	670,042,453	670,042,453	100	0
Studim projektimë	108,560,060	108,557,660	100	2,400
Kosto lokale	504,132,875	503,167,478	100	965,397
TVSH dhe taksë doganore	1,443,659,563	1,442,883,871	100	775,692
Vendime gjyqësore	420,000,000	407,578,663	97	12,421,337
Shpronësime	621,608,876	621,608,876	100	0
Rikonstruksion godinash (ARRSH qendër dhe Drejtoritë Rajonale)	29,290,000	28,673,790	98	616,210
Fond total emergjence (ura +emergjencë)	351,336,885	313,487,696	89	37,849,189

Në Aktin Normativ nr. 34, datë 03.12.2021 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 137/2020 “Për buxhetin e vitit 2021” për Autoritetin Rrugor Shqiptar janë akorduar fonde buxhetore shtesë në vlerën prej 1,400,000,000 lekë, nëpërmjet të cilit është kryer likuidimi i të gjithë detyrimeve të prapambetura, për kontratat e mirëmbajtjes. Në fund të vitit 2021 detyrimet arrijnë vlerën prej 133, 711, 658 lekë, për shkak të detyrimeve të krijuara rishtazi, dhe përbëhen vetëm nga vendimet gjyqësore.

Për vitin 2022

Shpenzimet operative (Llog. 602) janë realizuar gjithsej në vlerën prej 3,209,203,000 lekë ose 99.7 % e parashikimit. Në përbërjen e këtyre shpenzimeve 93.46 % ose 2,999,456,360 lekë e zënë kontratat e mirëmbajtjes dhe 7.54 % ose 209,746,640 lekë e zënë shpenzimet administrative.

Shpenzimet për investime kapitale (Llog. 230/231) janë realizuar gjithsej 14,399,404,000 lekë, nga ku 76 % ose 10,942,684,363 lekë janë shpenzime kapitale me financim të brendshëm dhe 24 % ose 3,456,720,000 lekë janë shpenzime kapitale me financim të huaj.

Struktura e shpenzimeve për investime kapitale me financim të brendshëm është treguar në tabelën si më poshtë:

Emërtimi	Buxheti 2022	Financimi 1 Janar-31 Dhjetor 2022	Realizimi 2022 në %	Diferenca të pa financuara
Gjithsej	10,961,648,450	10,942,684,363	99.8	18,964,087
Ndërtim rrugësh	8,424,009,548	8,423,770,448	100	239,100
Supervizion punimesh	78,641,115	78,150,061	99	491,054
Sinjalistikë dhe siguri rrugore	544,235,932	543,879,099	100	356,833
Studim projekte	155,666,263	154,719,887	99	946,376
Kosto lokale	364,223,192	353,145,138	97	11,078,054
TVSH dhe taksë doganore	721,838,177	715,986,380	99	5,851,797
Vendime gjyqësore	180,000,000	179,999,999	100	0
Shpronësime	404,804,770	404,804,770	100	0
Rikonstruksion godinash (ARRSH qendër dhe Drejtoritë Rajonale	400,000	400,000	100	0
Fond emergjence total	87,829,453	87,828,581	100	872

Në zbatim të Aktit Normativ nr. 17, datë 01.12.2022 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 115/2021 për buxhetin e vitit 2022” janë akorduar fonde shtesë për shpenzime kapitale me financim të brendshëm në vlerën prej 4,101,972,400 lekë.

Me anën e fondeve të sipërcituara, si edhe alokimet e kryera nga Autoriteti për fondet e pa shfrytëzuara janë likuiduar detyrimet e krijuara për kontratat deri në fund të vitit 2022.

Në fund të vitit 2022, për shkak të detyrimeve të krijuara rishtazi (vendime gjyqësore) detyrimet e mbetura janë llogaritur në vlerën prej 335,297,976 lekë, nga ku mbi 70 % e këtyre vendimeve janë kundërshtime të VKM^{-ve} për shpronësime.

Të ardhurat e mbledhura nga veprimtaria e autoritetit, derdhen të gjitha në buxhetin e shtetit dhe ARRSH nuk përfiton nga këto të ardhura.

1. Titulli i gjetjes:	Parregullsi në procesin e zbatimit të buxhetit.
Situata:	Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me buxhetin rezultojnë shpenzime publike të paplanifikuara në fillim të vitit dhe jashtë vitit buxhetor për të cilin janë parashikuar. Konkretisht, procedura e hapur e thjeshtuar e prokurimit me numër REF-98245-06-16- 2021 me objekt “Për mirëmbajtjen rutinë me performancë e segmentit rrugor Kryqëzim Qafa e Buallit-Fillim Rruga e Arbërit, me gjatësi 4.5 km” është kryer si rrjedhim i rialokimit të buxhetit të vitit 2021 për të cilin është lidhur kontrata nr. 5807 prot., datë 30.07.2021 në vlerën totale 744,000 lekë me TVSH, për periudhën 01.08.2021-31.12.2021. Segmenti rrugor i sipërcituar ka qenë i përfshirë në

	<p>projektin e Bankës Botërore “<i>Mirëmbajtje dhe siguri rrugore bazuar në rezultate</i>” deri në tetor të vitit 2020. Po për të njëjtin objekt prokurimi, me urdhrin e prokurimit nr. 328 prot., datë 17.12.2021 dhe fond limit në vlerën prej 673,069.⁵⁰ lekë pa TVSH, është kryer procedura <i>me vlerë të vogël</i> në datën 21.12.2021 për mirëmbaje për periudhën 01.01.2022-31.03.2022. Për këtë procedurë është lidhur kontrata nr. 11476/2 prot., datë 30.12.2021, pa mbaruar kontrata e mëparshme për të njëjtin objekt prokurimi. Me shkresën nr. 9295/1 prot., datë 15.10.2021 është miratuar rialokimi i fondit prej 161,600 lekë, ose afërsisht 20 % nga kontrata e sipërcituar. Nga sa më sipër rezulton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - është vepruar në kundërshtim me VKM nr. 285 datë 19.05.2021 RrPP, neni 106 pika 1 dhe 2, e ndryshuar, pasi procedura e prokurimit në vlerë të vogël duhet të jetë bazuar në fondin e vitit buxhetor 2021; - nuk është respektuar e drejta për të kryer shpenzime brenda kufirit të fondeve të miratuara, e cila skadon ditën e fundit të vitit buxhetor, pavarësisht nëse kontrata njëvjeçare ose shumëvjeçare mund të vazhdojë edhe në vitin buxhetor pasardhës; - angazhimi i ri buxhetor (nënshkrimi i kontratës) për kontratën e dytë është kryer më vonë se data 15 Tetor e vitit buxhetor 2021, pra përtej afateve që parashikon udhëzimi nr. 9, datë 20.03.2018 i Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë “<i>Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit</i>”, pikat 41, 69, 71, 79, 83. - stafi i ARRSH nuk është plotësisht i qartë dhe i informuar për të drejtat dhe detyrimet gjatë zbatimit të buxhetit dhe nëpunësi i autorizuar nuk provon se ka deleguar rregullat dhe procedura të miratuara në bordin e ARRSH për përgjegjësitë individuale gjatë zbatimit të buxhetit.
<p>Kriteri:</p>	<p>VKM nr. 285 datë 19.05.2021, i ndryshuar, neni 106 pika 1 dhe pika 2 shkronja b.</p> <p>Udhëzimi nr. 9, datë 20.03.2018 “<i>Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit</i>” të Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë, pikat 41, 69, 71, 79, 83 <u>ku përcaktohet se:</u></p> <p>41. <i>Mbi bazën e rregullave të brendshme dhe procedurave të miratuara nga titullari i njësisë së qeverisjes së përgjithshme, përgjegjësitë për zbatimin e buxhetit duhet të shpërndahen nga nëpunësi autorizues nëpërmjet një sistemi delegimesh/ndarje funksionesh me rregulla të qarta dhe të dokumentuara. Çdo individ duhet të jetë i qartë dhe i informuar plotësisht mbi përgjegjësitë e tij.</i></p> <p>69. <i>Rishpërndarja e fondeve buxhetore është pjesë e procesit të azhurnimit të politikave të programuara në fillim të vitit dhe të detajuara sipas strukturës përkatëse buxhetore.</i></p> <p>71. <i>Çdo kërkesë për fonde shitesë ose rishpërndarje fondesh shoqërohet me analizë ku identifikohet arsyeja, rezultatet e pritshme, kontributi në arritjen e qëllimit dhe objektivave dhe risqet e lidhura, pakësimet e mundshme dhe pasojat.</i></p> <p>79. <i>E drejta për të kryer shpenzime, brenda kufirit të fondeve të miratuara, skadon ditën e fundit të vitit buxhetor, pavarësisht nëse kontrata njëvjeçare ose shumëvjeçare mund të vazhdojë edhe në vitin buxhetor pasardhës.</i></p>

	<i>83. Nëpunësi autorizues i njësisë së qeverisjes së përgjithshme mund të ndërmarrë angazhime të reja gjatë vitit buxhetor, por jo më vonë se data 15 tetor e çdo viti buxhetor.</i>
Ndikimi:	Përdorimi i fondeve buxhetore me riskun e shpenzimit pa efijencë.
Shkaku:	Përdorimi i fondeve buxhetore të paplanifikuara dhe të pa strukturuara.
Rëndësia:	E lartë.
1.1 Rekomandimi:	Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të ARRSH, në cilësinë e nëpunësit të autorizuar të merren të gjitha masat e nevojshme për analizën e nevojave të domosdoshme dhe planifikimin në kohën e duhur të shpenzimeve publike, me qëllim realizimin e shpenzimeve me efijencën e duhur.
1.2 Rekomandimi:	Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të ARRSH, në cilësinë e nëpunësit të autorizuar të merren të gjitha masat e nevojshme për hartimin, miratimin në bord dhe delegimin e rregullave specifike dhe procedurave që duhet të ndiqen në procesin e zbatimit të buxhetit, me qëllim që çdo individ të jetë i qartë dhe i informuar plotësisht mbi përgjegjësitë e tij.

Për situatën e mësipërme, ngarkohet me përgjegjësi z. E. B. Drejtor i Përgjithshëm i ARRSH, në cilësinë e Nëpunësit Autorizues.

2.3 Organizimi dhe mbajtja e kontabilitetit:

2.3.1 Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve të kryera nëpërmjet arkës, bankës në lekë dhe në valutë, blerjet e vogla për periudhën objekt auditimi

Në strukturën e Autoritetit Rrugor Shqiptar, sektori i prokurimeve është pjesë përbërëse e drejtorisë juridike dhe përputhshmërisë së standardeve.

Në Urdhrat nr. 7676 prot, datë 13.10.2020, nr. 5867 prot, datë 17.06.2021, nr. 8455 prot, datë 22.09.2021, nr. 32 prot, datë 05.01.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm është caktuar komisioni i prokurimit në vlerë të vogël, në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator.

Në vitet 2021-2022 janë kryer gjithsej 43 procedura prokurimi në vlerë të vogël në shumën prej 21,639,612 lekë nga 63 procedura të parashikuara në shumën prej 40,882,868 lekë.

Të dhëna të përgjithshme mbi prokurimet në vlerë të vogël janë dhënë në tabelën si më poshtë:

Viti	Parashikimi		Realizimi		Realizimi në %
	Nr./procedurave të prokurimit	Vlera në lekë	Nr./procedurave të prokurimit	Vlera në lekë	
2021	28	17,357,199.66	19	7,873,999.00	45.36
2022	35	23,525,668.00	24	13,765,613.00	56.5
Totali	63	40,882,867.66	43	21,639,612.00	

Tab. nr. 1 Prokurimet në vlerë të vogël për ARRSH Qendër (nuk janë përfshirë 3 drejtoritë rajonale)

Nga auditimi rezulton si më poshtë:

1. Titulli i gjetjes:	Parregullsi në procesin e vlerësimit të prokurimit në vlerë të vogël.
Situata:	<p>Në 4 raste, operatorët ekonomikë fitues rezultojnë me oferta me vlerë më të ulët nga oferta e paraqitur gjatë verifikimit në treg për vlerësimin e fondit limit. Ofertat e mësipërme janë prezantuar me vlera të ndryshme për të njëjtën objekt prokurimi dhe praktikisht në të njëjtën kohë, si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none">- Procedura e prokurimit me objekt “Blerje materiale pastrimi” me numrin e referencës REF-89466-09-03-2021 dhe fond limit në vlerën prej 407,633 lekë pa TVSH. Në SPE, në datën 10.03.2021, është shpallur oferta fituese, operatori M. V. në vlerën prej 338,300 lekë pa TVSH.Në procesverbalin e llogaritjes së fondit limit nr. 2199/2 prot, datë 08.03.2021, operatori M. V. është prezantuar me ofertën në vlerën prej 403,375 lekë pa TVSH.- Procedura e prokurimit me objekt “Blerje goma për automjete” me numrin e referencës REF-00769-12-07-2021 dhe fond limit në vlerën prej 625,000 lekë pa TVSH. Në SPE, në datën 14.07.2021, është shpallur oferta fituese, OE P... I... SHPK në vlerën prej 459,000 lekë pa TVSH.Në procesverbalin e llogaritjes së fondit limit nr. 6197/1 prot, datë 09.07.2021 OE P... I... SHPK është prezantuar me ofertën në vlerën prej 590,000 lekë pa TVSH.- Procedura e prokurimit me objekt “Blerje tonera dhe dramer të ndryshme” me numrin e referencës REF-13778-02-12-2021 dhe fond limit në vlerën prej 296,340.3 lekë pa TVSH.

	<p>Në SPE, në datën 03.12.2021 është shpallur oferta fituese, OE “S... C...” SHPK në vlerën prej 293,980 lekë pa TVSH.</p> <p>Në procesverbalin e llogaritjes së fondit limit nr. 9855/2 prot, datë 02.12.2021, OE “S... C...” SHPK është prezantuar me ofertën në vlerën prej 289,112 lekë pa TVSH.</p> <p>- Procedura e prokurimit me objekt “Blerje goma për automjetet” është kryer në zbatim të Urdhrit të Prokurimit nr. 265 datë 03.11.2022 dhe fond limit në vlerën prej 998,933.3 lekë pa TVSH.</p> <p>Në SPE, në datën 04.11.2022 është shpallur oferta fituese, OE “A... T...” SHPK në vlerën prej 719,000 lekë pa TVSH.</p> <p>Në procesverbalin e llogaritjes së fondit limit nr.9026/1, datë 26.10.2022, OE A... T... SHPK është prezantuar me ofertën në vlerën prej 1,016,800 lekë pa TVSH.</p> <p>Në zbatim të pikave 1 dhe 3 të Udhëzimit Nr.11 datë 30.05.2018 të Agjencisë Prokurimit Publik, komisioni i prokurimit në vlerë të vogël, ka detyrimin të krahasojë ofertat e paraqitura nga OE^{-kë} në sistemin elektronik të prokurimeve me fondin limit të përcaktuar më parë me qëllim që oferta e OE të jetë sa më reale.</p> <p>Për arsye që, fondi limit të jetë një bazë krahasuese reale, ky fond llogaritet përpara urdhrit të prokurimit dhe i shërben vetëm komisionit të prokurimit.</p> <p>Ofertat e operatorëve fitues, nga dekriptimi në sistemin elektronik, kanë rezultuar në një vlerë më të ulët se ofertat që ata kanë depozituar për llogaritjen e fondit limit, praktika e së cilës është vënë në dispozicion të komisionit të prokurimeve.</p> <p>Pranimi nga ana e komisionit të prokurimeve, të ofertave të operatorëve fitues në SPE, ka sjellë deformimin e procesit të krahasimit të këtyre ofertave me fondin limit, për arsye se këta ofertues kanë ndryshuar praktikisht në të njëjtën kohë të njëjtën ofertë në një vlerë më të ulët.</p> <p>Veprimet e mësipërme të komisionit të prokurimeve të vogla bien në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, neni 63 pika 3, i ndryshuar, dhe në kundërshtim me, VKM nr. 285, datë 19.05.2021, neni 13 pika 4, neni 79 pika 4.</p> <p>Ekzistenca 2 ofertave të sipërcituara për OE^{-ët} fitues, për të njëjtën objekt prokurimi dhe praktikisht në të njëjtën kohë, ka sjellë si pasojë deformimin e vlerësimit dhe të konkurrencës gjatë kryerjes së procedurës të prokurimit.</p>
Kriteri:	<p>VKM nr. 914, datë 29.12.2014, neni 63 pika 3, i ndryshuar, dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, neni 79 pika 4, nga <u>ku përcaktohet se:</u></p> <p><i>“Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vetëm një ofertë, vetëm në përjashtim të rasteve kur kërkohen oferta alternative.”</i></p> <p>VKM nr. 285, datë 19.05.2021, neni 13 pika 4, nga <u>ku përcaktohet se:</u></p> <p><i>“Për studimin e tregut, Autoriteti Kontraktor mund të konsultohet me ekspertë, autoritete të pavarura ose operatorë ekonomikë në treg me shkrim ose verbalisht. Në rastin e konsultimit verbal, grupi i ngritur për këtë qëllim, harton një procesverbal me këto të dhëna. Këto të dhëna mund të përdoren në planifikimin dhe kryerjen e procedurës së prokurimit, nëse nuk rezultojnë në shtrembërimin e konkurrencës dhe cenojnë parimet e mos diskriminimit dhe transparencës.”</i></p>
Ndikimi:	Deformim i vlerësimit dhe i konkurrencës.

Shkaku:	Pranimi i dy ofertave prej OE fitues, për të njëjtën objekt prokurimi dhe në të njëjtën kohë.
Rëndësia:	E lartë.
1.1 Rekomandimi:	Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të sigurohet që proceset e prokurimeve të përfshihen në një manual për prokurimin, me qëllim identifikimin e përgjegjësive individuale, dokumentacionin përkatës të miratuar për hapat e procesit, vendimmarrjen individuale, të drejtat dhe detyrimet, që duhet të ushtrohen gjatë zbatimit të këtyre procedurave me qëllim orientimin e komisioneve me dispozitat e aplikueshme në kuadrin ligjor dhe rregullator.

Për veprimet dhe mosveprimet e trajtuara ngarkohen me përgjegjësi z. E. D., larguar, me cilësinë e ish-kryetarit të komisionit të prokurimeve në vlerë të vogël. znj. D. M., larguar, me cilësinë e ish-anëtarit të komisionit të prokurimeve në vlerë të vogël.

znj. A. H., larguar, me cilësinë e ish-anëtarit të komisionit të prokurimeve në vlerë të vogël.

znj. A. K., larguar, me cilësinë e ish-kryetares të komisionit të prokurimeve në vlerë të vogël.

z. E. Ç., specialist në Drejtorinë e Shërbimeve të Brendshme, me cilësinë e anëtarit të komisionit të prokurimeve në vlerë të vogël.

z. E. A., specialist në Sektorin e Prokurimeve, me cilësinë e anëtarit të komisionit të prokurimeve në vlerë të vogël.

z. B. D., Përgjegjës në Sektorin e Prokurimeve, me cilësinë e kryetarit të komisionit të prokurimeve në vlerë të vogël.

2. Titulli i gjetjes:	Parregullsi në procesin e hartimit të regjistrit të parashikimeve të prokurimit.
Situata:	<p>Autoriteti Kontraktor (ARRSH) në momentin e hartimit të regjistrave të parashikimit, për përcaktimin e procedurës së blerjes në vlerë të vogël nuk ka marrë parasysh grupin e mallrave apo shërbimeve të ngjashme, sipas natyrës, sasisë dhe llojit të kontratës, të cilat kanë të njëjtin funksion kryesor apo kanë të njëjtin emërtim në planin e shpenzimeve.</p> <p>Në 6 raste, gjatë hartimit të regjistrave të parashikimeve në prokurime është evidentuar shmangie nga procedurat përkatëse të prokurimit, duke shkaktuar copëzimin e fondeve apo të kontratave si më poshtë:</p> <p>-Procedura me objekt prokurimi “Blerje tonera dhe drame të ndryshëm” - tonera për makina fotokopjuese, me fond limit në vlerën prej 800,000 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 23.04.2021 dhe realizuar në vlerën prej 699,000 lekë pa TVSH.</p> <p>Procedura me objekt prokurimi “Blerje tonera dhe drame të ndryshëm” - tonera për printer dhe fax, me fond limit në vlerën prej 361,200 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 03.12.2021 dhe realizuar në vlerën prej 293,980 lekë pa TVSH.</p> <p>Të dy procedurat e ngjashme të sipërcituara, gjatë planifikimit rezultojnë së bashku në vlerën 1,161,200 lekë, duke tejkaluar në këtë mënyrë me 161,200 lekë pragun e procedurës së prokurimit në vlerë të vogël.</p> <p>-Procedura me objekt prokurimi “Shpenzime për mirëmbajtjen e objekteve ndërtimore (lyerje ambientesh dhe zyrash, riparime hidraulike etj.)” me fond limit 800,000 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 12.04.2021 dhe realizuar në vlerën 276,525 lekë pa TVSH.</p> <p>-Procedura me objekt prokurimi “Shpenzime për mirëmbajtjen e zyrave</p>

	<p>të laboratorit të ARRSH (lyerje ambientesh dhe zyrash, riparime hidraulike, elektrike pllakash etj.)” me fond limit në vlerën prej 1,000,000 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 16.07.2021 dhe realizuar në vlerën 780,000 lekë pa TVSH.</p> <p>Të dy procedurat e ngjashme të sipërcituara, gjatë planifikimit rezultojnë së bashku në vlerën 1,800,000 lekë, duke tejkaluar në këtë mënyrë me 800,000 lekë pragun e procedurës së prokurimit në vlerë të vogël.</p> <p>-Procedura me objekt prokurimi “Shpenzime për blerje Software Autocad” me fond limit 1,000,000 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 06.12.2022 dhe realizuar në vlerën 959,000 lekë pa TVSH.</p> <p>-Procedura me objekt prokurimi “Shpenzime për mirëmbajtjen e pajisjeve kompjuterike dhe elektronike” me fond limit në vlerën prej 1,000,000 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 13.10.2022 dhe realizuar në vlerën 915,600 lekë pa TVSH.</p> <p>Të dy procedurat e ngjashme të sipërcituara, gjatë planifikimit rezultojnë së bashku në vlerën 2,000,000 lekë, duke tejkaluar në këtë mënyrë me 1,000,000 lekë pragun e procedurës së prokurimit në vlerë të vogël.</p> <p>Nga auditimi, rezultojnë se janë emëruar personat përgjegjës për prokurimin për hartimin e regjistrave të prokurimit, megjithatë mungojnë linja të qarta raportimi, përfshirje e aktorëve të domosdoshëm, vendimmarrje dhe përgjegjësi të përcaktuara. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me Udhëzimin nr. 03, datë 08.01.2018, pikat 3, 4, me Udhëzimin nr. 05, datë 25.06.2021, pikën 3, në kundërshtim me Vendimin nr. 285 datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, nenin 56, pika 2 dhe 11, duke shkaktuar copëzimin e fondeve apo kontratave, për pasojë kufizimin e procedurave konkurruese të prokurimit.</p>
<p>Kriteri:</p>	<p>VKM nr. 285 datë 19.05.2021, neni 56 pika 2, <u>ku përcaktohet se:</u> <i>“Autoriteti Kontraktor planifikon natyrën, sasinë dhe llojet e kontratave, që do të prokurohen me këtë procedurë prokurimi. Në asnjë rast, Autoriteti Kontraktor në momentin e planifikimit të nevojave të tij, nuk duhet të përdorë procedurën e prokurimit me vlerë të vogël, si mundësi për të pjesëtuar vlerën e kontratës për shmangien nga procedurat e prokurimit.</i></p> <p>Udhëzimi nr. 03, datë 08.01.2018 i APP, pika 3 dhe 4, <u>ku përcaktohet se:</u> <i>“3. Kjo procedurë do të përdoret për blerjen e një grup mallrash, kryerjen e shërbimeve apo punëve të ngjashme, që kanë të njëjtin funksion kryesor apo që kanë të njëjtin emërtim në planin e shpenzimeve.</i></p> <p><i>4. Autoriteti Kontraktor planifikon natyrën, sasinë dhe llojet e mallrave, shërbimeve dhe zërave të punëve që do të prokurohen në këtë mënyrë dhe i përfshin ato në regjistrin e parashikimeve të procedurave të prokurimit publik.</i></p> <p><i>Autoriteti Kontraktor nuk është i detyruar të prokurojë njëherësh të gjithë sasinë e mallrave, shërbimeve, apo punëve ..Autoriteti Kontraktor mund të realizojë disa procedura prokurimi me vlerë të vogël gjatë vitit kalendarik, në varësi të nevojave dhe mundësive të tij,</i></p>

	<i>por vlera e përlogaritur në total e këtyre procedurave, për të njëjtin mall, punë, shërbim apo grup mallrash, shërbimesh/punësh, nuk duhet të jetë më e madhe se pragu.”</i>
Ndikimi:	Copëzimi fondeve apo ndarja e kontratave.
Shkaku:	Kufizimi i procedurave konkurruese të prokurimit.
Rëndësia:	E lartë.
2.1 Rekomandimi:	Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Përputhshmërisë së Standardeve si dhe Përgjegjësi i Sektorit të Prokurimeve, të merren masat e nevojshme, që në procesin e hartimit të regjistrit të parashikimeve të prokurimeve të përfshihen linja të qarta bashkëpunimi, raportimi dhe përgjegjësi të përcaktuara, me qëllim që të shmangët kufizimi i procedurave konkurruese të prokurimit dhe copëzimi i fondeve publike.

Lidhur me këto veprime dhe mosveprime ngarkohen me përgjegjësi z. B. D., me detyrë përgjegjës i sektorit të prokurimeve, znj. M. Sh. me detyrë drejtore e Drejtorisë Juridike dhe Përputhshmërisë së Standardeve, ish përgjegjëse e sektorit të prokurimeve.

2.3.2 Nxjerrja e bilancit kontabël në afat, plotësimi i pasqyrave financiare sipas udhëzimeve të Ministrisë së Financave.

2.3.3 Mbi administrimin e pronës shtetërore dhe zbatimimi i dispozitave për dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare.

3. Titulli i gjetjes:	Mos mbajtja e Regjistrit të Aktiveve sipas përcaktimeve.
Situata:	Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se Regjistri i Aktiveve të ARRSH, përfshihen: tag numri, emërtimi, njësia matëse/targa e mjetit, çmimi, gjendja në fund të vitit paraardhës (31.12.2021) e shprehur në sasi dhe vleftë, fletë hyrje dhe fletë dalje (numër, datë, sasia, dhe vlefta), si dhe gjendja në fund të vitit korrent (31.12.2022). Pra në këtë regjistër nuk paraqiten të dhëna lidhur me vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.
Kriteri:	Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 <i>“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”</i> , neni 30 <i>ku përcaktohet se:</i> <i>“Formati i regjistrit të aktiveve hartohet në varësi si të llojit të tyre afatgjatë apo afatshkurtër, si dhe grupit përkatës brenda llojit. Kërkesat minimale që duhet të përmbajë regjistri i aktiveve në varësi të llojit, përfshijnë: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.”</i>
Ndikimi:	Ekzistenca dhe gjendja në të cilën ndodhen aktivitetet fizike është një pjesë e rëndësishme në vlerësimin e riskut për arritjen e objektivave të ARRSH - së dhe vazhdimësinë e saj. Mos plotësimi i regjistrit të aktiveve sjell risk të lartë për shpërdorime materiale të pasurisë së ARRSH - së, si humbje, vjedhje, shkatërrime dhe mos përditësim i

	aktiveve që ka në dispozicion.
Shkaku:	Mos zbatimi i Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, neni 30.
Rëndësia:	E lartë.
3.1 Rekomandimi:	Nga Sektori i Financës të përditësohet Regjistri i Aktiveve, pasi të jenë kryer vlerësimet lidhur me vlerën e mbetur dhe jetën e dobishme të aktiveve me vlera materiale të cilat ndikojnë në rezultatin financiar.

4. Titulli i gjetjes:	Mos realizimi i procedurës të ankandit për shitjen e skrapit.
Situata:	<p>Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se lidhur me shitjen e skrapit janë realizuar dy procedura ankandi, të cilat janë anuluar, si më poshtë:</p> <p>Ankandi 1: -Me procesverbalin e hapjes të ankandit nr. 2, datë 23.06.2021 ka rezultuar se nuk është paraqitur asnjë ofertues.</p> <p>-Me shkresën nr. 4579/5 prot, datë 28.06.2021 “Raport përmbledhës për procedurën e ankandit publik me objekt ‘Automjete dhe makineri të tjetërsuara skrap, të Autoritetit Rrugor Shqiptar dhe Drejtorive Rajonale Tiranë, Gjirokastër, Shkodër”, drejtuar Titullarit të Autoritetit Shitës z. E. B., nga komisioni i sipër përmendur, është propozuar ndërprerja e kësaj procedure ankandi.</p> <p>-Me Urdhrin e Titullarit të ARRSH nr. 4579/6 prot, datë 28.06.2021 është anuluar procedura e ankandit.</p> <p>-Me shkresën nr. 4579/7 prot, datë 28.06.2021 është njoftuar Agjencia e Prokurimit Publik lidhur me anulimin e procedurës.</p> <p>Ankandi 2: Me procesverbalin nr. 2, datë 09.09.2021 “Hapja e ankandit publik” ka rezultuar se nuk është paraqitur asnjë ofertues.</p> <p>- Me shkresën nr. 7015/3 prot, datë 16.09.2021 “Raport përmbledhës për procedurën e ankandit publik me objekt ‘Automjete dhe makineri të tjetërsuara skrap, të Autoritetit Rrugor Shqiptar dhe Drejtorive Rajonale Tiranë, Gjirokastër, Shkodër”, drejtuar Titullarit të Autoritetit Shitës z. E. B., nga komisioni i sipër përmendur, është propozuar ndërprerja e kësaj procedure ankandi.</p> <p>-Me Urdhrin e Titullarit të ARRSH nr. 7015/4 prot, datë 27.09.2021 është anuluar procedura e ankandit.</p> <p>-Me shkresën nr. 7015/6 prot, datë 29.09.2021 është njoftuar Agjencia e Prokurimit Publik lidhur me anulimin e procedurës.</p> <p>Nga kjo periudhë e në vazhdim rezulton se nga ana e ARRSH nuk janë marrë masa lidhur me kryerjen e mëtejshme të procedurave të ankandit, në mënyrë që të realizohet shitja e skrapit.</p>
Kriteri:	<p>Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011, Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar <u>ku përcaktohet se:</u></p> <p><i>“109. Aktivët që pas vlerësimit nxirren jashtë përdorimit, kur mund të përdoren si vjetërsira/mbeturina/materiale të riciklueshme, hiqen nga regjistri i aktiveve në përdorim, bëhen hyrje në magazine dhe u shiten me ankand ndërmarrjeve që i grumbullojnë (me përjashtim të rasteve kur sipas rregullave të shëndetësisë duhet të asgjësohen), kurse të tjerat asgjësohen nga komisioni i nxjerrjes nga përdorimi duke ndryshuar formën e tyre fillestare, groposur ose djegur.”</i></p>
Ndikimi:	Ekzistenca dhe gjendja në të cilën ndodhen aktivet fizike është një pjesë e rëndësishme në vlerësimin e riskut për arritjen e objektivave të

	ARRSH - së dhe vazhdimësinë e saj.
Shkaku:	Nga ARRSH nuk janë marrë masa lidhur me kryerjen e mëtejshme të procedurave të ankandit në mënyrë që të realizohet shitja e skrapit.
Rëndësia:	E lartë.
4.1 Rekomandimi:	Sektori i Financës dhe Sektori Juridik të marrin masa lidhur me realizimin e procedurës së ankandit lidhur me shitjen e skrapit dhe ndjekjen me përgjegjshmëri të hapave lidhur me plotësimin e dokumentacionit përkatës.

5. Titulli i gjetjes:	Mos inventarizimi i “Rrugëve dhe rrjeteve rrugore”.
Situata:	Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se nuk janë evidentuar në kontabilitet “Rrugët dhe rrjetet rrugore”. Për pasojë, nuk ka një vlerë të saktë dhe të drejtë të zërave të mësipërm dhe vlerës së konsoliduar në pasqyrat financiare të shtetit. Deri në fund të vitit 2021 mungon një inventar i plotë e i azhornuar i rrjetit rrugor, me të dhëna për gjatësinë e rrugëve të përfunduara dhe të kolauduara (me të dhëna të plota mbi gjatësitë, kategoritë e rrugës dhe vlerën kontabël respektive që referuar planit duhej të pasqyroheshin në analiza të veçanta sipas ndarjes së përcaktuar në “Kodin Rrugor Shqiptar”), të analizuar në llogarinë 213 “Rrugë, rrjete dhe vepra ujore”.
Kriteri:	Ligji nr. 8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 2, pika 2, <i>ku përcaktohet se:</i> “Sipas karakteristikave të tyre konstruktive, teknike dhe funksionale” rrugët klasifikohen autostradë, rrugë interurbane kryesore, rrugë interurbane dytësore, rrugë urbane kryesore, rrugë urbane dytësore dhe rrugë lokale”.
Ndikimi:	Ekzistenca dhe gjendja në të cilën ndodhen aktivet fizike është një pjesë e rëndësishme në vlerësimin e riskut për arritjen e objektivave të ARRSH dhe vazhdimësinë e saj. Mos plotësimi i regjistrit të rrugëve dhe rrjeteve rrugore sjell paqartësi dhe rrezikon vonesa në fillimin dhe përfundimin e projekteve të realizimin e projekteve të ardhshme, duke rrezikuar kështu dhe penalitete të cilat mund të shkaktohen si pasojë e vonesave të realizimin e këtyre projekteve.
Shkaku:	Mos inventarizimi i rrugëve dhe rrjeteve rrugore.
Rëndësia:	E lartë.
5.1 Rekomandimi:	Drejtori i Përgjithshëm, Sektori i Financës dhe Sektori Juridik të marrin masa lidhur me realizimin e inventarizimit dhe plotësimit të regjistrit të rrugëve dhe rrjeteve rrugore.

6. Titulli i gjetjes:	Mos likuidimi i pronarëve të pasurive të shpronësuara.
Situata:	Autoriteti Rrugor Shqiptar, në cilësinë e subjektit në favor të së cilit bëhet shpronësimi ka paraqitur pranë Agjencisë Shtetërore për Shpronësim kërkesat për shpronësim të cilat janë finalizuar duke u miratuar me Vendime të Këshillit të Ministrave në vlerën 3,312,523,392 lekë, nga të cilat rezulton të jenë shlyer 39 % e kësaj vlere. Diferenca e mbetur e mos likuidimit është për shkak se pronarët e pasurive të shpronësuara nuk kanë depozituar pranë Autoritetit Rrugor

	Shqiptar dokumentacioni ligjor për likuidim.
Kriteri:	Ligji nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë së paluajtshme pronë private për interes publik”, i ndryshuar, neni 190 “Fitimi i pronësisë me anë të shpronësimit”, ligji nr. 7850, datë 29.07.1994 “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, si dhe VKM nr. 138, datë 23.03.2000 “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik” i ndryshuar, pika 2, 3 dhe 4.
Ndikimi:	Vonesat në procedurat e shpronësimeve rezultojnë më pas në vonesa në fillimin dhe përfundimin në afat të investimeve.
Shkaku:	Mangësitë në dokumentacionin e dorëzuar nga pronaret për shpronësim.
Rëndësia:	E lartë.
6.1 Rekomandimi:	Nga Sektorit i Financës dhe Sektori i Sigurimit të Tokës të merret në analizë situata e mos likuidimit të pronarëve të pasurive të shpronësuara, si dhe të merren masa lidhur me likuidimin e tyre.

7. Titulli i gjetjes:	Mos likuidimi i detyrimeve të prapambetura me palët e treta.
Situata:	Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion për periudhën objekt auditimi, duke ju referuar vendimeve të Gjykatave, ARRSH rezultojnë të jetë palë debitore në 18 raste me subjekte të ndryshme në vlerën 373,116,044 lekë . Në dy nga këto raste, nga ana e debitorëve është vendosur urdhër sekuestro në llogaritë e Thesarit me vlerën 41,942,661 lekë. Sa më sipër, situata e krijuar lidhur me detyrimet ndaj palëve të treta dhe urdhër sekuestrot e llogarive të Thesarit, rrezikojnë performancën e ARRSH, përmbushjen e funksioneve primare, pagesën e punonjësve e të detyrimeve të tjera, në kushtet e bllokimeve të vazhdueshme të llogarive të saj, gjë e cila mund të rezultojë në pezullim të detyrimeve operacionale.
Kriteri:	Vendimet e gjykatave dhe mos likuidimi i detyrimeve nga ana e ARRSH.
Ndikimi:	Mos likuidimi i detyrimeve të ARRSH ka shkaktuar efekt financiar negativ në vlerën 373,116,044 lekë , në buxhetin e ARRSH dhe urdhër sekuestro në llogaritë e thesarit.
Shkaku:	Mos likuidimi i detyrimeve të prapambetura.
Rëndësia:	E lartë.
7.1 Rekomandimi:	Drejtori i Përgjithshëm dhe Sektori i Financës të analizojnë efektin financiar negativ me vlerë 373,116,044 lekë , shkaqet të cilat kanë sjellë këtë situatë dhe të marrin masa lidhur me likuidimin e këtyre detyrimeve, të cilat sjellin si pasojë sekuestrim të llogarive thesarit të ARRSH.

8. Titulli i gjetjes:	Mos regjistrimi i pasurisë së paluajtshme në ZVRPP/ASHK.
Situata:	Në regjistrimin e pasurisë së paluajtshme u konstatua se nga ana e strukturave drejtuese të ARRSH, për periudhën objekt auditimi, këto pasuri rezultojnë të regjistruara në mënyrë jo të plotë në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurisë dhe më pas në Agjencinë Shtetërore të

	<p>Kadastrës, në kundërshtim kjo me përcaktimet e ligjit nr. 8743, datë 22.02.2001 “Për pasuritë e paluajtshme shtetërore”, i ndryshuar si dhe kërkesat e ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, VKM nr. 155, datë 02.03.2011 dhe VKM nr. 3, datë 07.01.2005. Konkretisht rezulton se nuk është regjistruar sipërfaqja totale e Ndërtesës së ARRSH prej 1.379,92 m² por është pasqyruar në kartelën dhe certifikatën e regjistrimit të pronësisë në ZVRPP vetëm 439 m², ose nuk janë regjistruar në kartelat e pronësisë së institucionit 940.92 m². Bazuar në Fletën e Inventarit të hartuar nga Komisioni i Inventarizimit të pasurisë, në inventarin e llog. 212. “Ndërtesa” përfshihen 6 zëra (nga këto, një objekt është godina e ARRSH me përfshirjen e Katiti 2, 3, 4, 5 dhe shtesës) dhe objektit “Laboratori”, me vlerë kontabël prej 3,622,664 lekë. Nga krahasimi i Hartës Treguese dt. 29.01.2019 që shoqëron Vërtetimin e Pronësisë ZVRPP Tiranë të datës 23.04.2019, me Planin e Rilevimit që shoqëron VKM nr. 788, datë 07.10.2020, konstatohen mospërputhje në pasqyrimin e objekteve ndërtimore, si vijon: Në Certifikatën për Vërtetimin e Pronësisë me nr. 1867034, datë 23.4.2019 për ZK nr. 8320, nuk janë pasqyruar dy objektet (objekti “H” sipas Plan Rilevimit që shoqëron VKM nr. 788, datë 07.10.2020, përkatësisht me sipërfaqe 401 m² dhe një shtojcë ngjitur me zyrat 2 katëshe). Për DRV Shkodër: Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion, nuk është regjistruar pronësia dhe nuk disponohen certifikata për DRV Shkodër nga ZVRPP e përfshira në këtë rajon dhe sipas pasqyrave të inventarit të dërguara në ARRSH shumica e objekteve rezultojnë të dëmtuara. Për DRJ Gjirokastër: Rezulton se bazuar në certifikatën e pronësisë sipërfaqja e trullit rezulton 3,556 m², ndërsa sipas VKM nr. 3, datë 07.01.2005 rezultojnë sipërfaqe trulli prej 2,607 m², duke mos patur përputhje të këtyre shifrave dhe arsytim të gjurmës së auditimit për diferencën e sipërfaqes së regjistruar me atë sipas VKM përkatëse. Sipas VKM nr. 789, datë 07.10.2020 është vendosur ndryshimi i përgjegjësisë së administrimit të kësaj pasurie me sipërfaqe prej 3,556 m² duke kaluar nga ARRSH te DPSHTR. Për objektet e tjera të përfshira në këtë rajon nuk disponohen certifikatat e regjistrimit të pronësisë.</p>
Kriteri:	<p>Ligji nr. 8743, datë 22.02.2001 “Për pasuritë e paluajtshme shtetërore”, i ndryshuar si dhe kërkesat e ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”.</p> <p>Ligji nr. 8743, datë 22.02.2001 “Për pasuritë e paluajtshme shtetërore”, i ndryshuar si dhe kërkesat e ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”.</p> <p>VKM nr. 155, datë 02.03.2011 dhe VKM nr. 3, datë 07.01.2005, gjë që tregon për parregullsi dhe pasaktësi dokumentare dhe bën të domosdoshëm rifreskimin e kartelave të regjistrimit të kësaj pasurie.</p> <p>UMF nr. 8, 2018, kreu 3.7, paragrafi 85, në lidhje me shënimet shpjeguese që shoqërojnë pasqyrat financiare vjetore, pasi ato nuk japin informacion të 52 përgjithshëm në lidhje me rakordimet financiare me debitorët dhe kreditorët në lidhje me elementë specifikë të pasqyrave financiare të dorëzuara, etj.</p>
Ndikimi:	<p>Parregullsitë e mësipërm ndikojnë në evidentimin e saktë dhe regjistrimin e pasurive të paluajtshme shtetërore.</p>

Shkak:	Mos regjistrimi dhe mos pajisja me dokumentacionin e duhur hipotekor.
Rëndësia:	E mesme.
8.1 Rekomandimi:	Drejtori i Përgjithshëm dhe Drejtorët e Drejtorive Rajonale të marrin masa lidhur me ndjekjen e hapave ligjorë të menjëhershëm për regjistrimin e pasurive të paluajtshme në ZVRPP/ ASHK, me qëllim pajisjen me dokumentacionin e plotë hipotekor.

Lidhur me këto veprime dhe mosveprime ngarkohen me përgjegjësi z. E. B., në cilësinë Drejtorit të Përgjithshëm të ARRSH, znj. A. Ll., në cilësinë e Drejtorit të Planifikimit të Buxhetit dhe Financës, znj. V. P., në cilësinë e Përgjegjës të Sektorit të Financës si dhe z. E. Sh., në cilësinë e Përgjegjës të Sektorit të sigurimit të Tokë.

Për sa më sipër në këtë pikë të programit të auditimit, nga ana e znj. A. Ll. Drejtore e Drejtorisë së Planifikimit të Buxhetit dhe Financës, znj. V. B. Përgjegjës e Sektorit të Financës si dhe znj. E. L. (N.) Përgjegjëse e Sektorit të Panifikimit të Buxhetit është paraqitur observacioni i administruar në KLSH me nr. 1201/14 prot., datë 25.07.2023 dhe në ARRSH me nr. 6216 prot., datë 21.07.2023 i cili në përmbajtje është i njëjtë me argumentet e paraqitura për aktin e konstatimit e për rrjedhojë edhe qëndrimi i Audituesve Shtetërorë të KLSH është i njëjtë me atë të sqaruar në Projektraportin e Auditimit.

2.4 Mbi organizimin e strukturës organizative, dhënien e pagave dhe shpërblimeve në përputhje me dispozitat ligjore. Zbatimi i ligjshmërisë gjatë procesit të rekrutimit dhe largimit të punonjësve nga puna.

1. Titulli i gjetjes:	Mos plotësimi i numrit mesatar të punonjësve.
Situata:	Sipas programit ekonomik për vitin 2020, numri mesatar i punonjësve ka qenë programuar 112 punonjës gjithsej, ndërsa sipas statistikave të punës rezulton se numri mesatar i të punësuarve në të vitit 2020 është realizuar 110 punonjës. Fondi i pagave është 86,968,000 lekë, pra realizimi është 1,617,674 lekë më pak se programi. Sipas programit ekonomik për vitin 2021, numri mesatar i punonjësve ka qenë programuar 112 punonjës gjithsej, ndërsa sipas statistikave të punës rezulton se numri mesatar i të punësuarve në të vitit 2021 është realizuar 105 punonjës. Fondi i pagave është 87,029,000 lekë, pra realizimi është 950,930 lekë më pak se programi. Sipas programit ekonomik për vitin 2022, numri mesatar i punonjësve ka qenë programuar 117 punonjës gjithsej, ndërsa sipas statistikave të punës rezulton se numri mesatar i të punësuarve në të vitit 2022 është realizuar 108 punonjës. Fondi i pagave është 85,951,461 lekë, pra është realizuar 100 %.
Kriteri:	Përcaktimet e programeve ekonomike të viteve 2020, 2021 dhe 2022.
Ndikimi:	Mos plotësimi i nevojave të ARRSH me numrin e parashikuar të punonjësve ndikon në performancën dhe në rezultatin e saj financiar.
Shkaku:	Numri i punonjësve të ARRSH - së është më i ulët se parashikimet e programit dhe për pasojë sjell mos plotësimin e nevojave të saj.
Rëndësia:	E ulët.
1.1 Rekomandimi:	Nga Drejtori i Përgjithshëm dhe Sektori i Burimeve Njerëzore të merren masa për plotësimin e nevojave për punonjës të ARRSH - së referuar parashikimeve të programit ekonomik.

2. Titulli i gjetjes:	Parregullsi në procedurat e Rekrutimit të Punonjësve dhe të dhënies të masave disiplinore.
Situata:	Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me rekrutimet e punonjësve rezulton se: - Për mënyrën e përzgjedhjes së kandidatëve për punë nga Burimet Njerëzore gjatë periudhës objekt auditimi, janë rekrutuar 24 punonjës, nga të cilët në 15 raste është shpallur vakanca e vendit të punës në faqen web dhe janë kryer procedurat e rekrutimit, pra në 62,5 % të tyre. - Nga auditimi rezulton se konstatohet se në asnjë rast nuk ka patur konkurrencë, pra ka patur vetëm një kandidat për çdo pozicion pune. - Gjatë periudhës objekt auditimi në total janë dhënë 39 masa disiplinore, nga këto 28 “Vërejtje”, 4 masa “Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna”, 1 masë “Kalim në një detyrë të një niveli apo klase më të ulët” dhe 6 masa “Pushim nga puna”. Nga auditimi i procedurës së dhënies së masave disiplinore konstatohet se nuk ka procedura transparente, pasi nuk ka të dhëna lidhur me mënyrën e marrjes të këtyre masave dhe nuk ka komision apelimi.
Kriteri:	Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i punës i Republikës të Shqipërisë”, i ndryshuar me ligj nr. 136/2015, datë 05.12.2015, neni 11, 12, 37 dhe 37.
Ndikimi:	Mos zbatimi i procedurave të rekrutimit të marrëdhëniesve të punës sipas kuadrit ligjor përkatës sjell parregullsi dhe mangësi në punësimin

	e punonjësve.
Shkaku:	Mos zbatimi i ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i punës i Republikës të Shqipërisë” dhe mangësitë në zbatimin e procedurave rekrutimit të punonjësve të rinj.
Rëndësia:	E lartë.
2.1 Rekomandimi:	Nga Drejtori i Përgjithshëm dhe Sektori i Burimeve Njerëzore, të merren masa për ndjekjen me përgjegjësi të procedurave të rekrutimit të punonjësve të rinj, dhe hartimi dhe miratimi i rregulloreve për emërimin dhe procedurat e lëvizjeve të stafit të ARRSH.
2.2 Rekomandimi:	Nga Drejtori i Përgjithshëm dhe Sektori i Burimeve Njerëzore, të merren masa për ndjekjen me përgjegjësi dhe transparencë të procedurave të dhënies së masave disiplinore, si dhe ngritjen e komisionit përkatës të apelimit.

3. Titulli i gjetjes:	Humbja e proceseve gjyqësore dhe dëmshpërblimi i ish – punonjësve për ndërprerjen e paligjshme të marrëdhënieve të punës.
Situata:	Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet se procedura e largimeve nga puna është e parregullt, konstatim ky i cili mbështetet edhe nga argumentimi si më poshtë. Konkretisht rezulton se në proceset gjyqësore në të cilat ARRSH është palë, për periudhën objekt auditimi janë në proces 7 çështje gjyqësore Gjykatën e Shkallës të Parë Tiranë dhe në Gjykatën e Apelit Tiranë, ku 4 çështje janë humbur dhe 3 janë në proces. Për periudhën objekt auditimi, lidhur me këto procese ARRSH ka paguar ish – punonjësit e saj në vlerë prej 3,233,034 lekë si dëmshpërblim për ndërprerje të paligjshme të marrëdhënieve të punës dhe shpenzime përmbartimore, duke shkaktuar kështu efekt financiar negativ.
Kriteri:	Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i punës i Republikës të Shqipërisë”, i ndryshuar me ligj nr. 136/2015, datë 05.12.2015, neni 155.
Ndikimi:	Efekt financiar negativ në shumën prej 3,233,034 lekë .
Shkaku:	Mos ndjekja e procedurave të rregullta ligjore lidhur me largimet nga puna.
Rëndësia:	E lartë.
3.1 Rekomandimi:	Nga Drejtori i Përgjithshëm, Drejtorja Juridike dhe Përputhshmërisë së Standardeve dhe Sektori i Burimeve Njerëzore të Autoritetit Rrugor Shqiptar, të merren masa për analizimin e efektit negativ në vlerën 3,233,034 lekë dhe për ndjekjen me përgjegjësi të procedurave të shkëputjes të marrëdhënieve të punës me punonjësit e saj, dhe të procedurave gjyqësore për dëmshpërblimet që mund të vijnë si rezultat i zgjidhjes së kontratës së punësimit pa shkaqe të arsyeshme, humbje të cilat janë në vlera të konsiderueshme për ARRSH.

Për sa më sipër, sipas shkresës së administruar në KLSH me nr. 1201/13 prot., datë 24.07.2023, janë bërë observacione ana e z. Th. K., znj. M. Sh. dhe znj. A. Z. të cilat në përmbajtje janë të njëjta me ato të paraqitura për aktin e konstatimit e për rrjedhojë edhe qëndrimi i Audituesve Shtetërorë të KLSH është i njëjtë me atë të sqaruar në Projektraportin e Auditimit.

2.5 Mbi zbatimin e ligjshmërisë në prokurimet e fondeve publike dhe ankandet, lidhjen dhe zbatimin e kontratave.

2.5.1 Mbi zbatimin e ligjshmërisë në prokurimet e fondeve publike⁵

- Vlerësimi i kërkesave dhe nevojave për punë, mallra dhe shërbime;
- Argumentimi dhe përlllogaritja e fondit limit sipas nevojave konkrete për punë, mallra e shërbime;
- Analizimi dhe vlerësimi i zbatimit të procedurave të prokurimit nga momenti i nxjerrjes së urdhrit të prokurimit deri në lidhjen e kontratës;

1. Titulli i gjetjes:	Përzgjedhje e gabuar e metodës së vlerësimit të ofertës.
Situata:	<p>Sipas DT rezulton se kriteri i përzgjedhjes së fituesit është përcaktuar oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto duke përdorur sistemin me pikë. Në fakt, referuar nenit 87 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, pika 4 citohet se: “Kriteret për shpalljen e kontratës fituese nuk i japin autoritetit ose entit kontraktor një liri të pakufizuar zgjedhjeje. Ato garantojnë mundësinë e konkurrencës efektive dhe shoqërohen nga specifikime, të cilat lejojnë që informacionet e dhëna nga ofertuesit të verifikohen për të vlerësuar nëse ofertat përmbushin kriteret për shpalljen e kontratës fituese ...”.</p> <p>Gjithashtu, referuar VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publikl”, neni 45 Kriteret për shpalljen e ofertës fituese, pika 3 citohet se:</p> <p>“Për punët/mallrat/shërbimet, që kanë specifikime të thjeshta, standarde teknike të mirënjohura dhe janë lehtësisht të gjendura në treg, oferta ekonomikisht më e favorshme <u>bazohet në çmimin si i vetmi element i ndryshueshëm ndërmjet ofertave</u>”.</p> <p>Përzgjedhja e metodës bazuar në kosto nuk është në përputhje me parimet kryesore të Ligjit të Prokurimit Publik.</p> <p>Kjo do të thotë se nga ana e AK do të duhet të ishin përcaktuar vetëm kriteret e veçanta të kualifikimit dhe oferta ekonomikisht më e favorshme të përzgjidhej në bazë të çmimit dhe jo të kostos pasi punimet e ndërtimit janë me standarde të njohura kombëtare e ndërkombëtare e përveç çmimit OE pjesëmarrës, praktikisht nuk kanë se me çfarë të konkurrojnë tjetër.</p>
Kriteri:	<p>Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, neni 87, pika 4 <u>ku përcaktohet se:</u></p> <p>“Kriteret për shpalljen e kontratës fituese nuk i japin autoritetit ose entit kontraktor një liri të pakufizuar zgjedhjeje. Ato garantojnë mundësinë e konkurrencës efektive dhe shoqërohen nga specifikime, të cilat lejojnë që informacionet e dhëna nga ofertuesit të verifikohen për të vlerësuar nëse ofertat përmbushin kriteret për shpalljen e kontratës fituese ...”.</p> <p>VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publikl”, neni 45 Kriteret për shpalljen e ofertës fituese, pika 3 <u>ku përcaktohet se:</u></p> <p>“Për punët/mallrat/shërbimet, që kanë specifikime të thjeshta, standarde teknike të mirënjohura dhe janë lehtësisht të gjendura në treg, oferta ekonomikisht më e favorshme <u>bazohet në çmimin si i vetmi</u></p>

⁵ Tabelat e procedurave të audituara janë pasqyruar në Aneksin nr. 3.1.

	<i>element i ndryshueshëm ndërmjet ofertave”</i>
Ndikimi:	Vendosja e kriterit të vlerësimit jo në përputhje me nevojat e investimit nuk ka rritur eficiencën dhe efikasitetin e procedurave, nuk ka arritur të sigurojë mirë përdorim të fondeve publike dhe ulje të shpenzimeve procedurale, nuk ka nxitur pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë si dhe nuk ka nxitur konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë për procedurat e prokuruar.
Shkaku:	Interpretim i gabuar i kuadrit ligjor e rregullator të procedurave të prokurimit publik.
Rëndësia:	E lartë.
1.1 Rekomandimi:	Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të ARRSH të merren masa të menjëhershme për rishikimin në procedurat e prokurimeve të zhvilluara nga ana e ARRSH, përfshirë ato në proces, të kriterit të vlerësimit të ofertës fituese me pikë si më sipër pasi kjo metodë nuk rrit eficiencën dhe efikasitetin e procedurave, nuk arrin të sigurojë mirë përdorim të fondeve publike dhe ulje të shpenzimeve procedurale, nuk nxit pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë, nuk nxit konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë dhe si e tillë krijon kushte për përdorim pa EEE të fondeve publike.

Për sa më sipër, sipas shkresës së administruar në KLSH me nr. 1201/13 prot., datë 24.07.2023, janë bërë observacione ana e anëtarëve të NJP znj. J. A., znj. Dh. L., z. G. R., z. E. A., N. M., z. B. D., znj. A. L., z. A. K., z. A. T., znj. M. Sh. dhe znj. D. Xh. të cilat në përmbajtje janë të njëjta me ato të paraqitura për aktin e konstatimit e për rrjedhje edhe qëndrimi i Audituesve Shtetërorë të KLSH është i njëjtë me atë të sqaruar në Projektraportin e Auditimit.

2. Titulli i gjetjes:	Mangësi në drejtim të vendosjes së kriterëve.
Situata:	<p>Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me procedurat e prokurimit të zhvilluara rezulton se janë vendosur kriterë të paargumentuara teknikisht dhe ligjërisht për sa i takon numrit të punonjësve të kërkuar, numrit dhe kualifikimeve të stafit kryesor teknik dhe atij mbështetës si dhe numrit dhe kapacitetit të mjeteve në disa raste. Konkretisht janë vendosur kriterë si më poshtë:</p> <p>Kriteri: <i>“Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë fuqi punëtore minimalisht ... persona.”</i></p> <p>NJP në këtë rast, përveçse ka cituar bazën ligjore (nenin 77, pika 4 të Ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”) është shprehur ndër të tjera se:</p> <p><i>“Numri i punonjësve është përcaktuar bazuar në afatin, orët e punës dhe pagën minimale të lejuar, që duhen për të përmbushur zbatimin e kontratës ...”</i></p> <p>Në fakt, sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, konkretisht procesverbaleve të argumentimit të kriterëve rezulton se nuk ka ndonjë llogaritje analitike në raport me grafikun e punimeve, kapacitet e mjeteve si dhe normativat përkatëse se prej nga ka rezultuar një numër të punësuarish në lidhje me këtë kontratë pavarësisht faktit nëse ky numër mund të jetë ose jo i mjaftueshëm.</p>

	<p>Kriteri: “Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, si më poshtë:</p> <p>Kriteri: “Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe stafin mbështetës (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë: ...</p> <p>Konstatohet se argumentimi i bërë për stafin në cilësinë e drejtuesit teknik është i njëjtë me atë të dhënë edhe për stafin mbështetës (copy – paste) dhe gjithashtu nuk është e argumentuar kërkesa për diferencimin mes stafit të kërkuar si pjesë e licencës së shoqërisë dhe atyre si staf mbështetës me kontratë, jo domosdoshmërisht në licencën e shoqërisë.</p> <p>Kriteri: “Operatoret ekonomike duhet te paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ...</p> <p>Në fakt, referuar preventivit dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion nuk rezulton i argumentuar teknikisht në çdo rast domosdoshmëria e disponimit të niveleve të kërkuara të kategorive të licencave.</p> <p>Kriteri: “Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:</p> <p>Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, konkretisht procesverbaleve të argumentimit të kriterëve rezulton se nuk ka një sqarim konkret për të argumentuar numrin llojin dhe kapacitetet e mjeteve të vendosura.</p> <p>Kriteri: “Operatori ekonomik duhet të disponojë programin “PLS CADD and TOWER”, për projektimin e linjave elektrike</p> <p>Në lidhje me këtë kriter NJP nuk ka argumentuar domosdoshmërinë që lidhet me disponimin e këtij programi pasi programi i kërkuar është një software i cili, sipas citimit të bërë nga ana e NJP, është për projektimin e linjave elektrike, kur kontrata në fjalë është e llojit Punë.</p> <p>Kriteri: “Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:</p> <p>Kriteri: “Operatori ekonomik duhet të ketë realizuar gjatë 5 (pesë) viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së përlllogaritur për QMT, sipas relacionit teknik. Ku përfshihet edhe qendër monitorimi trafiku (ndërtimi dhe pajisja, kontrolli dhe monitorimi në rrugë, tunele dhe autostrada të kësaj kategorie) të realizuara në një kontratë të ngjashme.”</p> <p>Në fakt vendosja e këtij kriteri është në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ‘Për miratimin e rregullave të prokurimit publikl’, neni 39, pika 5 pasi kjo dispozitë ligjore ka parashikuar saktësisht se cilat janë dëshmitë që do të merren në shqyrtim nga Autoritetet Kontraktore për të vlerësuar përvojën e mëparshme. Në lidhje me punët e ngjashme AK duhet të kishte kërkuar të tilla në raport vlerën e parashikuar të kontratës që prokurohet, pra në raport me fondin limit dhe jo për kategori të veçanta zërash në preventiv, apo për një zë i cili sipas relacionit teknik ka një vlerë prej 306,752,162.48 lekë, ose gati 13 % të të gjithë vlerës së parashikuar të kontratës.</p>
Kriteri:	<p>Ligji nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Neni 1, “Objekti” ku përcaktohet se:</p> <p>1. Ky ligj përcakton rregullat për procedurat e prokurimit nga autoritetet</p>

dhe entet kontraktore për kontratat publike dhe konkurset e projektimit.

2. Prokurimi, sipas kuptimit të këtij ligji, është blerja e punëve, furnizimit të mallrave ose shërbimeve nëpërmjet një kontrate publike nga ana e një ose më shumë autoriteteve ose enteve kontraktore nga operatorët ekonomikë që zgjidhen nga këto autoritete ose ente kontraktore, pavarësisht nëse punët, furnizimet e mallrave ose shërbimet përdoren ose jo për qëllime publike.

Neni 2 “Qëllimi” ku përcaktohet se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë eficiencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

Neni 3 “Parime të përgjithshme” ku përcaktohet se:

“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

Neni 21 “Autoriteti ose enti kontraktor” ku përcaktohet se:

“Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.”

Neni 77 “Kërkesat për kualifikim” ku përcaktohet se:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe

	<p>të jenë proporcionale me objektin e kontratës.”</p> <p>VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ‘Për miratimin e rregullave të prokurimit publik’, Neni 39 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike”, <u>ku përcaktohet se:</u></p> <p>“2. Specifikimet teknike shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës.</p> <p>4. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”</p> <p>39, pika 5 <u>ku përcaktohet se:</u></p> <p>“Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon:</p> <p>a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë vjetëve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;</p> <p>b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë vjetëve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.</p> <p>Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.”</p> <p>Neni 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit” <u>ku përcaktohet se:</u></p> <p>“1. Dokumentet e tenderit hartohen nga njësia e prokurimit në përputhje me këto rregulla dhe me legjislacionin në fuqi. Në hartimin e dokumenteve të tenderit, njësia e prokurimit duhet të përdorë dokumentet standarde të tenderit, sipas llojit të procedurës e të tipit të kontratës.</p> <p>2. Hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret për shpalljen e ofertës fituese (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit. Në varësi të objektit të prokurimit, nëse nuk është vlerësuar e nevojshme caktimi i një specialisti fushe, hartimi i kërkesave si më sipër bëhet nga njësia e prokurimit. Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre.”</p>
Ndikimi:	Vendosja e kriterëve jo në përputhje me nevojat e shërbimit ndikon në konkurrencën e lirë e të ndershme si dhe nuk siguron përdorim me efektivitet, eficiencës dhe ekonomikitet të fondeve të ARRSH.
Shkaku	Interpretim i gabuar i kuadrit ligjor e rregullator të procedurave të prokurimit publik.
Rëndësia:	E lartë.
2.1 Rekomandimi:	Nga ana e ARRSH të merren masa për vendosjen në procedurat e prokurimit të kriterëve të argumentuara teknikisht dhe ligjërisht si dhe në raport me nevojat e investimit me qëllim përdorim të fondeve me efektivitet, eficiencës dhe ekonomikitet.

Për sa më sipër, sipas shkresës së administruar në KLSH me nr. 1201/13 prot., datë 24.07.2023, janë bërë observacione ana e anëtarëve të NJP znj. J. A., znj. Dh. L., z. G. R., z. E. A., N. M., z. B. D., znj. A. L., z. A. K., z. A. T., znj. M. Sh. dhe znj. D. Xh. të cilat në përmbajtje janë të njëjta me ato të paraqitura për aktin e konstatimit e për rrjedhë edhe qëndrimi i Audituesve Shtetërorë të KLSH është i njëjtë me atë të sqaruar në Projektraportin e Auditimit.

3. Titulli gjetjes:	i Lidhje e kontratës jo sipas kushteve të parashikuara të DT.
Situata:	Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt <i>‘Ndërtimi i Unazës së jashtme Tiranë, Loti 4’</i> , rezulton se pavarësisht faktit se BOE i shpallur fitues ka deklaruar në ofertën e tij në SPE se garancia e punimeve do të jetë 3 vite nga data e kolaudimit të punimeve, kontrata e lidhur sipas aktit me nr. 7354/6 prot., datë 11.11.2021, në Kushtet e Veçanta të Kontratës, neni 11 <i>Garancia e defekteve</i> , ka cituar se kjo periudhë do të zgjas 2 vite.
Kriteri:	Ligji nr. 162/2020 <i>“Për Prokurimin Publik”</i> neni 122, pika 1 <u>ku përcaktohet se:</u> <i>“Kushtet e kontratës të lidhur sipas këtij ligji nuk ndryshojnë nga ato të përshkruara në dokumentet e tenderit dhe në ofertën fituese, me përjashtim të rasteve kur kontraktori, për arsye objektive dhe të pavarura prej tij në kohën e ofertimit ofron, me të njëjtin çmim, kushte më të mira se ato të tenderuara.”</i>
Ndikimi:	Ndryshimi i kushteve të kontratës pas shpalljes fitues denatyrton procesin e prokurimit, kjo për vet faktin se BOE është kualifikuar dhe shpallur fitues përmes deklaratave të bërë në fazën e ofertimit.
Shkaku	Mungesa e kontroleve nga punonjësit e ngarkuar në konceptimin e kontratës së lidhur mes palëve.
Rëndësia:	E ulët.
3.1 Rekomandimi:	Nga ana e ARRSH të merren masa për modifikimin e kontratës së lidhur sipas aktit nr. 7354/6 prot., datë 11.11.2021, të Kushteve të Veçanta të Kontratës, konkretisht nenit 11 <i>Garancia e defekteve</i> , duke ndryshuar periudhën e garancisë nga 2 në 3 vite, aq sa ka ofruar fituesi i kësaj procedure BOE E... P... & P...U & N... K.... 2.

4. Titulli gjetjes:	i Kualifikim dhe shpallje fitues e OE me mangësi në dokumentacion.
Situata:	Sipas dokumentacionit të ngarkuar në SPE nga ana e OE fitues rezulton se në 2 raste, konkretisht në procedurat me objekt: 3. <u>Ndërtimi i Unazës së jashtme Tiranë, Loti 2</u> Nga ana e BOEnuk përmbushet kriteri në lidhje me disponimin e licencave sipas përqindjes së punimeve të marra përsipër, kjo pasi sipas kontratës së bashkëpunimit të përkohshëm mes shoqërive me nr. 5428 rep. 1206 kol., datë 15.09.2021, nga ana e OE I.. K... janë marrë përsipër të kryhen 95 % e punimeve nën kategorinë e licencës NS-19 <i>Sisteme kundër zhurmës</i> për të cilën NJP ka përllogaritur shumën prej <u>121,541,840 lekë</u> . Referuar vlerës përkatëse, OE I.. K... i takon një vlerë punimesh prej 115,464,748 lekë ($0.95 \times 121,541,840$), ose kategoria D e licencës NS-19.

	<p>Në fakt kjo shoqëri disponon kategorinë C të NS-19 e si e tillë kjo kompani nuk përmbush kriterin në lidhje me disponimin e licencës profesionale në raport me punën e marrë përsipër dhe si e tillë duhet të ishte s'kualifikuar.</p> <p>4. <u>Përmirësimi i sinjalistikës horizontale, vertikale dhe pajisjeve të sigurisë rrugore në akset e Rajonit Verior, Loti 1</u></p> <p>Në përfundim të procedurës së prokurimit është shpallur fitues OE J... me të cilin sipas shkresës me nr. 4122/6 prot., datë 31.05.2022 është lidhur kontrata përkatëse e sipërmarrjes së punimeve me vlerë 217,200,000 lekë me TVSH. Sipas dokumentacionit të ngarkuar në SPE si dhe atij të ndodhur në dosje, OE D... është deklaruar si nënkontraktor në fazën e ofertës me një angazhim në drejtim të realizimit të kontratës prej 40 %. Pas shpalljes fitues, me aktin nr. 3558 rep. 1695 kol., datë 20.05.2022 është lidhur kontrata e sipërmarrjes (Kontratë sipërmarrje për kryerje punimesh) mes OE J... dhe OE D... sipas të cilës palët kanë ndarë mes tyre edhe zërat e punimeve. Nisur nga volumet dhe vlerat përkatëse të punimeve të marra përsipër nga ana e nënkontraktorit të punimeve, rezulton se ky i fundit nuk plotëson kriterin në lidhje me disponimin e licencave sipas zërave respektivë të marrë përsipër në kontratën e sipërmarrjes. Konkretisht OE D... nuk disponon licencën NS-6/D <i>Sinjalistika rrugore jo ndriçuese</i>, pasi sipas përqindjes dhe volumeve të marra përsipër rezulton një vlerë në diapazonin e punimeve mes 51,000,000 – 100,000,000 lekë.</p>
<p>Kriteri:</p>	<p>Ligji nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Neni 80, <i>“Parimet e procesit të përzgjedhjes” ku përcaktohet se:</i></p> <p><i>“1. Kontratat jepen mbi bazën e kriterëve të përcaktuara, pasi autoriteti ose enti kontraktor të ketë verifikuar që janë përmbushur të gjitha kushtet e mëposhtme:</i></p> <p><i>a) oferta përmbush kërkesat, kushtet dhe kriteret e përcaktuara në njoftimin e kontratës ose në ftesën për ofertë dhe në dokumentet e tenderit, duke marrë në konsideratë, sipas rastit, variantet e paraqitura;</i></p> <p><i>b) operatori ekonomik, që ka dorëzuar ofertën, përmbush kriteret e kualifikimit e të përzgjedhjes dhe nuk ndodhet në ndonjë nga situatat që përbëjnë shkak për skualifikim.</i></p> <p><i>2. Autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin refuzimin e ofertës, pavarësisht vlerës së saj, nëse vlerësohet se oferta e paraqitur nuk është në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga zbatimi i legjislacionit vendas, marrëveshjeve ndërkombëtare ose legjislacionit vendas në fushën e mjedisit, mbrojtjes shoqërore dhe punës.</i></p> <p><i>3. Autoritetet ose entet kontraktore i shqyrtojnë ofertat e paraqitura bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga operatorët ekonomikë dhe legjislacionin përkatës në fuqi.</i></p> <p><i>4. Në çdo rast, nëse autoriteti ose enti kontraktor vihet në dijeni të një fakti që është kusht për skualifikimin e operatorit ekonomik të shpallur fitues, deri në momentin e lidhjes së kontratës merr vendim për skualifikimin e tij sipas parashikimeve në këtë ligj..”</i></p> <p><i>Neni 3 “Parime të përgjithshme” ku përcaktohet se:</i></p> <p><i>“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.</i></p> <p><i>2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e</i></p>

	<p>zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.</p> <p>3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”</p> <p>Neni 92, “Shqyrtimi i Ofertave”, <u>ku përcaktohet se:</u></p> <p>Pika 3:</p> <p>“Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji;”</p> <p>VKM nr. 285, datë 19.5.2021 ‘Për miratimin e rregullave të prokurimit publik’, neni “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”.</p> <p>“2. Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme.”</p> <p>Neni 89 Nënkontraktimi <u>ku përcaktohet se:</u></p> <p>“1. Përpara lidhjes së kontratës, ofertuesi i shpallur fitues duhet t’i dorëzojë autoritetit/entit kontraktor një kopje të noterizuar të marrëveshjes së nënkontraktimit. Nënkontraktori duhet të plotësojë kërkesat e nenit 76, të LPP, dhe të plotësojë kriteret e kualifikimit për pjesën e punës/shërbimit/mallrave që merr përsipër të furnizojë. Komisioni i vlerësimit të ofertave vlerëson nëse nënkontraktori plotëson këto kërkesa, në mënyrë që autoriteti/enti kontraktor të mund të miratojë nënkontraktimin.”</p> <p>- Rregulloren e Përgjithshme të punës;</p>
Ndikimi:	Kualifikimi dhe shpallja fitues e Operatorëve Ekonomikë të cilët nuk përmbushin kriteret e vendosura për kualifikim nuk siguron përdorim me efektivitet, efizienz dhe ekonomicitet të fondeve të ARRSH.
Shkaku	Veprimet dhe mosveprimet e anëtarëve të KVO.
Rëndësia:	E lartë.
4.1 Rekomandimi:	Nga ana e ARRSH të merren masa për kualifikimin e operatorëve të cilët përmbushin plotësisht dhe saktësisht kriteret e vendosura me qëllim shmangien e përdorimit pa efektivitet, efizienz dhe ekonomicitet të fondeve.

Për sa më sipër, sipas shkresës së administruar në KLSH me nr. 1201/13 prot., datë 24.07.2023, janë bërë observacione ana e anëtarëve të KVO znj. A. H., z. B. D., znj. M. Sh., znj. A. Ll., znj. A. S., znj. A. L., z. G. R., znj. A. G., z. G. N. dhe znj. K. K. të cilat në përmbajtje janë të njëjta me ato të paraqitura për aktin e konstatimit e për rrjedhojë edhe qëndrimi i Audituesve Shtetërorë të KLSH është i njëjtë me atë të sqaruar në Projektraportin e Auditimit.

Grupi i auditimit ka marrë në konsideratë pjesërisht observacionet në lidhje me mbështetjen në kapacitetet financiare të OE tek një OE tjetër ekonomik pas argumentimeve të dhëna, por

duhet të theksojnë këtu se në vijimësi mbështetje të tilla duhet të kryhen sipas kontributit të OE në drejtim të realizimit të kontratës.

<p>6. Titulli i gjetjes:</p>	<p>Përfshirje e detyrës së projektimit brenda një kontrate e llojit <i>Punë</i>.</p>
<p>Situata:</p>	<p>Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se me Urdhër nr. 169 datë 06.08.2021 është ngritur Grupi i Punës për hartimin e Termave të Referencës (ToR) për Qendrën e Monitorimit të Trafikut (QMT), nga ana e të cilit janë hartuar këto terma, pjesë e dosjes së procedurës së prokurimit. Këto terma referenca i kanë diktuar firmës sipërmarrëse hartimin e detyrës së projektimi në lidhje me këtë qendër monitorimi ku konkretisht citohet se:</p> <p><i>“Për të minimizuar risqet e sigurisë rrugore në vepër, lind nevoja e hartimit të detyrës si të projektimit të sistemeve ndihmëse në vepër, (sistemet e mbrojtjes ndaj zjarrit dhe evakuimit, sistemet e ventilimit, sinjalizimin elektronik dhe sistemet e monitorimit të trafikut etj.), ashtu dhe të implementimit të tyre në mënyrë që vepra të jetë plotësisht funksionale dhe në standardet më të larta evropiane e ndërkombëtare.”.</i> Më tej këto ToR citojnë si objektivi të detyrës se OE duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Të japë aspektet e përgjithshme ku duhet të bazohet për të hartuar ofertën teknike ekonomike për projektimin dhe zbatimin e të gjithë sistemeve të nevojshme referuar legjislacionit në fuqi për sigurinë në tunelet rrugore si dhe nevojave sipas rastit të evidentuara nga shqyrtimi i projektit aktual të veprës në tërësi.</i> - <i>Të propozojë rekomandimet për zgjedhjen e tipit më të përshtatshëm të masave për minimizimin e risqeve për drejtuesit e mjeteve për pjesën e tubave të nënkalimeve dhe kalimet në nivel (për mjetet dhe këmbësorët) si dhe koordinimin e sistemit të menaxhimit të trafikut dhe sinjalizimit për të gjithë veprën.</i> - <i>Të përcaktojë standardet dhe kërkesat ku duhet të bazohet ofertuesi për të hartuar projektin dhe realizuar ndërtimin e veprës e harmonizuar dhe në koherencë me gjendjen faktike të realizimit të punimeve dhe problematikave të hasura në vepër.</i> - <i>Të përcaktojë sasinë e përafërta të punimeve, zërat e mundshëm të punimeve dhe çmimet orientuese për të realizuar një preventiv paraprak (referuar eksperiencave të ngjashme në këtë fushë)”</i> <p>Gjithashtu, ky material ka diktuar edhe kërkesat për projektin e zbatimit, konkretisht:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. <i>Lidhja e qendrës me linjat e furnizimit me energji të përshtatshme sipas fuqisë së parashikuar të instalimeve;</i> 2. <i>Skema Rrjet-Gjenerator për të siguruar furnizim të vazhduar me energji elektrike në mënyrë që mos ketë ndërprerje të operimit të tuneleve;</i> 3. <i>Sistemet e detektimit të zjarrit në tunele;</i> 4. <i>Monitorimi i pompave të ujit për shkarkimin e vaskave;</i> 5. <i>Sistemi i Kontrollit të Trafikut dhe Tabelat Elektronike me Mesazhe Variabël (VMS);</i> 6. <i>Mbi ndërtimin e rrjetit të sinjalistikës elektronike;</i> 7. <i>Sistemi i mbrojtjes ndaj zjarrit</i> 8. <i>Sistemi i ventilimit</i>

9. Godina dhe Salla e Monitorimit dhe Komandimit (Muri i monitorëve)
10. Dhoma e Serverit
11. Rrjeti LAN i komunikimit
12. Sistemi SCADA
13. Sistemi CCTV
14. Stacionet Meteorologjike për monitorimin e kushteve klimaterike:
15. Numëruesit e Trafikut:

Në kapitullin X Volumet e Punës dhe Preventivi të këtij materiali është cituar se:

“Për hartimin e preventivit është bërë referim në punimet e ngjashme që janë realizuar në Shqipëri si dhe janë krahasuar këto punime me shumatoren e punimeve elektromekanike të tuneleve apo projekteve të tuneleve në vend. Zërat e punimeve të ndërtimit dhe sasi të paraprake janë bazuar në preventivët e projektuesve të punëve të ngjashme. Ofertuesi nuk është i kufizuar vetëm në këto zëra, mund të shtojë zëra të rinj ose të ndryshojë sasi të paraprake të llogaritjes referuar projektit përfundimtar. Ofertuesi duhet të përfshijë në preventiv vlerat e projektimit, ndërtimit, instalimit, monitorimit e riparimit të defekteve brenda afatit të garancisë objektit.”

Në fakt, sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se vlera e punimeve në shumën prej 368,102,594.97 lekë me TVSH është caktuar pa një referencë konkrete por vetëm (kjo pavarësisht citimit të preventivit ku është shprehur se vlera krahasuese i është referuar projekt zbatimit të tunelit të Llogorasë, seksioni Elektromekanike) duke përfshirë 4 kategori si më poshtë:

Nr.	Përshkrimi i punimeve	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera
1	Pajisjet E&M, kostot e përgjithshme + Projekt	lump sum	1	34,366,039. ²³	34,366,039. ²³
2	Sistemi i Ventilimit të Tunelit	lump sum	1	90,457,610. ⁷¹	90,457,610. ⁷¹
3	Sistemet mekanike	lump sum	1	24,228,992. ³¹	24,228,992. ³¹
4	Sistemi Elektrik	lump sum	1	157,699,520. ²³	157,699,520. ²³
SHUMA					306,752,162.⁴⁸
TVSH					61,350,432.⁵⁰
TOTAL					368,102,594.⁹⁷

Në këtë rast AK ka përzgjedhur Kontratë për punë publike dhe mënyra e prokurimit ka qenë Punime me matje dhe jo Kontratë me çelësa në dorë e për këtë arsye nuk duhet të ishte përfshirë në këtë kontratë edhe projektimi i kategorive si më sipër nga ana e sipërmarrësit.

Kriteri:

VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ‘Për miratimin e rregullave të prokurimit publikl’, neni 12 Metoda të zbatueshme në përllogaritjen e vlerës së kontratës, pika 4 ku përcaktohet se:

“Autoriteti/enti Kontraktor, në fazën e hartimit të nevojave për mallra, punë ose shërbime mban në konsideratë, metodat e përllogaritjes së vlerës së prokurimit. Vlera e përllogaritur e prokurimit duhet të jetë vlerë reale e përllogaritur përpara nxjerrjes së urdhrat të prokurimit.”

Neni 13 Studimi paraprak i tregut, ku përcaktohet se:

“1. Përpara se të nisë një procedurë prokurimi, autoriteti/enti Kontraktor mund të studiojë tregun, me qëllim që të përgatisë prokurimin, të përditësojë të dhënat që ka përdorur për hartimin e buxhetit dhe regjistrave të parashikimit, si dhe të informojë operatorët ekonomikë për

planet dhe kërkesat e tyre për prokurim.

2. Studimi i tregut ka për qëllim përlllogaritjen e një vlere reale të kontratës dhe të shmangë dështimin e procedurës për vlera që nuk përputhen me vlerat reale të tregut.

3. Autoriteti/enti Kontraktor, në varësi të natyrës së objektit të prokurimit ngarkon me detyrë për studimin e tregut, një ose disa persona, që mund të jenë një grup pune i ngritur për këtë qëllim çdo fillim viti ose rast pas rasti.

4. Për studimin e tregut, autoriteti/enti kontraktor, mund të konsultohet me ekspertë, autoritete të pavarura ose operatorët ekonomikë në treg me shkrim ose verbalisht. Në rastin e konsultimit verbalisht, grupi i ngritur për këtë qëllim harton një procesverbal me këto të dhëna. Këto këshilla mund të përdoren në planifikimin dhe kryerjen e procedurës së prokurimit, nëse nuk rezultojnë në shtrembërimin e konkurrencës dhe cenojnë parimet e mosdiskriminimit dhe të transparencës. Autoriteti/enti kontraktor duhet të kujdeset që konsultimi të jetë sa më gjithëpërfshirës dhe të shmangë dhënien e çdo informacioni preferencial, që mund të favorizojë operatorë të caktuar në përgatitjen e ofertës për procedurën e prokurimit.

5. Në çdo rast, duhet të shmanget rreptësisht çdo konflikt interesi apo edhe shfaqja e një konflikti interesi, në marrëdhëniet e punonjësit të angazhuar në procesin e prokurimit dhe operatorit ekonomik. Zyrtarët e përfshirë në studimin e tregut duhet të plotësojnë deklaratën për situatën e konfliktit të interesit.”

Neni 39 Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike, pika 1 ku përcaktohet se:

“1. Punët publike mund të prokurohen:

a) me anë të punimeve me matje, në bazë të çmimeve fikse, në rastet kur vëllimi i punëve të specifikuara në projektpreventiv mund të ndryshojë gjatë realizimit. Në këtë rast, kontraktori është i detyruar të ruajë, pa asnjë ndryshim çmimet për njësi të përcaktuara në ofertën e dorëzuar. Kur punët prokurohen me anë të punimeve me matje, vëllimi i punëve jepet me hollësi dhe përmban të gjitha çmimet dhe përqindjet që autoriteti/enti kontraktor i vlerëson të nevojshme (si për shembull: fondi rezervë, të ardhurat minimale, shpenzimet minimale).

b) me kontratë me çelësa në dorë:

i. Ku vëllimi i punëve i parashikuar në projektpreventiv mund të shërbejë vetëm si një orientim dhe ofertuesi kryen një studim të hollësishëm të projektit, pa asnjë detyrim për të respektuar vëllimin e punëve të projektit. Në këtë rast, kontraktori ka përgjegjësinë e realizimit të punëve, pa kërkuar asnjë fond shtesë, përveç vlerës së kontratës së prokurimit, që në çdo rast, përfshin të gjitha detyrimet fiskale në fuqi.

ii. Kur autoriteti kontraktor nuk ka hartuar projektpreventiv, por ka vetëm një projektide apo detyrë projektimi dhe terma reference për objektin që prokuron. Në këtë rast, autoriteti kontraktor kërkon nga kontraktori hartimin e projektpreventivit, si dhe realizimin e punimeve të zbatimit të këtij projekti, pas miratimit paraprak të tij nga autoriteti kontraktor. Autoriteti/enti kontraktor duhet të kërkojë nga ofertuesit disponimin e kapaciteteve teknike për realizimin e secilës fazë të sipërcituar: për hartimin e projektit, si dhe për realizimin e tij, duke lejuar edhe mundësinë që projektimi mund të nënkontraktohet apo që ofertuesi (zbatuesi i

	<i>punimeve) të paraqesë kontratë bashkëpunimi me subjekte që operojnë në fushën e projektimit dhe që plotësojnë të gjitha kriteret e hartuara nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë qëllim. Në këtë rast kontraktori ka përgjegjësinë e realizimit të punëve, sipas projektpreventivit të miratuar paraprakisht nga autoriteti kontraktor, pa kërkuar asnjë fond shtesë, përveç vlerës së kontratës së prokurimit, që në çdo rast, përfshin të gjitha detyrimet fiskale në fuqi.”</i>
Ndikimi:	Përzgjedhja e gabuar e mënyrës së përlllogaritjes së vlerës së fondit limit si dhe mënyrë së prokurimit nuk siguron konkurrencën maksimale të mundshme përgjatë procedurës së prokurimit.
Shkaku	Interpretim i gabuar i kuadrit ligjor e rregullator të procedurave të prokurimit publik.
Rëndësia:	E mesme.
6.1 Rekomandimi:	Nga ana e ARRSH të merren masa, për ato raste në të cilat për reference merren kontratat e mëparshme, që përlllogaritja e vlerës së fondit limit të investimeve të kryhet bazuar në zërat konkretë të këtyre praktikave të mëparshme dhe jo në kategori preventivash pasi kategorizimi nuk përkrahuan saktë zërat konkretë që përfshin.
6.2 Rekomandimi:	Nga ana e ARRSH të merren masa për të identifikuar dhe ndjekur saktë rastet në të cilat duhen ndjekur metoda e prokurimit <i>Punime me matje</i> apo <i>Kontratë me çelësa në dorë</i> me qëllim realizimin e një procedure prokurimi efikase.

2.5.2 Mbi zbatimin e kontratave

7. Titulli i gjetjes:	i Mangësi në drejtim të përmbushjes së deklarimeve të bëra gjatë fazës së ofertave.
Situata:	<p>Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me procedurën e prokurimit dhe të zbatimit të kontratës me objekt <i>Plotësimi, rakordimi dhe vazhdimi i punimeve Sheshi Shqiponja – Lumi i Tiranës, Loti 1 dhe QMT</i>, në përfundim të procedurës është shpallur fitues OE S... me të cilin sipas aktit nr. 9729/7 prot., datë 24.12.2021 është lidhur kontrata përkatëse e punimeve me Titullarin e AK me vlerë të kontratës 2,736,853,766 lekë me TVSH. Nga ana e Titullarit të AK janë caktuar mbikëqyrësit e punimeve z. G. N. me nr. licence MK.2352/1 dhe znj. D. Sh. me nr. licence MK.0910/2. Në fakt rezulton se nga ana e inxhinierëve të caktuar nuk disponohen disa prej kategorive të licencës NP-12 <i>Punime inxhinierike mjedisore</i>, NS-5 <i>Impiante të sinjalistikës ndriçuese të trafikut</i>, NS-12 <i>Pajisje termike, teknologjike dhe të kondicionimit</i>, NS-13 <i>Pajisje të linjave telefonike dhe telekomunikacionit</i>, NS-14 <i>Pajisje të brendshme, elektrike, të telefonisë, radiotelefonike, televizive</i>, dhe NS-18 <i>Punime topogjeodezike</i>.</p> <p>Me shkresën e administruar në ARRSH me nr. 11742/2 prot., datë 30.12.2021 nga ana e sipërmarrësit të punimeve është njoftuar fillimi i punimeve në datën 24.12.2021. Sipas korrespondencave rezulton se në datën 24.12.2021 është bërë akti i dorëzimit të sheshit (i cili ka rezultuar pjesërisht i lirë në momentin e dorëzimit të tij), është mbajtur akti i piketimit të objektit si dhe procesverbali i fillimit të punimeve. Këto tre akte rezultojnë të jenë firmosur nga ana e përfaqësuesit të AK znj. A. S., nga ana e mbikëqyrësit të përkohshëm z. G. N., sipërmarrësi i punimeve z.</p>

	<p>L. S... si dhe Drejtuesi Teknik i OE S... z. T. B.. Sipas aktit me nr. 769/2 prot., datë 09.03.2022 është lidhur kontrata e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve me OE A ... E.... me përfaqësues ligjor znj. E. Ç. me vlerë të kontratës 21,600,000 lekë me TVSH. Sipas shkresës nr. 9729/7 prot., datë 28.12.2021 i është dorëzuar nga ana e Drejtorit të Drejtorisë së Ndërtimit dhe Mirëmbajtjes Plani i Zbatimit të Kontratës Drejtorisë Juridike dhe Përputhshmërisë së Standardeve.</p> <p>Sipas raporteve mujore të hartuara nga ana e mbikëqyrësit të punimeve rezultoi se nga ana e OE S... nuk është angazhuar si drejtues teknik ing. T. B., sipas deklaratës së bërë në zbatim të kërkesës 2.3.7 të DT por është vendosur ing. T. M..</p>
Kriteri:	<p>Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, neni 87, pika 4 <u>ku përcaktohet se:</u></p> <p><i>“Kriteret për shpalljen e kontratës fituese nuk i japin autoritetit ose entit kontraktor një liri të pakufizuar zgjedhjeje. Ato garantojnë mundësinë e konkurrencës efektive dhe shoqërohen nga specifikime, të cilat lejojnë që informacionet e dhëna nga ofertuesit të verifikohen për të vlerësuar nëse ofertat përmbushin kriteret për shpalljen e kontratës fituese ...”.</i></p>
Ndikimi:	<p>Ndryshimi i kushteve të kontratës pas shpalljes fitues denatyrton procesin e prokurimit, kjo për vet faktin se OE S... është kualifikuar dhe shpallur fitues përmes deklaratave të bërë në fazën e ofertimit.</p>
Shkaku	<p>Mungesa e kontroleve nga ana e mbikëqyrësit të punimeve si dhe punonjësve të ngarkuar.</p>
Rëndësia:	<p>E mesme.</p>
7.1 Rekomandimi:	<p>Nga ana e ARRSH të merren masa për përzgjedhjen në cilësinë e mbikëqyrësve të përkohshëm të kontratave të punimeve të atyre punonjësve të cilët disponojnë të gjitha kategoritë dhe nivelet e nevojshme të licencave për të realizuar një shërbim efektiv dhe të plotë, në përputhje me nevojat që dikton edhe natyra e investimeve.</p>
7.2 Rekomandimi:	<p>Nga ana e ARRSH të merren masa për tu siguruar se nga ana e sipërmarrëse janë angazhuar mjete dhe staf sipas deklarimeve të bëra nga ana e OE gjatë fazës së ofertimit. Zëvendësimet e tyre të shoqërohen me dokumentacionin e nevojshëm e të mjaftueshëm justifikues, duke siguruar kështu edhe një gjurmë të mjaftueshme auditimi.</p>

Për sa më sipër, sipas shkresës së administruar në KLSH me nr. 1201/13 prot., datë 24.07.2023, janë bërë observacione nga ana e z. G. N. si dhe znj. D. Sh. të cilat në përmbajtje janë të njëjta me ato të paraqitura për aktin e konstatimit e për rrjedhojë edhe qëndrimi i Audituesve Shtetërorë të KLSH është i njëjtë me atë të sqaruar në Projektraportin e Auditimit.

Kontrata me objekt “Ndërtim rruga Kardhiq – Delvine, Loti 8 (Sinjalistikë dhe Siguri rrugore nga loti 1 deri në lotin 6)”

Historiku i zbatimit të punimeve

Në përfundim të procedurës së prokurimit, është shpallur fitues OE J... me nr. licence për zbatim punimesh NZ. 0340/19 datë 12.07.2021 me të cilin është lidhur kontrata me Autoritetin Kontraktor me nr. 1474/2 prot., datë 09.03.2022 me vlerë 264,000,001 lekë me TVSh dhe me afat të zbatimit të punimeve 3.5 muaj nga data e lidhjes së kontratës.

Për mbikëqyrjen e punimeve, sipas shkresës nr. 1473/2 prot., datë 16.03.2022, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me OE S...O, me përfaqësues ligjor znj. A. M. me vlerë të kontratës 2,949,970 lekë me TVSH.

Në datë 17.03.2022 është bërë akti i dorëzimit të sheshit të ndërtimit si dhe njoftimet nga firma dhe mbikëqyrësi për fillimin e punimeve.

Me vendim nr. 19 administruar në ARRSH me nr. 4043/2 prot., datë 25.04.2022 është miratuar propozimi i sipërmarrësit për rritjen e volumeve të kontratës dhe vlerës respektive në shumën 51,292,399 lekë me TVSH, amendim i cili është formalizuar sipas aktit me nr. 7042/2 prot., datë 29.06.2022 duke amenduar afatin e përfundimit të punimeve me 30 ditë nga data e nënshkrimit të këtij amendamenti.

Me shkresën nr. 26.07.2022 nga ana e sipërmarrësit është njoftuar përfundimi i punimeve në datë 26.07.2022, datë në të cilën është mbajtur edhe procesverbali përkatës si dhe njoftimi nga ana e mbikëqyrësit të punimeve.

Punimet e përfunduara janë kolauduar në datë 19.08.2022 nga Grupi i Ngritur me Urdhër të Titullarit me nr. 188 prot., datë 04.08.2022 me përbërje të Grupit të Kolaudimit znj. A. B., znj. M. H. dhe z. N. H..

Kontrata me objekt “Stabilizimi i qëndrueshmërisë të trupit të rrugës në aksin rrugor Vlorë – Orikum (zona Jonufër – Nimfa)”

Historiku i zbatimit të punimeve

Në përfundim të procedurës së prokurimit, është shpallur fitues BOE G... C... & G... L... me të cilin është lidhur kontrata me Autoritetin Kontraktor sipas shkresës me nr. 5002/8 prot., datë 03.06.2021 me vlerë 86,054,400 lekë me TVSH dhe me afat të zbatimit të punimeve 3.5 muaj nga data e lidhjes së kontratës. Mbikëqyrja e punimeve është kryer nga ing. N. M., punonjës i ARRSH me nr. licence për mbikëqyrje dhe kolaudim punimesh MK.0514 i caktuar me Urdhër të Titullarit sipas aktit me nr. 6207/5 prot., datë 05.07.2021. Sipas korrespondencave rezulton se punimet kanë nisur me datë 06.07.2021. Nisur nga fakti se kontrata është prokuruar si e llojit *Me çelësa në dorë* rezulton se projekti është hartuar nga ana e studios së projektimit N.....S, e kontraktuar kjo nga vet BOE G... C... & G... L.... Projekti ka marrë miratimin përmes VKT nr. 21 me nr. 6207/1 prot., datë 01.07.2021. Punimet kanë përfunduar me datë 17.09.2021, pra brenda afatit të parashikuar në kontratë. Kolaudimi i punimeve është kryer nga ana e Grupit të ngritur me Urdhër nr. 339, datë 24.12.2021 të Titullarit me përbërje të grupit z. A. Q. dhe znj. M. H. sipas procesverbalit përkatës në datë 29.12.2021.

8. Titulli i gjetjes:	Përdorim pa EEE i fondeve në kontratat publike të llojit <i>Me çelësa në dorë</i> .
Situata:	Nga krahasimi i zërave të likuiduar e me ato të situacionuara e të pasqyruara në librezën e masave rezultojnë diferenca në volume me pasojë përdorim pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet fondet në shumën prej 10,376,373.5 lekë pa TVSH si rrjedhojë e përdorimit të çmimeve të preventivit të hartuar nga ana e projektuesit mbi ato të parashikuara nga manuali teknik i çmimeve të punimeve të ndërtimit në fuqi. Nga auditimi rezulton se projekti i hartuar nga ana e projektuesit të kontraktuar nga BOE G... C... & G... L... nuk i është referuar parashikimeve ligjore në drejtim të hartimit të preventivit të punimeve. Konkretisht, vlerat e mësipërme pasqyrohen të detajuara në Aneksin nr. 3.2.
Kriteri:	Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, <u>ku përcaktohet se:</u> neni 7/1: “Mbikëqyrësi/grupi i mbikëqyrësve të punimeve është i detyruar të kontrollojë dhe është përgjegjës për zbatimin e punimeve të ndërtimit në

përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të projektimit, të zbatimit, si dhe destinacionin e objektit. Ai është i detyruar të kontrollojë librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë, vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit.”

Neni 5/1 Përgjegjësia e projektuesit:

Pika 1: “Projektuesi është përgjegjës për hartimin e studimeve e të projekteve në përputhje me detyrën e projektimit, me dokumentet e planifikimit e të kontrollit të zhvillimit dhe me legjislacionin në fuqi që rregullon veprimtarinë e ndërtimit në Republikën e Shqipërisë, përfshirë dispozitat antisizmike, të sigurisë, mbrojtjes nga zjarri, higjieno-sanitare, si dhe eficientë energjetike.”

Pika 3: “Çdo projektues ose grup projektimi është i detyruar të lidhë një kontratë të sigurimit të përgjegjësisë profesionale për çdo dëm që mund të shkaktohet si pasojë e veprimtarisë së tij dhe duhet të mbulojë të paktën dëmet e mëposhtme:

a) çdo shpenzim të nevojshëm e të domosdoshëm të projektimit të ri, si dhe shpenzimet shitesë të kryera nga zhvilluesi ose organet e administratës publike, që kanë rrjedhur si pasojë e gabimeve në projektim;

b) kostot shitesë që mund të lindin për zhvilluesin, si pasojë e gabimeve në projektim gjatë zbatimit të projektit.”

Neni 12, ku përcaktohet se:

“Të gjitha objektet e përkufizuara në nenin 3 duhet t'i nënshtrohen kolaudimit tekniko-ekonomik, i cili ka për qëllim të verifikojë nëse:

1. objekti është realizuar në kushtet teknike;
2. objekti është realizuar në përputhje me kontratën dhe anekset e saj;
3. çmimet e aplikuara janë sipas përcaktimeve të kontratës;
4. në këtë akt verifikohen edhe kërkesat e zbatuesit të paraqitura gjatë zbatimit të punimeve

Udhëzimi nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, ku përcaktohet se:

Pika 8.1: “Situacionet pjesore hartohen në lloje, zëra, sasi, çmim e vlerë, sipas kontratës dhe ndryshimeve të urdhëruara nga investitori. Zërat, sasitë, çmimet jashtë kontratës dhe përdorimi i fondit rezervë në situacionin përfundimtar justifikohen me dokumentacionin përkatës”.

Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënparagrafi 3.2 dhe 3.3 ku përcaktohet se:

“3.2 Libreza e masave për punimet e ndërtimit është dokumentacioni bazë për verifikimin e saktësisë së vëllimeve të punimeve të ndërtimit, të vendosura në situacion. Kjo librezë hartohet nga drejtuesi teknik i objektit dhe firmoset nga ai, nga mbikëqyrësi i punimeve dhe nga përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit, për të cilin është miratuar leja e ndërtimit.

3.3 Situacionet mujore pjesore, progresive dhe përfundimtare hartohen mbi bazën e volumeve të llogaritura në librezën e masave dhe çmimeve faktike, mbështetur në analizat teknike të çmimeve, që përfshihen në manualin teknik të çmimeve të ndërtimit, të miratuara çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave. Ato firmosen nga drejtuesi teknik i objektit, mbikëqyrësi i punimeve dhe përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit për të cilin është miratuar leja e ndërtimit. Në rastet kur në manualin teknik të çmimeve të ndërtimit mungojnë analizat teknike të çmimeve të zërave të

	<p><i>punimeve të kryera në objekt, veprohet në përputhje me procedurën e përcaktuar në pikën 8 të vendimit nr. 514, datë 15.8.2007 të Këshillit të Ministrave “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”;</i></p> <p><i>Udhëzimi nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar e konkretisht Kreu II, Pika 3 <u>ku përcaktohet se:</u></i></p> <p><i>Kolaudatori ose grupi i kolaudimit duhet të verifikojë me përgjegjësi:</i></p> <p><i>a. Realizimin e objektit, në përputhje me projektin, lejen e ndërtimit, standardet dhe rregullat teknike.</i></p> <p><i>b. Realizimin e objektit, në përputhje me kontratën e nënshkruar.</i></p> <p><i>c. Përputhjen e dokumenteve me të dhënat nga matjet në dimension, formë, sasi dhe cilësi.</i></p> <p><i>ç. Përputhjen e vlerës së preventivuar dhe të kontraktuar me atë të paraqitur në situacionin përfundimtar, si dhe sqarimet përkatëse, në rastet e mospërputhjes.</i></p> <p><i>Punimet e ndërtimit, të përkufizuara në nenin 3, duhet të projektohen dhe të zbatohen në tërësi ose në pjesë të veçanta në përputhje me kërkesat urbanistike, kushtet teknike të projektimit, kushtet teknike të zbatimit, si dhe me destinacionin e tyre, duke pasur parasysh edhe anën ekonomike të tyre.</i></p>
Ndikimi:	Përdorim pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet i fondeve në shumën prej 10,376,373.5 lekë pa TVSH.
Shkaku	Veprimet dhe mos veprimet e punonjësve të përfshirë në këtë praktikë, mbikëqyrësit dhe grupit të kolaudimit të punimeve, keqinterpretim i kuadrit ligjor e rregullator të prokurimit publik, e konkretisht atij në lidhje me kontratat e prokuruar sipas llojit <i>Me çelësa në dorë.</i>
Rëndësia:	E lartë.
8.1 Rekomandimi:	Nga ana e ARRSH, në rastet e kontratave të llojit <i>Me çelësa në dorë</i> , përpara miratimit të projektit nga ana e institucioni, të merren masat e nevojshme për respektimin, nga ana e projektuesve të të gjitha detyrimeve që parashikon kuadri ligjor e rregullator i projektimit, kjo me qëllim shmangien e përdorimit pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet i fondeve.

Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve z. N. M. është dërguar përmes postës elektronike observacioni i datës 31.07.2023.

Pretendimi i subjektit:

“ ... Mbikëqyrësi ka ndjekur me kujdes zbatimin e punimeve sipas kontratës së sipërmarrjes, kushteve teknike dhe legjislacionit në fuqi ..

Qëndrimi i Audituesve shtetërorë të KLSH

Pretendimet Tuaja mbi këtë çështje nuk merren në konsideratë nga Grupi i Auditimit pasi ato nuk sjellin fakte shtesë nga ato të konstatuara gjatë fazës së auditimit në terren e të sqaruara edhe në Projektraportin e Auditimit.

Nga ana e Grupit të Kolaudimit z. A. Q. dhe znj. M. H. është dërguar përmes postës elektronike observacioni i datës 28.07.2023.

Pretendimi i subjektit:

“ ... Nuk është në detyrën e Grupit të Kolaudimit të bëjë interpretimin e zërave dhe çmimeve të përdorura në preventivin e detajuar dhe të miratuar nga ana e AK..

Qëndrimi i Audituesve shtetërorë të KLSH

Pretendimet Tuaja mbi këtë çështje nuk merren në konsideratë nga Grupi i Auditimit pasi ato nuk sjellin fakte shtesë nga ato të konstatuara gjatë fazës së auditimit në terren e të sqaruara edhe në Projektraportin e Auditimit.

Kontrata me objekt “Emergjencë: “Rrëshqitje e Borshit” Kontratë me çelësa në dorë”***Historiku i zbatimit të punimeve***

Në përfundim të procedurës së prokurimit, është shpallur fitues OE G... me të cilin është lidhur kontrata me Autoritetin Kontraktor e përfaqësuar nga ish Titullari i AK sipas shkresës me nr. 3731/5 prot., datë 28.05.2021 me vlerë 161,311,370 lekë me TVSh dhe me afat të zbatimit të punimeve 4.5 muaj nga data e lidhjes së kontratës. Mbikëqyrja e punimeve është kryer nga ing. N. M., punonjës i ARRSH me nr. licence për mbikëqyrje dhe kolaudim punimesh MK.0514 i caktuar me Urdhër të Titullarit sipas aktit me nr. 7688/5 prot., datë 07.09.2021. Sipas korrespondencave punimet kanë nisur me datë 09.09.2021. Nisur nga fakti se kontrata është prokuruar si e llojit *Me çelësa në dorë* rezulton se projekti është parashikuar për tu hartuar nga ana e shoqërisë C....S. Punimet kanë përfunduar me datë 15.12.2021, pra brenda afatit të parashikuar në kontratë. Kolaudimi i punimeve është kryer nga ana e Grupit të ngritur me Urdhër nr. 338, datë 24.12.2021 të Titullarit me përbërje të grupit z. A. Q. dhe znj. M. H. sipas procesverbalit përkatës në datë 29.12.2021.

9. Titulli i gjetjes:	Përdorim pa EEE i fondeve në kontratat publike të llojit <i>Me çelësa në dorë</i>
9.1 Situata:	<p>Nga krahasimi i zërave të likuiduar e me ato të situacionuara e të pasqyruara në librezën e masave paraqiten diferenca në vlerë me pasojë përdorim pa efektivitet, efizienz dhe ekonomikitet fondet në shumën prej 82,030,528 lekë pa TVSH si rrjedhojë e çmimeve ndryshe nga sa ka parashikuar manuali teknik i çmimeve të punimeve të ndërtimit në fuqi në momentin e realizimit të kontratës dhe/apo punimeve të pakryera në fakt. Sipas evidencave konstatohet se projekti nuk është i miratuar nga ana e projektuesit C....S pasi nuk është i sigluar dhe nuk ka emrat e hartuesve të tij por vetëm atë të OE G.... Nga një analizë e preventivit të ndodhur në dosje vërehet se zërat janë paraqitur me çmime. Nga krahasimi i preventivit të përdorur nga ana e punonjësve të ARRSH për përlllogaritjen e vlerës së fondit limit dhe atij të hartuar nga ana e sipërmarrësit të punimeve rezulton se dokumenti i parë, i hartuar nga ana e BOE 4...9 & I....S, ka parashikuar volume pune për një gjatësi shkarjeje prej 50 ml dhe dokumenti i dytë për një gjatësi prej 84 ml, por në këtë të fundit një pjesë e volumeve janë në sasi më të vogla duke bërë që nga ana e sipërmarrësit të ofrohet një projekt preventiv me çmime më të larta për njësi duke rritur kështu koston totale. Konkretisht, rezultatet nga auditimi i ndryshimeve të vlerave për çdo kategori punimesh pasqyrohen më të detajuara në Aneksin nr. 3.3.</p> <p>OE G..., në këtë rast:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Nuk ka hartuar projektin sipas parashikimeve dhe deklarimeve të bëra në fazën e zhvillimit të procedurës (hartimin e projektit të zbatimit nga ana e shoqërisë C....S) e duke sigluar një projekt preventiv jo sipër licencave që disponon për projektim punimesh ndërtimi;

	<p>2. Nuk ka hartuar projekt-preventivin e punimeve të zbatimit në përputhje me kuadrin ligjor që disiplinon punimet e ndërtimit, këtë përmes heqjes nga preventivi të shumë zërave dhe kalimit të shumë korresponduese në zëra të tjerë me çmime shumë herë më të larta se ato që parashikon VKM përkatëse;</p> <p>Rezultatet e efektit financiar pasqyrohen në Aneksin nr. 3.4. Ky projekt preventiv i është nënshtruar opionencës teknike nga ana e Institutit të Ndërtimit i cila ka kthyer përgjigje sipas shkresës së administruar në ARRSH me nr. 7668 prot., datë 25.08.2021 e më pas projekti ka marrë miratimin përmes VKT nr. 32 me nr. 7668/1 prot., datë 30.08.2021.</p>
<p>9.2 Situata:</p>	<p>Nga auditimi rezulton se nga ana e OE G... janë përfshirë në situacionin përfundimtar, zëra të pakryera në fakt dhe/apo të pakryera sipas zërit të përshkruar në situacion. Konkretisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Gjermimi i dheut me ekskavator nuk është kryer me mjet të pajisur me kovë 0.25 m³; - Zërat <i>Spërkatje me emulsion bituminoz 1 l/m²</i> dhe <i>Spërkatje me emulsion bituminoz 0.5 l/m²</i> <p>Sasitë përkatëse të nevojshme për realizimin e ljerjeve me prajmer janë parashikuar nën zërat për realizimin e vetë shtresave asfaltike. Për rrjedhojë rezulton se janë përfituar tepër nga ana e sipërmarrësit vlera prej 925,435 lekë pa TVSH ((563 lekë/m² + 402 lekë/m²) x 959 m²);</p> <ul style="list-style-type: none"> - Zëri <i>Mbushje me çakëll pas mureve</i> <p>Referuar detajeve të projektit të zbatimit rezulton se në lidhje me këtë ka një mbivendosje mes volumit për mbushjen me çakëll dhe zërit mbushje me çakëll e gur guroreje në trupin e rrugës përhapur e ngjeshur me makineri. Konkretisht volumi i likuiduar dy herë për të njëjtën hapësirë është në masën prej 200 m³ duke bërë që të përfitohet tepër nga ana e sipërmarrësit të punimeve vlera prej 617,200 lekë pa TVSH (200 m³ x 3,086 lekë/m³)</p> <ul style="list-style-type: none"> - Zëri <i>Shpim me sonda në tokë të zakonshme ϕ 1000 mm, thellësia 20 – 30 m</i> <p>Referuar detajeve të projektit të zbatimit si dhe vizatimeve të librezës së masave rezulton se shpimi me sondë nuk është bërë më këto të dhëna, por me diametër 800 mm dhe në thellësi 16 ml. Pra në këtë rast do të duhet të ishte ndryshuar zëri në preventiv sipas zërit të kryer në fakt. Konkretisht ky zë duhet të ishte ndryshuar në zërin sipas atij me nr. Analize M.3 An SD2 me çmim 4,906 lekë ml, ose vlera totale prej 3,610,816 lekë pa TVSH (46 copë pilota x 16 ml x 4,096 lekë/ml). Për rrjedhojë rezulton se janë përfituar tepër nga ana e sipërmarrësit vlera prej 3,379,316.4 lekë pa TVSH (6,990,132.4 lekë – 3,610,816 lekë);</p> <ul style="list-style-type: none"> - Zëri <i>Beton C 30/37 për pilota dhe traun e pilotave</i> <p>Sipas situacionit përfundimtar në lidhje me këtë zë është paraqitur volumi prej 588.8 m³, kjo vetëm për sa i takon betonit për pilotat. Libreza e masave pasqyron të njëjtin volum pune. Në fakt, referuar detajeve të projektit të zbatimit si dhe vizatimeve të librezës së masave, kjo e fundit ka paraqitur gabim sipërfaqen e seksionit tërthor të pilotës prej 0.8 m² kur në fakt sipërfaqja e seksionit tërthor për pilotë me diametër 0.8 m është 0.5024 m². Nga kjo volumi total i realizuar vetëm për pilotat është 369.8 m³ (0.5024 m²/ml x 46 pilota x 16 ml). Për rrjedhojë rezulton se janë përfituar tepër nga ana e sipërmarrësit vlera prej 4,605,570 lekë pa TVSH</p>

	((588.8 m ³ – 369.8 m ³) x 21,030 lekë/m ³).
Kriteri:	<p>Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, <u>ku përcaktohet se:</u></p> <p>neni 7/1: “Mbikëqyrësi/grupi i mbikëqyrësve të punimeve është i detyruar të kontrollojë dhe është përgjegjës për zbatimin e punimeve të ndërtimit në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të projektimit, të zbatimit, si dhe destinacionin e objektit. Ai është i detyruar të kontrollojë librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë, vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit.”</p> <p>Neni 5/1 <u>Përgjegjësia e projektuesit:</u></p> <p>Pika 1: “Projektuesi është përgjegjës për hartimin e studimeve e të projekteve në përputhje me detyrën e projektimit, me dokumentet e planifikimit e të kontrollit të zhvillimit dhe me legjislacionin në fuqi që rregullon veprimtarinë e ndërtimit në Republikën e Shqipërisë, përfshirë dispozitat antisizmike, të sigurisë, mbrojtjes nga zjarri, higjieno-sanitare, si dhe efikasitetin energjetike.”</p> <p>Pika 3: “Çdo projektues ose grup projektimi është i detyruar të lidhë një kontratë të sigurimit të përgjegjësisë profesionale për çdo dëm që mund të shkaktohet si pasojë e veprimtarisë së tij dhe duhet të mbulojë të paktën dëmet e mëposhtme:</p> <p>a) çdo shpenzim të nevojshëm e të domosdoshëm të projektimit të ri, si dhe shpenzimet shitesë të kryera nga zhvilluesi ose organet e administratës publike, që kanë rrjedhur si pasojë e gabimeve në projektim;</p> <p>b) kostot shitesë që mund të lindin për zhvilluesin, si pasojë e gabimeve në projektim gjatë zbatimit të projektit.”.</p> <p>Neni 12, <u>ku përcaktohet se:</u></p> <p>“Të gjitha objektet e përkufizuara në nenin 3 duhet t'i nënshtrohen kolaudimit tekniko-ekonomik, i cili ka për qëllim të verifikojë nëse:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. objekti është realizuar në kushtet teknike; 2. objekti është realizuar në përputhje me kontratën dhe anekset e saj; 3. çmimet e aplikuara janë sipas përcaktimeve të kontratës; 4. në këtë akt verifikohen edhe kërkesat e zbatuesit të paraqitura gjatë zbatimit të punimeve <p>Udhëzimi nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, <u>ku përcaktohet se:</u></p> <p>Pika 8.1: “Situacionet pjesore hartohen në lloje, zëra, sasi, çmim e vlerë, sipas kontratës dhe ndryshimeve të urdhëruara nga investitori. Zërat, sasi, çmimet jashtë kontratës dhe përdorimi i fondit rezervë në situacionin përfundimtar justifikohen me dokumentacionin përkatës”.</p> <p>Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënparagrafi 3.2 dhe 3.3 <u>ku përcaktohet se:</u></p> <p>“3.2 Libreza e masave për punimet e ndërtimit është dokumentacioni bazë për verifikimin e saktësisë së vëllimeve të punimeve të ndërtimit, të vendosura në situacion. Kjo librezë hartohet nga drejtuesi teknik i objektit dhe firmoset nga ai, nga mbikëqyrësi i punimeve dhe nga përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit, për të cilin është miratuar leja e ndërtimit.</p> <p>3.3 Situacionet mujore pjesore, progresive dhe përfundimtare hartohen mbi bazën e volumeve të llogaritura në librezën e masave dhe çmimeve faktike, mbështetur në analizat teknike të çmimeve, që përfshihen në</p>

	<p>manualin teknik të çmimeve të ndërtimit, të miratuara çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave. Ato firmosen nga drejtuesi teknik i objektit, mbikëqyrësi i punimeve dhe përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit për të cilin është miratuar leja e ndërtimit. Në rastet kur në manualin teknik të çmimeve të ndërtimit mungojnë analizat teknike të çmimeve të zërave të punimeve të kryera në objekt, veprohet në përputhje me procedurën e përcaktuar në pikën 8 të vendimit nr. 514, datë 15.8.2007 të Këshillit të Ministrave “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”;</p> <p>Udhëzimi nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar e konkretisht Kreu II, Pika 3 <u>ku përcaktohet se:</u></p> <p><i>Kolaudatori ose grupi i kolaudimit duhet të verifikojë me përgjegjësi:</i></p> <p>a. Realizimin e objektit, në përputhje me projektin, lejen e ndërtimit, standardet dhe rregullat teknike.</p> <p>b. Realizimin e objektit, në përputhje me kontratën e nënshkruar.</p> <p>c. Përputhjen e dokumenteve me të dhënat nga matjet në dimension, formë, sasi dhe cilësi.</p> <p>ç. Përputhjen e vlerës së preventivuar dhe të kontraktuar me atë të paraqitur në situacionin përfundimtar, si dhe sqarimet përkatëse, në rastet e mospërputhjes.</p> <p><i>Punimet e ndërtimit, të përkufizuara në nenin 3, duhet të projektohen dhe të zbatohen në tërësi ose në pjesë të veçanta në përputhje me kërkesat urbanistike, kushtet teknike të projektimit, kushtet teknike të zbatimit, si dhe me destinacionin e tyre, duke pasur parasysh edhe anën ekonomike të tyre.</i></p>
9.1 Ndikimi:	Përdorim pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet i fondeve në shumën prej 82,030,528 lekë pa TVSH.
Shkaku	Veprimet dhe mos veprimet e punonjësve të përfshirë në këtë praktikë, mbikëqyrësit dhe grupit të kolaudimit të punimeve, keqinterpretim i kuadrit ligjor e rregullator të prokurimit publik, e konkretisht atij në lidhje me kontratat e prokuruar sipas llojit <i>Me çelësa në dorë.</i>
Rëndësia:	E lartë.
9.1Rekomandimi:	Nga ana e ARRSH, në rastet e kontratave të llojit <i>Me çelësa në dorë</i> , përpara miratimit të projektit nga ana e institucioni, të merren masat e nevojshme për respektimin, nga ana e projektuesve të të gjitha detyrimeve që parashikon kuadri ligjor e rregullator i projektimit, kjo me qëllim shmangien e përdorimit pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet i fondeve.

Nga ana e Grupit të Kolaudimit z. A. Q. dhe znj. M. H. është dërguar përmes postës elektronike observacioni i datës 28.07.2023.

Pretendimi i subjektit:

“ ... Nuk është në detyrën e Grupit të Kolaudimit të bëjë interpretimin e zërave dhe çmimeve të përdorura në preventivin e detajuar dhe të miratuar nga ana e AK..

Qëndrimi i Audituesve shtetërorë të KLSH

Pretendimet Tuaja mbi këtë çështje nuk merren në konsideratë nga Grupi i Auditimit pasi ato nuk sjellin fakte shtesë nga ato të konstatuara gjatë fazës së auditimit në terren e të sqaruara edhe në Projektraportin e Auditimit.

Kontrata me objekt “Ndërtim Rruga mbikalimi TEG dhe rrugët lidhëse të tij”:

Projekti “Ndërtim Rruga mbikalimi TEG dhe rrugët lidhëse të tij” është hartuar për rregullimin e trafikut ku bashkohet Unaza e Madhe e Tiranës (pjesa Lindore dhe Jugore) me autostradën Tiranë-Elbasan ku nga rrotullimi do të ketë një nënkalim në drejtimi Unazë Jugore-Elbasan. Pjesa e rrugëve dytësore dhe Unaza Lindore do të lidhen midis tyre me mbikalim në rrethrotullim. Për zbatimin e punimeve civile midis ARRSH dhe OE A... B... me nr. 1130 prot., datë 03.02.2021 me vlerë 1,402,652,826.75 lekë pa TVSH ose 1,683,183,392.10 lekë me TVSH me afat përfundimi të punimeve 15 muaj nga data e lidhjes së saj, data e përfundimit të punimeve 04.05.2022. Për shkak të vonesave në procesin e shpronësimeve afati i përfundimit të punimeve është ndryshuar me amendimin e kontratës nr. 3091/2 prot., datë 18.03.2022, deri më 02.11.2022 pra me (6) gjashtë muaj. Progresi i kësaj kontrate, deri në fund të periudhës audituese 31.12.2022, në volume punimesh dhe atë financiar është realizuar në masën 53.7 %. Deri në fund të periudhës së audituar për kontratën me objekt “Ndërtim Rruga mbikalimi TEG dhe rrugët lidhëse të tij” janë kryer 4 pagesa të ndërmjetme me vlerë totale 860,330,865 lekë pa TVSH (në këtë vlerë përfshihet edhe ndalesa prej 5% e garancisë së punimeve).

Kap.	Përshkrimi i punimeve	Preventivi (Lekë pa TVSH)			Realizuar (Lekë pa TVSH)	Realizimi %
		Kontrata	Rishikuar	Diferenca		
	PUNIME NË RRUGË DHE TROTUARE					
A-1	Punime prishje dhe çmontimi	36,921,800	35,654,920	1,266,880	14,993,720	40.6
A-2	Punime në trup të rrugës (Kryesore +rampa)	376,601,000	386,560,985	-9,959,985	200,348,730	53.2
A-2	Punime në trup të rrugës (Dytësore)	117,524,000	128,766,800	-11,242,800	25,465,350	21.7
A-3	Punime në bordure, kuneta, trotuare dhe skarpata	40,784,800	40,296,080	488,720	23,035,950	56.5
	B PUNIME NË VEPRA ARTI					
B-1	Punime në vepra arti të vogla	470,439,350	434,539,045	35,900,305	302,019,737.5	64.2
B-2	Punime në vepra arti të mëdha (H.D 10-30 m)	110,641,200	123,078,000	-12,436,800	103,208,500	93.3
D	Punime në rrjetin K.U.SH	40,977,200	40,977,200	-3,930,000	27,416,200	66.9
F	Punime për sinjalistikën rrugore	86,010,750	86,010,750	0	8,508,000	9.9
G	Punime për gjelbërimin	28,346,000	28,432,000	-86,000	9,200,000	32.5
J	Punime për ndërtimin e ndriçimit rrugor	27,613,735	27,613,735	0	2,746,200	9.9
	Fondi rezervë 5%	0	0	0	0	
	Totali	1,335,859,835	1,335,859,515	320	716,942,387.5	53.7

Mbikëqyrja e punimeve të zbatimit të projektit kryhet nga kompania *BOE P... C... & E... C... G... & E....G & I....S* sipas kontratës së lidhur me Autoritetin Rrugor Shqiptar nr. 301/2 prot. datë 03.02.2021 dhe vlerë **12,603,055 Lekë me TVSh** me objekt: “*Supervizion Punimesh, Ndërtim Rruga mbikalimi TEG dhe rrugët lidhëse të tij*” me afat deri në përfundimin e punimeve civile.

Nga auditimi rezultuan diferenca në volume punimesh të pa kryera në shumën **12,204,541 lekë pa TVSH** trajtuar si më poshtë:

10. Titulli i gjetjes:	Punime të situacionuara por të pakryera në fakt.
Situata:	<p>Në objektin “<i>Ndërtim Rruga mbikalimi TEG dhe rrugët lidhëse të tij</i>” sipas kontratës të lidhur midis Autoritetit Rrugor Shqiptar dhe OE A... B... me nr. 1130 prot. datë 03.02.2021 në lidhje me zbatimin e punimeve me 1,402,652,826.75 lekë pa TVSH ose 1,683,183,392.10 lekë me TVSH me afat përfundimi të punimeve 15 muaj dhe ky afat i ndryshuar me amendimin e kontratës nr. 3091/2 prot. datë 18.03.2022, deri më 02.11.2022, nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion, konkretisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Projekti fillestar;</i> • <i>Projekti i Zbatimit pjesor (Vizatimet sipas faktit);</i> • <i>Pagesat pjesore nga Situacioni nr. 1 deri Situacioni nr. 4;</i> • <i>Librezat e masave pjesore deri në situacionin përmbledhës nr. 4 ;</i>

	<ul style="list-style-type: none"> • <i>Ndryshimet e miratuara me Vendimet e Këshillit Teknik;</i> • <i>Korrespondencat mes Autoritetit Rrugor Shqiptar (ARRSH) dhe Kompanisë konsulete që kryen supervizionimin BOE “P... C...” sh.p.k & E... C... G...” sh.p.k & “E.....G” sh.p.k & “I....S” sh.p.k.</i> <p>si dhe nga verifikimi i kryer në terren në prezencë të përfaqësuesve shtetërorë të KLSH dhe Konsulentit (supervizori i punimeve) rezultuan se janë përfshirë në librezat e masave volume pune të pakryera në fakt. Këto diferenca rezultuan në zërat me vlerat përkatëse si më poshtë:</p> <table border="1" data-bbox="485 557 1385 927"> <thead> <tr> <th>Nr.</th> <th>Kategoria e Punimeve</th> <th>Emërtimi i Zërit</th> <th>Vlera (lekë pa TVSH)</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>1</td> <td>A-2. Punime në rrugë dhe trotuare</td> <td>Gërmim dheu me ekskavator zinxhir, 0.25 m³, ne kanale gjerësi > 2 m, toke zak. kategoria III, me shk. në tokë</td> <td>5,599,368</td> </tr> <tr> <td rowspan="2">2</td> <td rowspan="2">A-1. Punime në rrugë dhe trotuar</td> <td>Gërmim dheu me ekskavator zinxhir, 0.25 m³, ne kanale gjerësi > 2 m, toke zak. kategoria III, me shk. në tokë</td> <td>1,729,156</td> </tr> <tr> <td>Transport dheu deri në 10 km</td> <td>4,803,217</td> </tr> <tr> <td colspan="3" style="text-align: right;">SHUMA</td> <td>12,131,741</td> </tr> </tbody> </table> <p>Konkretisht, argumentimet pasqyrohen të përshkruara në Akt konstatimin Nr. 21.</p>	Nr.	Kategoria e Punimeve	Emërtimi i Zërit	Vlera (lekë pa TVSH)	1	A-2. Punime në rrugë dhe trotuare	Gërmim dheu me ekskavator zinxhir, 0.25 m ³ , ne kanale gjerësi > 2 m, toke zak. kategoria III, me shk. në tokë	5,599,368	2	A-1. Punime në rrugë dhe trotuar	Gërmim dheu me ekskavator zinxhir, 0.25 m ³ , ne kanale gjerësi > 2 m, toke zak. kategoria III, me shk. në tokë	1,729,156	Transport dheu deri në 10 km	4,803,217	SHUMA			12,131,741
Nr.	Kategoria e Punimeve	Emërtimi i Zërit	Vlera (lekë pa TVSH)																
1	A-2. Punime në rrugë dhe trotuare	Gërmim dheu me ekskavator zinxhir, 0.25 m ³ , ne kanale gjerësi > 2 m, toke zak. kategoria III, me shk. në tokë	5,599,368																
2	A-1. Punime në rrugë dhe trotuar	Gërmim dheu me ekskavator zinxhir, 0.25 m ³ , ne kanale gjerësi > 2 m, toke zak. kategoria III, me shk. në tokë	1,729,156																
		Transport dheu deri në 10 km	4,803,217																
SHUMA			12,131,741																
Kriteri:	<p>Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 <i>“Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”</i>, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 <u>ku përcaktohet se:</u> <i>“Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë periodikisht dhe në fazat më kryesore, librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit”</i></p> <p>-Udhëzimit nr. 2, datë 13.05.2005 <i>“Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”</i>, Kreu II, Pika 8.1 <u>ku përcaktohet se:</u> <i>“Situacionet pjesore hartohen në lloje, zëra, sasi, çmim e vlerë, sipas kontratës dhe ndryshimeve të urdhëruara nga investitori. Zërat, sasitë, çmimet jashtë kontratës dhe përdorimi i fondit rezervë në situacionin përfundimtar justifikohen me dokumentacionin përkatës”</i></p> <p>-Udhëzimi nr. 3 datë 15.02.2001 <i>“Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”</i>, i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nën pikat 3.2 dhe 3.3.</p> <p>- Kontrata e shërbimit e lidhur midis ARRSH dhe BOE P... C... & E... C... G... & E.....G SH.P.K & I....S me nr. 301/2 prot. datë 03.02.2021 me objekt: <i>“Supervizion Punimesh, Ndërtim Rruga mbikalimi TEG dhe rrugët lidhëse të tij”</i> Neni 7 pika 1 <i>“Detyrimet e Përgjithshme të Kontraktorit”</i> ku thuhet; <i>“Kontraktuesi duhet ti kryejë Shërbimet dhe përmbushi detyrimet e tij me të gjitha përpjekjet, eficiente dhe ekonomike në pajtim me teknikat dhe praktikat profesionale të pranuar në përgjithësi”</i>.</p>																		
Ndikimi/Efekti:	Dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit në shumën 12,131,741 lekë pa TVSH.																		
Shkaku:	Certifikimi nga ana e supervizorit i volumeve të punimeve të pakryera në fakt nga ana e sipërmarrësit.																		

Rëndësia:	E lartë.
10.1 Rekomandimi:	ARRSH në bashkëpunim me mbikëqyrësin e punimeve të marrë masa për zbritjen e punimeve të certifikuar më tepër dhe rakordimin e tyre, të vlerës 12,131,741 lekë pa TVSH që përbën dëm ekonomik, në situacionet pasardhës deri në atë përfundimtar, përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve OE A... B... me të cilin është lidhur kontrata nr. 1130 prot., datë 03.02.2021 për zbatimin e punimeve.

Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi përfaqësuesi i Supervisorit/Konsulentit BOE P... C... & E... C... G... & E....G & I...S. z. Xh. A. sipas kontratës së shërbimit nr. 301/2Prot. datë 03.02.2021 me objekt: “Supervizion Punimesh, Ndërtim Rruga mbikalimi TEG dhe rrugët lidhëse të tij”.

Kontrata me objekt “Rehabilitimi i Segmentit Rrugor Mbikalimi Pallati me Shigjeta – Rreth rrotullimi Shqiponja Loti1”:

Projekti “Rehabilitimi i Segmentit Rrugor Mbikalimi Pallati me Shigjeta – Rreth rrotullimi Shqiponja Loti1” është hartuar për rregullimin e trafikut ku bashkohet Unaza e Madhe e Tiranës (pjesa Jugore dhe Veriore) me autostradën Tiranë-Durrës dhe me hyrjen dhe daljen nga Tirana. Kjo nyje, nga një rreth rrotullim do të kthehet me nënkalime dhe mbikalime si dhe rrugët dytësore.

Për zbatimin e punimeve civile midis ARRSH dhe BOE S... & B... N... me nr. 5469/7 prot., datë 22.10.2019 me vlerë 1,776,111,282 lekë pa TVSH ose 2,129,438,058.33 lekë me TVSH me afat përfundimi të punimeve 24 muaj nga data e lidhjes së saj, datë e përfundimi të punimeve 04.05.2022. Për shkak të vonesave në procesin e shpronësimeve afati i përfundimit të punimeve është ndryshuar me amendimin e kontratës nr. 9300/2 prot. datë 15.10.2021, deri më 16.04.2022. Sipas procesverbalit të fillimit të punimeve ato kanë filluar më datë 16.04.2020 për arsyen e vonesave në procesin e shpronësimeve. Punimet kanë përfunduar më datë 25.01.2022 dhe kolaudimi i objektit është kryer më datë 15.04.2022 sipas Urdhrit nr. 41 datë 03.03.2022. Deri në fund të periudhës së audituar për kontratën me objekt “Rehabilitimi i Segmentit Rrugor Mbikalimi Pallati me Shigjeta – Rreth rrotullimi Shqiponja Loti1” janë kryer 16 pagesa të ndërmjetme me vlerë totale 2,129,438,058 lekë me TVSH (në këtë vlerë përfshihet edhe ndalesa prej 5% e garancisë së punimeve).

Mbikëqyrja e punimeve të zbatimit të projektit kryhet nga kompania OE A... E... E... me nr. 2128/5 prot. datë 24.06.2019 dhe vlerë 18,000,000 Lekë me TVSh me objekt: “Supervizionim Punimesh, Rehabilitimi i Segmentit Rrugor Mbikalimi Pallati me Shigjeta – Rreth rrotullimi Shqiponja Loti1” me afat deri në përfundimin e punimeve civile.

Nga auditimi rezultuan diferenca në volume punimesh të pa kryera në shumën 9,036,607 lekë pa TVSH trajtuar si më poshtë:

11. Titulli i gjetjes:	Punime të situacionuara por të pakryera në fakt.
Situata:	Në objektin “Rehabilitimi i Segmentit Rrugor Mbikalimi Pallati me Shigjeta – Rreth rrotullimi Shqiponja Loti1” sipas kontratës të lidhur midis ARRSH dhe S... & B... N... me nr. 5469/7 prot., datë 22.10.2019 në lidhje me zbatimin e punimeve me vlerë 1,776,111,282 lekë pa TVSH ose 2,129,438,058 lekë me TVSH me afat përfundimi të punimeve 24 muaj dhe ky afat i ndryshuar me amendimin e kontratës nr. 9300/2 prot., datë 15.10.2021, deri më 16.04.2022, nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion, konkretisht: <ul style="list-style-type: none"> • Projekti fillestar;

- *Projekti i Zbatimit pjesor (Vizatimet sipas faktit);*
- *Pagesat pjesore nga Situacioni nr. 1 deri Situacioni nr. 16;*
- *Librezat e masave pjesore deri në situacionin përmbledhës nr.16 ;*
- *Ndryshimet e miratuara me Vendimet e Këshillit Teknik;*
- *Korrespondencat mes ARRSH dhe Kompanisë konsulente që kryen supervizionimin OE A... E... E....*

si dhe nga verifikimi i kryer në terren rezultuan se janë përfshirë në librezat e masave volume pune të pakryera në fakt. Këto diferenca rezultuan në zërat me vlerat përkatëse si më poshtë:

Nr.	Kategoria e Punimeve	Emërtimi i Zërit	Vlera (lekë pa TVSH)
1	Aksi 1 Punime gërmimi	Gërmim dheu me ekskavator zinxhir 0.5m ³ , në kanale me gjerësi deri 2 m, tokë e zakonshme, kategoria IV, me shkarkim në mjet	1,476,390
2	Aksi 2 Punime gërmimi	Gërmim dheu me ekskavator zinxhir 0.5m ³ , në kanale me gjerësi deri 2m, tokë e zakonshme, kategoria IV, me shkarkim në mjet	5,074,500
3	Aksi 8, 9 Punime gërmimi	Mbushje me material të gërmuar në trupin e rrugës	242,400
		Mbushje me çakëll e gur gurore në trupin e rrugës, përhapur e ngjeshur me makineri	1,696,800
SHUMA			8,490,090

Konkretisht, argumentimet pasqyrohen të përshkruara në Akt konstatimin nr. 22.

Kriteri:

Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 *“Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”*, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 ku përcaktohet se: *“Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë periodikisht dhe në fazat më kryesore, librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit”*.

-Udhëzimit nr. 2, datë 13.05.2005 *“Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”*, Kreu II, Pika 8.1 ku përcaktohet se: *“Situacionet pjesore hartohen në lloje, zëra, sasi, çmim e vlerë, sipas kontratës dhe ndryshimeve të urdhëruara nga investitori. Zërat, sasi, çmimet jashtë kontratës dhe përdorimi i fondit rezervë në situacionin përfundimtar justifikohen me dokumentacionin përkatës”*.

-Udhëzimi nr. 3 datë 15.02.2001 *“Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”*, i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3.

- Kontrata e shërbimit e lidhur midis ARRSH dhe OE A... E... E... me nr. 2128/5 prot., datë 24.06.2019 me objekt: *“Supervizion Punimesh, Rehabilitimi i Segmentit Rrugor Mbikalimi Pallati me Shigjeta – Rrethrotullimi Shqiponja Loti 1”*, Neni 7 pika 1 *“Detyrimet e Përgjithshme të Kontraktorit”* ku thuhet: *“Kontraktuesi duhet t'i kryejë Shërbimet dhe përmbushi detyrimet e tij me të gjitha përpjekjet, eficiente dhe ekonomike në pajtim me teknikat dhe praktikat profesionale të pranuar në përgjithësi”*.

Ndikimi/Efekti:

Përdorim pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet të fondeve të buxhetit të shtetit në shumën **8,490,090 lekë pa TVSH**.

Shkak:	Certifikimi nga ana e supervizorit i volumeve të punimeve të pakryera në fakt nga ana e sipërmarrësit.
Rëndësia:	E lartë.
11.1 Rekomandimi:	ARRSH në bashkëpunim me mbikëqyrësin e punimeve, të verifikojnë dokumentacionin e plotë të dosjes teknike si dhe punimet faktike të realizuara në terren për volumet e përmendura, në kontratën e sipërmarrjes së punimeve të lidhur mes BOE “S...” sh.p.k & “B... N...” sh.p.k sipas aktit me nr. 5469/7 prot. datë 22.10.2019, për zbatimin e punimeve civile.

Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi përfaqësuesi i Supervizorit/Konsulentit A... E... E... znj. E. Ç. sipas kontratës së shërbimit nr. 2128/5 prot., datë 24.06.2019 me objekt: “Supervizion Punimesh, Rehabilitimi i Segmentit Rrugor Mbikalimi Pallati me Shigjeta – Rrethrotullimi Shqiponja Loti 1”.

Për sa më sipër nga ana e mbikëqyrësit të punimeve znj. E. Ç. me shkresën nr. 684 prot. datë 19.07.2023 dhe administruar në KLSH me nr. 1201/12 prot. datë 20.07.2023, ka dërguar komente dhe shpjegime, konkretisht:

Pretendimet e subjektit të audituar:

1. Në lidhje me Akset 1 dhe 2 duam të theksojmë se nuk mund të gjykohet nga nëpërmjet dy pamjeve fotografike në raportet mujore për faktorët teknik për llogaritjen e volumeve sipas faktit. Çdo sasi është llogaritur referuar matjeve faktike në librezat e masave të cilat janë dokumenti bazë për verifikimin e saktësinë e volumeve të punimeve. (foto bashkëlidhur).

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH -së:

1. Për Akset 1 dhe 2 në librezat e masave dhe situacionin përfundimtar ju pasqyroni një volum gjermimi më të madh se sa ai i transportuar dhe pjesa tjetër është lënë në kantier.

Volumi i dheut të gërmuar të lënë në kantier për akset 1 dhe 2 është 21,836 m³, por ndodhur në kushtet se punimet kanë përfunduar dhe janë marrë në dorëzim nga Autoriteti Kontraktor, gjithashtu sheshi ku u kryen punimet është plotësisht i lirë, ju nuk jepni fakte që volumi i dheut të jetë përdorur në një zë tjetër punimesh për mbushje. Kështu që kjo sasi mund të jetë përdorur për materiale të tjera në mbushje ose nuk është kryer si volum gjermimi, prandaj i lidhet si detyrë Autoritetit kontraktor të kryej verifikimet përkatëse për këto dy akse ku ju keni paraqitur foto të pjerrësive të skarpatit. Deri në sqarimin e plotë do të konsiderohet përfitim më tepër i vlerës së këtyre volumeve për këto zëra nga ana e grupit të auditimit.

2. Për sasinë e mbushur me material të gërmuar në trupin e rrugës dhe me çakëll e gur gurore (për akset 8 dhe 9), në këtë observacion ju nuk jepni fakte. ju sqaroni se janë sipas profilit faktik dhe nuk mund të gjykohet nga pamjet fotografike. Referuar observacionit tuaj të dërguara pas akt konstatimeve ju sqarojmë dhe një herë se, sasia e volumit të zërave mbushje me material të gërmuar në trupin e rrugës dhe me çakëll e gur gurore janë llogaritur për akset 8 dhe 9 (jo për gjithë gjatësinë) dhe jo për akset 1 dhe 2. Ketë e vërtetojnë edhe fotot e, figura 2 dhe 3 të cilat tregojnë mënyrën e gërmimit e për rrjedhojë edhe mbushjen. Kështu që me fotot bashkëlidhur ju vërtetoni konstatimet e grupit të auditimit për volumet e mbushjes së trajtuara në këtë pikë dhe pretendimet tuaja nuk merren parasysh. Meqenëse vlerësimet tona janë të përafërta dhe janë punime të maskuara përsëri i lihet detyrë AK për verifikim të këtyre volumeve.

2.6 Mbi zbatimin e ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e sistemit të MFK si dhe auditit të brendshëm

Autoriteti Rrugor Shqiptar është person juridik publik, i cili është krijuar dhe organizuar në zbatim të Ligjit nr. 10 164, datë 15.10.2009 “Për Autoritetin Rrugor Shqiptar” dhe VKM Nr. 276, datë 16.5.2018 “Për miratimin e mënyrës së organizimit, të strukturës, organikës dhe statutit të Autoritetit Rrugor Shqiptar”. ARRSH administron rrjetin rrugor kombëtar me gjatësi prej 3 606 km, sipas inventarit të miratuar me VKM nr. 600, datë 13.10.2021. Organet e ARRSH janë bordi menaxhimit dhe drejtori i përgjithshëm. Bordi përbëhet nga 7 anëtarë, të cilët emërohen nga këshilli ministrave, me propozimin e institucioneve përkatëse. Drejtori i përgjithshëm merr pjesë pa të drejtë vote në mbledhjet e bordit, si dhe emërohet nga kryeministri. Mënyra e organizimit dhe struktura e Autoritetit është përcaktuar në nivel qendror dhe rajonal, nga ku në nivelin e parë funksionojnë 5 drejtori, Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Operacioneve, Drejtoria e Planifikimit të Buxhetit dhe Financës, Drejtoria e Ndërtimit dhe Mirëmbajtjes, Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme, dhe Drejtoria Juridike dhe Përputhshmërisë së Standardeve. Në nivelin e dytë, atë rajonal, Drejtoritë Rajonale Qendër-Tiranë, Veri-Shkodër, dhe Jug-Gjirokastrë funksionojnë me buxhet më vete, gjithashtu njësitë e menaxhimit të projekteve, të cilat financohen sipas marrëveshjeve të huave të lidhura ndërmjet qeverisë shqiptare dhe donatorëve të huaj. Buxheti total i shpenzuar nga ARRSH, për vitin 2022, arriti vlerën prej 17,754,489,000 lekë, nga ku 14,297,769,000 leke ose 80.5 % është financuar nga buxheti i shtetit dhe 3,456,720,000 lekë ose 19.5 % është me financim të huaj. Në zbatim të ligjit nr. 10 296, datë 08.07.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, në Autoritetin Rrugor Shqiptar është implementuar sistemi i menaxhimit financiar dhe kontrollit. Normat e përgjithshme, që rregullojnë organizimin dhe funksionimin e ARRSH, detyrat funksionale, procedurat e komunikimit, etika profesionale, mbarëvajtja dhe disiplina në marrëdhëniet e punës etj., janë reflektuar në Rregulloren e Brendshme të Autoritetit (përfshirë edhe anekset për funksionimin e Drejtorive Rajonale), e cila është miratuar me vendimin nr. 10, datë 04.09.2018 të Bordit. Dokumentimi i procesit të menaxhimit të riskut është prezantuar në një regjistër risku, i cili përfshin objektivat, llojin e riskut dhe përshkrimin e tij, si edhe ndikimin dhe mundësinë e ndodhjes së riskut duke e kategorizuar si të lartë, të mesëm dhe të ulët. Regjistri i riskut është rishikuar çdo vit, sipas modelit të ardhur nga Ministria Infrastrukturës dhe Energjisë. Gjithashtu, është ngritur Grupi Menaxhimit Strategjik, i kryesuar nga Drejtori i Përgjithshëm i ARRSH, në rolin e Nëpunësit Autorizues. Politikat e burimeve njerëzore në ARRSH dhe praktikat e ngjashme, lidhen me rekrutimin, emërimin, trajnimin, vlerësimin e performancës, avancimin në detyrë dhe veprimet disiplinore. Me Vendimin Nr.21, datë 10.11.2020 të Bordit është miratuar formulari “Vlerësimi i punës” për punonjësit e institucionit.

Njësia e Auditit të Brendshëm

Auditimi i brendshëm në Autoritetin Rrugor Shqiptar është organizuar mbi bazë sektori, në zbatim të VKM Nr. 276, datë 16.5.2018 “Për miratimin e mënyrës së organizimit, të strukturës, organikës dhe statutit të Autoritetit Rrugor Shqiptar”.

Në strukturën e Autoritetit është parashikuar sektori i AB në varësi të Drejtorit të Përgjithshëm të ARSH. Sektori i AB përbëhet nga 3 punonjës, ku njëri prej tyre është emëruar përgjegjës sektori, por aktualisht ky sektor punon vetëm me 2 specialistë.

Auditi i brendshëm raporton çdo vit mbi veprimtarinë e tij në Drejtorinë e Harmonizimit në Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë.

Nga auditimi rezulton si më poshtë:

1. Titulli i gjetjes:	Parregullsi në sistemin financiar dhe kontrollit (MFK).
Situata:	Në rregulloren e brendshme të institucionit, rregullat apo proceset

	<p>kryesore të përfshira janë ndërtuar kryesisht sipas linjave funksionale të përgjegjëse, por ato nuk përshkruajnë me detaje proceset, rrjedhën dhe identifikimin e punës, përgjegjësinë individuale, afatet e kryerjes, vendimmarrjen individuale, dokumentacionin e miratuar, si edhe veprimtaritë e kontrollit të nevojshme.</p> <p>Nga auditimi ka rezultuar se, me përjashtim të Drejtorisë Planifikimit të Buxhetit dhe Financës, manualët për proceset kryesore në sektorët dhe drejtoritë e ARRSH janë akoma në proces hartimi.</p> <p>Qeverisja e ARRSH përfaqëson mënyrën me të cilën ajo drejtohet dhe kontrollohet, por nga auditimi rezulton se Grupi i Menaxhimit Strategjik nuk ka funksionuar mjaftueshëm, mungojnë minutat e takimit, vendimet dhe raportet, të cilat duhet t'u vihen në dispozicion stafit menaxhues të njësisë publike.</p> <p>Regjistri i riskut është rishikuar çdo vit, por nga auditimi formularëve të plotësuar të regjistrit të riskut ka rezultuar se nuk bëhet dallimi i riskut të mbetur nga ai i qenësishmi (i natyrshëm), dhe se menaxhimi i riskut nuk kryhet në mënyrë sistematike, apo periodike gjatë vitit. Gjithashtu, ka rezultuar se regjistri nuk është plotësuar korrekt, p.sh. kur niveli i riskut nuk ndryshon dhe mbetet i lartë nuk kërkohet marrja e masave të kontrollit, apo kur niveli i riskut ullet kërkohen në mënyrë të panevojshme masa të tilla.</p> <p>Proceset kryesore sipas objektivave, me qëllim adresimin e risqeve, duhet të vendosin “pronarët” e proceseve të punës, dhe jo Drejtorin e Përgjithshëm si “pronar” të tyre.</p> <p>Topologjia e riskut nuk është e plotë dhe e qartë, risqet e brendshme duhet të lidhen më shumë me planifikimin, proceset operacionale, burimet njerëzore (kapacitetet e nevojshme), anën ligjore të mbikëqyrjes (ndarjen e detyrave, caktimin e përgjegjëseve për punën e secilit punonjës).</p> <p>Në rregulloren e brendshme të ARRSH nuk janë përfshirë mjaftueshëm veprimtaritë e kontroleve parandaluese, për shkak se rregulloret nuk përshkruajnë me detaje proceset. Gjithashtu, veprimtaritë e kontroleve menaxheriale të pamjaftueshme kanë sjellë mungesën e përgjegjëseve të përcaktuara menaxheriale, siç është rasti i mungesës së marrëveshjes në zbatimin e programit “Për transportin rrugor” ndërmjet ARRSH dhe ministrisë përgjegjëse MEI. Për sa më sipër, për pasojë rezulton në një nivel i pamjaftueshëm implementimi i sistemit financiar dhe kontrollit (MFK).</p>
Kriteri:	<p>Ligji nr. 10 296, datë 08.07.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, neni 20, pika 2 shkronja c, neni 21 pika 1, neni 27.</p> <p>Ligji nr. 10 164, datë 15.10.2009 “Për Autoritetin Rrugor Shqiptar”, neni 6 pika 2.</p> <p>Urdhri nr. 108, datë 17.11.2016 i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Manuali për MFK”, pika 2.2.6, dhe pika 2.1 “Përgjegjësia menaxheriale”.</p>
Ndikimi:	Nivel i pamjaftueshëm i implementimit të MFK.
Shkaku:	Nuk kuptohet dhe zbatohet kuadri ligjor dhe rregullator.
Rëndësia:	E lartë.
1.1	Drejtori i Përgjithshëm i ARRSH, në cilësinë e nëpunësit autorizues, të

Rekomandimi:	<p>marrë të gjitha masat e nevojshme për rishikimin e rregullores së brendshme, në të cilën të përfshihen me detaje proceset kryesore të veprimtarisë së ARRSH dhe me këtë rast, veprimtaritë e domosdoshme parandaluese të kontrollit.</p> <p>Gjithashtu, të marrë të gjitha masat e nevojshme për funksionimin e një sistemi të shëndoshë financiar dhe të kontrollit, duke siguruar menaxhimin sistematik të risqeve që cenojnë veprimtarinë e ARRSH, si edhe funksionimin sistematik dhe të nevojshëm të grupit të menaxhimit strategjik (GMS).</p>
1.2 Rekomandimi:	<p>Drejtori i Përgjithshëm i ARRSH, të marrë të gjitha masat e nevojshme për krijimin dhe funksionimin e marrëveshjes me ministrinë e linjës MEI, për administrimin e programit “Transporti Rrugor”, me qëllim përcaktimin e përgjegjësive përkatëse menaxheriale të secilit institucion pjesëmarrës.</p>

2. Titulli i gjetjes:	Pavarësia e Auditit të Brendshëm.
Situata:	<p>Njësia e Auditit të Brendshëm nuk funksionon në mënyrë të decentralizuar si një veprimtari e pavarur funksionalisht, dhe është pjesë përbërëse e ekzekutivit në formën e sektorit dhe në varësinë e drejtorit të përgjithshëm të ARRSH, i cili miraton planin e angazhimeve të AB.</p> <p>Misioni i AB është të japë siguri të arsyeshme për titullarin e njësisë publike, në mënyrë të pavarur dhe objektive për sistemin e kontrollit të brendshëm.</p> <p>Auditimi i brendshëm, duke qenë një strukturë e varur nga Drejtori i përgjithshëm brenda ekzekutivit të ARRSH nuk arrin të kryejë një aktivitet të pavarur dhe objektiv, që jep siguri dhe këshilla, si dhe për t’i shtuar vlerë operacioneve të njësisë publike. Gjatë angazhimeve për zbatimin e rekomandimeve nuk kemi reagime nga subjekti i audituar.</p>
Kriteri:	<p>Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, neni 4 pika 22, ligji nr. 114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, neni 4 pika 19, <u>ku përcaktohet se:</u></p> <p><i>“Titullar i njësive publike, që drejtohen me organe vendimmarrëse kolegjiale, por që nuk organizohen si shoqëri tregtare, konsiderohet ky organ.”</i></p> <p>Urdhri nr. 108, datë 17.11.2016 të Ministrisë të Financave “Manuali për MFK”, pika 2.2.10, <u>ku përcaktohet se:</u></p> <p><i>“Auditimi i brendshëm është një aktivitet i pavarur, objektiv që jep siguri dhe këshilla dhe është i projektuar për t’i shtuar vlerë dhe përmirësuar operacionet e njësive publike. Ai i vjen në ndihmë njësive të arrijë objektivat e veta, duke sjellë një qasje sistematike dhe të disiplinuar për të vlerësuar dhe përmirësuar efektivitetin e menaxhimit të riskut, kontrollit dhe proceseve qeverisëse të njësive.</i></p> <p><i>Një njësi e pavarur e AB ofron garanci dhe jep rekomandime në mënyrë që i gjithë sistemi i MFK të funksionojë me efektivitet.”</i></p>
Ndikimi:	Nivel i pamjaftueshëm i pavarësisë të auditit të brendshëm.
Shkaku:	Përfshirja e sektorit të auditit të brendshëm në ekzekutivin e ARRSH, dhe në varësi funksionale nga drejtori i përgjithshëm.
Rëndësia:	E lartë.

2.1 Rekomandimi:	Drejtori i Përgjithshëm i ARRSH, të marrë të gjitha masat e nevojshme për kalimin e auditit të brendshëm jashtë strukturës ekzekutive të ARRSH, me qëllim sigurimin e funksionit të decentralizuar të auditimit të brendshëm, si një veprimtari e pavarur funksionalisht dhe që raporton në mënyrë të drejtpërdrejtë tek Bordi.
-----------------------------------	---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

Për veprimet dhe mosveprimet e trajtuara ngarkohen me përgjegjësi z. E. B., Drejtor i Përgjithshëm dhe në cilësinë e Nëpunësit Autorizues.

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga Auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me aktivitetin e organeve drejtuese rezulton se anëtarët e Bordit të Menaxhimit janë emëruar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 28, datë 17.01.2018 “Për emërimin e anëtarëve të bordit të menaxhimit të Autoritetit Shqiptar Rrugor”. Nëpërmjet Vendimit nr. 350, datë 16.06.2021, Këshilli i Ministrave vendosi përfundimin e mandatit të z. E. H. dhe nëpërmjet Vendimit nr. 455, datë 29.06.2022, vendosi zëvendësimin e tij me z. E. Ll.. Si rrjedhojë, për një vit, qershor 2021-qershor 2022, Bordi ka funksionuar me gjashtë anëtarë. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 10164, datë 15.10.2009 “Për Autoritetin Rrugor Shqiptar”, neni 8, pika 5.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 1 faqet nr. 18 – 22 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1 Rekomandimi: Kryetari i Bordit, nëpërmjet sekretariatit/sekretarit të bordit, të tregojë kujdes maksimal në mënyrë që në asnjë rast në vazhdim, Bordi të mos ushtrojë funksionimin e tij pa numër të plotë të anëtarëve, sikurse e përcakton ligji nr. 10164, datë 15.10.2009 “Për Autoritetin Rrugor Shqiptar”.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga Auditimi: Nga shqyrtimi i pjesëmarrjes së anëtarëve të Bordit në mbledhjet e zhvilluara, rezulton se gjatë vitit 2021, Kryetari i Bordit z. A. Sh. nuk ka marrë pjesë në 5 mbledhje, ose 42 % të mbledhjeve të zhvilluara dhe z. F. K., përfaqësues i Shoqatës Shqiptare të Inxhinierëve Konsulentë, nuk ka marrë pjesë në 8 mbledhje, ose 67 % të tyre. Gjatë vitit 2022, rezulton se z. J. H., përfaqësues i Ministrisë së Brendshme, nuk ka marrë pjesë në 8 mbledhje, ose 80 % të mbledhjeve të zhvilluara; dhe z. A. Sh. nuk ka marrë pjesë në 3 mbledhje nga 4 të zhvilluara, deri në zëvendësimin e tij me z. E. N. nëpërmjet Vendimit nr. 455, datë 09.06.2022 të Këshillit të Ministrave. Gjithashtu, nga shqyrtimi i pagesave të kryera për kryetarin dhe anëtarët e Bordit, rezulton se pagesa e tyre është bërë për numër vendimesh të marra dhe jo për numër mbledhjesh të zhvilluara. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 10164 datë 15.10.2009 “Për Autoritetin Rrugor Shqiptar”, neni 10 mbi largimin nga detyra të anëtarëve të bordit, pika c si dhe VKM nr. 656, datë 31.10.2018 “Përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të përhershme të njësisive të qeverisjes qendrore”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 1 faqet nr. 18 – 22 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1 Rekomandimi: Sekretari/sekretariati i Bordit të ndjekë me përgjegjshmëri pjesëmarrjen e anëtarëve të Bordit, në mënyrë që të respektohet kriteri i pjesëmarrjes minimale në 2/3 e mbledhjeve të zhvilluara gjatë vitit. Në rastet kur konstatohet tejkalim i këtij kriteri, të njoftohet Kryetari i Bordit, me qëllim marrjen e masave për të vënë në dijeni organin që e ka emëruar.

Menjëherë dhe në vijimësi

2.2 Rekomandimi: Sekretari/sekretariati i Bordit të ndjekë me përgjegjshmëri pjesëmarrjen e anëtarëve të bordit dhe pagesa të llogaritet për numër takimesh dhe jo për numër vendimesh dhe nga ana e Drejtorisë së Financës të kontrollohet saktësia e dokumentacionit përpara kryerjes së pagesave.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga Auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me aktivitetin e organeve drejtuese rezulton se Vendimet e Bordit nuk kanë një rend dite të përcaktuar nga Kryetari si dhe nuk janë të shoqëruara me procesverbalet e mbledhjes. Në këtë rast, grupi i auditimit e kishte të pamundur të vlerësonte rendin e ditës, çështjet e diskutuara,

vendimet që u morën, si dhe formën dhe rezultatin e votimeve. Gjithashtu, disa nga Vendimet e Bordit, që i janë vënë në dispozicion grupit të auditimit, nuk kanë bashkëlidhur asnjë dokumentacion shpjegues në mënyrë që të kuptohet se mbi bazën e çfarë dokumentacioni apo informacioni është marrë vendimi. Edhe pse grupi i auditimit kërkoi vazhdimisht praktikën që duhet të ishte bashkëlidhur këtyre vendimeve, deri në përfundim të auditimit nuk u vu në dispozicion asnjë dokument. Pra në këtë rast mungon gjurma e auditimit. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, neni 16, ligjin nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore”, neni 7 dhe neni 16, Detyrat e sektorit të Arkiv Protokollit në Rregulloren e Brendshme të Funksionimit të Autoritetit Rrugor Shqiptar, miratuar me Vendimin e Bordit nr. 10, datë 04.09.2018 si dhe përcaktimet në normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, në mbështetje të ligjit nr. 9154 datë 06.11.2003 “Për arkivat”, neni 15, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 1 faqet nr. 18 – 22 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1 Rekomandimi: Nga ana e Kryetarit të Bordit të merren masa për përcaktimin e rendit e ditës për çdo mbledhje të zhvilluar. Gjithashtu, Sekretari/sekretariati i Bordit të mbajë procesverbalet e mbledhjes në të cilat të përmbledhë gjithçka që thuhet dhe diskutohet në mbledhje, anëtarët që morën pjesë, çështjet që u diskutuan, vendimet që u morën, si dhe formën dhe rezultatin e votimeve.

Menjëherë dhe në vijimësi

3.2 Rekomandimi: Nga ana e Sekretarit/sekretariatit të Bordit të merren masa që vendimet e Bordit të kenë të gjithë dokumentacionin shpjegues dhe justifikues bashkëlidhur dhe njëkohësisht Sektori i protokoll arkivës në asnjë rast të mos pranojë Vendimet e Bordit pa dokumentacionin e plotë bashkëlidhur.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi rezulton se Sekretari i Bordit është propozuar nga Drejtori i Përgjithshëm dhe është miratuar nga Bordi por nuk ka zbatuar kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore”, pasi në Rregulloren e Brendshme të ARRSH nuk ka përkrahim të detyrave të tij.

Rregullorja e brendshme, edhe pse është miratuar nga vetë Bordi, me Vendimin nr. 10, datë 04.09.2018, nuk përmban rregullat për mënyrën e funksionimit të bordit. Sa më sipër është në kundërshtim me VKM nr. 276, datë 16.5.2018 “Për miratimin e mënyrës së organizimit, të strukturës, organikës dhe statutit të Autoritetit Rrugor Shqiptar” pika III/3 si dhe VKM nr. 276, pika III/3/ç.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 1 faqet nr. 18 – 22 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të merren masa për rishikimin e rregullores së brendshme të institucionit në të cilën të përshkruhen me detaje detyrat e sekretarit/sekretariatit të bordit, mënyra e funksionimit të bordit, hallkat e komunikimit dhe raportimit brenda dhe jashtë institucionit.

Menjëherë

5. Gjetje nga Auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me buxhetin rezultojnë shpenzime publike të paplanifikuara në fillim të vitit dhe jashtë vitit buxhetor për të cilin janë parashikuar. Konkretisht, procedura e hapur e thjeshtuar e prokurimit me numër REF-98245-06-16- 2021 me objekt “Për mirëmbajtjen rutinë me performancë e segmentit rrugor Kryqëzim Qafa e Buallit-Fillim Rruga e Arbërit, me gjatësi 4.5 km” është kryer si rrjedhim i rialokimit të buxhetit të vitit 2021 për të cilën është lidhur kontrata nr. 5807 prot.,

datë 30.07.2021 në vlerën totale 744,000 lekë me TVSH, për periudhën 01.08.2021-31.12.2021. Segmenti rrugor i sipërcituar ka qenë i përfshirë në projektin e Bankës Botërore “Mirëmbajtje dhe siguri rrugore bazuar në rezultate” deri në tetor të vitit 2020. Po për të njëjtin objekt prokurimi, me urdhrin e prokurimit nr. 328 prot., datë 17.12.2021 dhe fond limit në vlerën prej 673,069.⁵⁰ lekë pa TVSH, është kryer procedura *me vlerë të vogël* në datën 21.12.2021 për mirëmbaje për periudhën 01.01.2022-31.03.2022. Për këtë procedurë është lidhur kontrata nr. 11476/2 prot., datë 30.12.2021, pa mbaruar kontrata e mëparshme për të njëjtin objekt prokurimi. Me shkresën nr. 9295/1 prot., datë 15.10.2021 është miratuar rialokimi i fondit prej 161,600 lekë, ose afërsisht 20 % nga kontrata e sipërcituar. Nga sa më sipër rezulton se:

- është vepruar në kundërshtim me VKM nr. 285 datë 19.05.2021 RrPP, neni 106 pika 1 dhe 2, e ndryshuar, pasi procedura e prokurimit në vlerë të vogël duhet të jetë bazuar në fondin e vitit buxhetor 2021;

- nuk është respektuar e drejta për të kryer shpenzime brenda kufirit të fondeve të miratuara, e cila skadon ditën e fundit të vitit buxhetor, pavarësisht nëse kontrata njëvjeçare ose shumëvjeçare mund të vazhdojë edhe në vitin buxhetor pasardhës;

- angazhimi i ri buxhetor (nënshkrimi i kontratës) për kontratën e dytë është kryer më vonë se data 15 Tetor e vitit buxhetor 2021, pra përtej afateve që parashikon udhëzimi nr. 9, datë 20.03.2018 i Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pikat 41, 69, 71, 79, 83.

- stafi i ARRSH nuk është plotësisht i qartë dhe i informuar për të drejtat dhe detyrimet gjatë zbatimit të buxhetit dhe nëpunësi i autorizuar nuk provon se ka deleguar rregullat dhe procedura të miratuara në bordin e ARRSH për përgjegjësitë individuale gjatë zbatimit të buxhetit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqet nr. 23 – 26 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të ARRSH, në cilësinë e nëpunësit të autorizuar të merren të gjitha masat e nevojshme për analizën e nevojave të domosdoshme dhe planifikimin në kohën e duhur të shpenzimeve publike, me qëllim realizimin e shpenzimeve me eficiencën e duhur.

Në vijimësi

5.2 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të ARRSH, në cilësinë e nëpunësit të autorizuar të merren të gjitha masat e nevojshme për hartimin, miratimin në bord dhe delegimin e rregullave specifike dhe procedurave që duhet të ndiqen në procesin e zbatimit të buxhetit, me qëllim që çdo individ të jetë i qartë dhe i informuar plotësisht mbi përgjegjësitë e tij.

Në vijimësi

6. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi i procedurave për blerje të vogla rezulton se në 4 raste, operatorët ekonomikë fitues janë paraqitur me oferta me vlerë më të ulët nga ajo e dërguar për verifikimin e tregut për vlerësimin e fondit limit. Ofertat e mësipërme janë prezantuar me vlera të ndryshme për të njëjtën objekt prokurimi dhe praktikisht në të njëjtën kohë, si më poshtë:

- Procedura e prokurimit me objekt “Blerje materiale pastrimi” me numrin e referencës REF-89466-09-03-2021 dhe fond limit në vlerën prej 407,633 lekë pa TVSH.

Në SPE, në datën 10.03.2021, është shpallur oferta fituese, operatori M. V. në vlerën prej 338,300 lekë pa TVSH.

Në procesverbalin e llogaritjes së fondit limit nr. 2199/2 prot, datë 08.03.2021, operatori M. V. është prezantuar me ofertën në vlerën prej 403,375 lekë pa TVSH.

- Procedura e prokurimit me objekt “Blerje goma për automjete” me numrin e referencës REF-00769-12-07-2021 dhe fond limit në vlerën prej 625,000 lekë pa TVSH.

Në SPE, në datën 14.07.2021, është shpallur oferta fituese, OE P... I... në vlerën prej 459,000 lekë pa TVSH.

Në procesverbalin e llogaritjes së fondit limit nr. 6197/1 prot, datë 09.07.2021 OE P... I... është prezantuar me ofertën në vlerën prej 590,000 lekë pa TVSH.

- Procedura e prokurimit me objekt “Blerje tonera dhe dramer të ndryshme” me numrin e referencës REF-13778-02-12-2021 dhe fond limit në vlerën prej 296,340.3 lekë pa TVSH.

Në SPE, në datën 03.12.2021 është shpallur oferta fituese, OE S... C... në vlerën prej 293,980 lekë pa TVSH.

Në procesverbalin e llogaritjes së fondit limit nr. 9855/2 prot, datë 02.12.2021, OE S... C... është prezantuar me ofertën në vlerën prej 289,112 lekë pa TVSH.

- Procedura e prokurimit me objekt “Blerje goma për automjetet” është kryer në zbatim të Urdhrit të Prokurimit nr. 265 datë 03.11.2022 dhe fond limit në vlerën prej 998,933.3 lekë pa TVSH.

Në SPE, në datën 04.11.2022 është shpallur oferta fituese, OE “A... T...” SHPK në vlerën prej 719,000 lekë pa TVSH.

Në procesverbalin e llogaritjes së fondit limit nr. 9026/1, datë 26.10.2022, OE A... T... është prezantuar me ofertën në vlerën prej 1,016,800 lekë pa TVSH.

Në zbatim të pikave 1 dhe 3 të Udhëzimit nr. 11 datë 30.05.2018 të Agjencisë Prokurimit Publik, komisioni i prokurimit në vlerë të vogël, ka detyrimin të krahasojë ofertat e paraqitura nga OE^{-kë} në sistemin elektronik të prokurimeve me fondin limit të përcaktuar më parë me qëllim që oferta e OE të jetë sa më reale.

Për arsye që, fondi limit të jetë një bazë krahasuese reale, ky fond llogaritet përpara urdhrit të prokurimit dhe i shërben vetëm komisionit të prokurimit. Ofertat e operatorëve fitues, nga dekritimi në sistemin elektronik, kanë rezultuar në një vlerë më të ulët se ofertat që ata kanë depozituar për llogaritjen e fondit limit, praktika e së cilës është vënë në dispozicion të komisionit të prokurimeve. Pranimi nga ana e komisionit të prokurimeve, të ofertave të operatorëve fitues në SPE, ka sjellë deformimin e procesit të krahasimit të këtyre ofertave me fondin limit, për arsye se këta ofertues kanë ndryshuar praktikisht në të njëjtën kohë të njëjtën ofertë në një vlerë më të ulët. Veprimet e mësipërme të komisionit të prokurimeve të vogla bien në kundërshtim me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014, neni 63 pika 3, i ndryshuar, dhe në kundërshtim me, VKM Nr. 285, datë 19.05.2021, neni 13 pika 4, neni 79 pika 4.

Ekzistenca e 2 ofertave të sipërcituara për OE fitues, për të njëjtën objekt prokurimi dhe praktikisht në të njëjtën kohë, ka sjellë si pasojë deformimin e vlerësimit dhe të konkurrencës gjatë kryerjes së procedurës të prokurimit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet nr. 27 – 36 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të sigurohet që proceset e prokurimeve të përfshihen në një manual për prokurimin, me qëllim identifikimin e përgjegjësive individuale, dokumentacionin përkatës të miratuar për hapat e procesit, vendimmarrjen individuale, të drejtat dhe detyrimet, që duhet të ushtrohen gjatë zbatimit të këtyre procedurave me qëllim orientimin e komisioneve me dispozitat e aplikueshme në kuadrin ligjor dhe rregullator.

Menjëherë

7. Gjetje nga Auditimi: Autoriteti Kontraktor (ARRSH) në momentin e hartimit të regjistrave të parashikimit, për përcaktimin e procedurës së blerjes në vlerë të vogël nuk ka marrë parasysh grupin e mallrave apo shërbimeve të ngjashme, sipas natyrës, sasisë dhe llojit të kontratës, të cilat kanë të njëjtin funksion kryesor apo kanë të njëjtin emërtim në planin e shpenzimeve.

Në 6 raste, gjatë hartimit të regjistrave të parashikimeve në prokurime është evidentuar shmangie nga procedurat përkatëse të prokurimit, duke shkaktuar copëzimin e fondeve apo të kontratave.

-Procedura me objekt prokurimi “Blerje tonera dhe dreme të ndryshëm” - tonera për makina fotokopjuese, me fond limit në vlerën prej 800,000 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 23.04.2021 dhe realizuar në vlerën prej 699,000 lekë pa TVSH.

Procedura me objekt prokurimi “Blerje tonera dhe dreme të ndryshëm” - tonera për printer dhe fax, me fond limit në vlerën prej 361,200 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 03.12.2021 dhe realizuar në vlerën prej 293,980 lekë pa TVSH.

Të dy procedurat e ngjashme të sipërcituara, gjatë planifikimit rezultojnë së bashku në vlerën 1,161,200 lekë, duke tejkaluar në këtë mënyrë me **161,200 lekë** pragun e procedurës së prokurimit në vlerë të vogël.

-Procedura me objekt prokurimi “Shpenzime për mirëmbajtjen e objekteve ndërtimore (lyerje ambientesh dhe zyrash, riparime hidraulike etj.)” me fond limit 800,000 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 12.04.2021 dhe realizuar në vlerën 276,525 lekë pa TVSH.

-Procedura me objekt prokurimi “Shpenzime për mirëmbajtjen e zyrave të laboratorit të ARRSH (lyerje ambientesh dhe zyrash, riparime hidraulike, elektrike pllakash etj.)” me fond limit në vlerën prej 1,000,000 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 16.07.2021 dhe realizuar në vlerën 780,000 lekë pa TVSH.

Të dy procedurat e ngjashme të sipërcituara, gjatë planifikimit rezultojnë së bashku në vlerën 1,800,000 lekë, duke tejkaluar në këtë mënyrë me **800,000 lekë** pragun e procedurës së prokurimit në vlerë të vogël.

-Procedura me objekt prokurimi “Shpenzime për blerje Software Autocad” me fond limit 1,000,000 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 06.12.2022 dhe realizuar në vlerën 959,000 lekë pa TVSH.

-Procedura me objekt prokurimi “Shpenzime për mirëmbajtjen e pajisjeve kompjuterike dhe elektronike” me fond limit në vlerën prej 1,000,000 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 13.10.2022 dhe realizuar në vlerën 915,600 lekë pa TVSH.

Të dy procedurat e ngjashme të sipërcituara, gjatë planifikimit rezultojnë së bashku në vlerën 2,000,000 lekë, duke tejkaluar në këtë mënyrë me **1,000,000 lekë** pragun e procedurës së prokurimit në vlerë të vogël.

Nga auditimi, rezultojnë se janë emëruar personat përgjegjës për prokurimin për hartimin e regjistrave të prokurimit, megjithatë mungojnë linja të qarta raportimi, përfshirje e aktorëve të domosdoshëm, vendimmarrje dhe përgjegjësi të përcaktuara. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me Udhëzimin nr. 03, datë 08.01.2018, pikat 3, 4, me Udhëzimin nr. 05, datë 25.06.2021, pikën 3, në kundërshtim me Vendimin nr. 285 datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, nenin 56, pika 2 dhe 11, duke shkaktuar copëzimin e fondeve apo kontratave, për pasojë kufizimin e procedurave konkurruese të prokurimit. Sa më sipër është në kundërshtim me VKM nr. 285 datë 19.05.2021, neni 56 pika 2 si dhe Udhëzimin nr. 3, datë 08.01.2018 i APP, pika 3 dhe 4.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet nr. 27 – 36 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Përputhshmërisë së Standardeve si dhe Përgjegjësi i Sektorit të Prokurimeve, të merren masat e nevojshme, që në procesin e hartimit të regjistrit të parashikimeve të prokurimeve të përfshihen linja të qarta bashkëpunimi, raportimi dhe përgjegjësi të përcaktuara, me qëllim që të shmangët kufizimi i procedurave konkurruese të prokurimit dhe copëzimi i fondeve publike.

Në vijimësi

8. Gjetje nga Auditimi: Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se Regjistri i Aktiveve të ARRSH, përfshihen: tag numri, emërtimi, njësia matëse/targa e mjetit, çmimi, gjendja në fund të vitit paraardhës (31.12.2021) e shprehur në sasi dhe vleftë, fletë hyrje dhe fletë dalje (numër, datë, sasia, dhe vlefta), si dhe gjendja në fund të vitit korrent (31.12.2022). Pra në këtë regjistër nuk paraqiten të dhëna lidhur me vlerën e shpenzimeve kapitale të mëposhme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia. Sa më sipër është në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, neni 30.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet nr. 27 – 36 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.1 Rekomandimi: Nga Sektori i Financës të përditësohet Regjistri i Aktiveve, pasi të jenë kryer vlerësimet lidhur me vlerën e mbetur dhe jetën e dobishme të aktiveve me vlera materiale të cilat ndikojnë në rezultatin financiar.

Menjëherë

9. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi ka rezultuar se lidhur me shitjen e skrapit janë realizuar dy procedura ankandi, të cilat janë anuluar dhe në vijim nga ana e ARRSH nuk janë marrë masa lidhur me kryerjen e mëtejshme të procedurave të ankandit, në mënyrë që të realizohet shitja e skrapit. Sa më sipër është në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar pika 109.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet nr. 27 – 36 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9.1 Rekomandimi: Sektori i Financës dhe Sektori Juridik të marrin masa lidhur me realizimin e procedurës së ankandit lidhur me shitjen e skrapit dhe ndjekjen me përgjegjshmëri të hapave lidhur me plotësimin e dokumentacionit përkatës.

Menjëherë

10. Gjetje nga Auditimi: Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se nuk janë evidentuar në kontabilitet “Rrugët dhe rrjetet rrugore”. Për pasojë, nuk ka një vlerë të saktë dhe të drejtë të zërave të mësipërm dhe vlerës së konsoliduar në pasqyrat financiare të shtetit. Deri në fund të vitit 2021 mungon një inventar i plotë e i azhornuar i rrjetit rrugor, me të dhëna për gjatësinë e rrugëve të përfunduara dhe të kolauduara (me të dhëna të plota mbi gjatësitë, kategoritë e rrugës dhe vlerën kontabël respektive që referuar planit duhej të pasqyroheshin në analiza të veçanta sipas ndarjes së përcaktuar në “Kodin Rrugor Shqiptar”), të analizuar në llogarinë 213 “Rrugë, rrjete dhe vepra ujore”. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 2, pika 2.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet nr. 27 – 36 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

10.1 Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm, Sektori i Financës dhe Sektori Juridik të marrin masa lidhur me realizimin e inventarizimit dhe plotësimit të regjistrit të rrugëve dhe rrjeteve rrugore.

Menjëherë

11. Gjetje nga Auditimi: Autoriteti Rrugor Shqiptar, në cilësinë e subjektit në favor të së cilit bëhet shpronësimi ka paraqitur pranë Agjencisë Shtetërore për Shpronësim kërkesat për shpronësim të cilat janë finalizuar duke u miratuar me Vendime të Këshillit të Ministrave në vlerën 3,312,523,392 lekë, nga të cilat rezulton të jenë shlyer 39 % e kësaj vlere. Diferenca e mbetur e mos likuidimit është për shkak se pronarët e pasurive të shpronësuara nuk kanë depozituar pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar dokumentacioni ligjor për likuidim. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë së paluajtshme pronë private për interes publik”, i

ndryshuar, neni 190 "Fitimi i pronësisë me anë të shpronësimit", ligji nr. 7850, datë 29.07.1994 "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar si dhe VKM nr. 138, datë 23.03.2000 "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik" i ndryshuar, pika 2, 3 dhe 4.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet nr. 27 – 36 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

11.1 Rekomandimi: Nga Sektorit i Financës dhe Sektori i Sigurimit të Tokës të analizohet situata e mos likuidimit të pronarëve të pasurive të shpronësuara si dhe të merren masa lidhur me likuidimin e tyre.

Menjëherë

12. Gjetje nga Auditimi: Në regjistrimin e pasurisë së paluajtshme u konstatua se nga ana e strukturave drejtuese të ARRSH, për periudhën objekt auditimi, këto pasuri rezultojnë të regjistruara në mënyrë jo të plotë në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurisë dhe më pas në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, në kundërshtim kjo me përcaktimet e ligjit nr. 8743, datë 22.02.2001 "Për pasuritë e paluajtshme shtetërore", i ndryshuar si dhe kërkesat e ligjit nr. 33/2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", VKM nr. 155, datë 02.03.2011 dhe VKM nr. 3, datë 07.01.2005. Konkretisht rezulton se nuk është regjistruar sipërfaqja totale e Ndërtesës së ARRSH prej 1.379,92 m² por është pasqyruar në kartelën dhe certifikatën e regjistrimit të pronësisë në ZVRPP vetëm 439 m², ose nuk janë regjistruar në kartelat e pronësisë së institucionit 940.92 m². Bazuar në Fletën e Inventarit të hartuar nga Komisioni i Inventarizimit të pasurisë, në inventarin e llog. 212. "Ndërtesa" përfshihen 6 zëra (nga këto, një objekt është godina e ARRSH me përfshirjen e Katiti 2, 3, 4, 5 dhe shtesës) dhe objektit "Laboratori", me vlerë kontabël prej 3,622,664 lekë. Nga krahasimi i Hartës Treguese dt. 29.01.2019 që shoqëron Vërtetimin e Pronësisë ZVRPP Tiranë të datës 23.04.2019, me Planin e Rilevimit që shoqëron VKM nr. 788, datë 07.10.2020, konstatohen mospërputhje në pasqyrimin e objekteve ndërtimore, si vijon: Në Certifikatën për Vërtetimin e Pronësisë me nr. 1867034, datë 23.4.2019 për ZK nr. 8320, nuk janë pasqyruar dy objektet (objekti "H" sipas Plan Rilevimit që shoqëron VKM nr. 788, datë 07.10.2020, përkatësisht me sipërfaqe 401 m² dhe një shtojcë ngjitur me zyrat 2 katëshe). Për DRV Shkodër: Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion, nuk është regjistruar pronësia dhe nuk disponohen certifikata për DRV Shkodër nga ZVRPP e përfshira në këtë rajon dhe sipas pasqyrave të inventarit të dërguara në ARRSH shumica e objekteve rezultojnë të dëmtuara. Për DRJ Gjirokastër: Rezulton se bazuar në certifikatën e pronësisë sipërfaqja e truallit rezulton 3,556 m², ndërsa sipas VKM nr. 3, datë 07.01.2005 rezultojnë sipërfaqe trualli prej 2,607 m², duke mos patur përputhje të këtyre shifrave dhe arsyetim të gjurmës së auditimit për diferencën e sipërfaqes së regjistruar me atë sipas VKM përkatëse. Sipas VKM nr. 789, datë 07.10.2020 është vendosur ndryshimi i përgjegjësisë së administrimit të kësaj pasurie me sipërfaqe prej 3,556 m² duke kaluar nga ARRSH te DPSHTR. Për objektet e tjera të përfshira në këtë rajon nuk disponohen certifikatat e regjistrimit të pronësisë. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 8743, datë 22.02.2001 "Për pasuritë e paluajtshme shtetërore", i ndryshuar si dhe kërkesat e ligjit nr. 33/2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", VKM nr. 155, datë 02.03.2011 dhe VKM nr. 3, datë 07.01.2005, gjë që tregon për parregullsi dhe pasaktësi dokumentare dhe bën të domosdoshëm rifreskimin e kartelave të regjistrimit të kësaj pasurie si dhe UMF nr. 8, 2018, kreu 3.7, paragrafi 85, në lidhje me shënimet shpjeguese që shoqërojnë pasqyrat financiare vjetore, pasi ato nuk japin informacion të 52 përgjithshëm në lidhje me rakordimet financiare me debitorët dhe kreditorët në lidhje me elementë specifikë të pasqyrave financiare të dorëzuara, etj.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet nr. 27 – 36 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

12.1 Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm dhe Drejtorët e Drejtorive Rajonale të marrin masa lidhur me ndjekjen e hapave ligjorë të menjëhershëm për regjistrimin e pasurive të paluajtshme në ZVRPP/ ASHK, me qëllim pajisjen me dokumentacionin e plotë hipotekor.

Menjëherë

13. Gjetje nga Auditimi: Sipas programit ekonomik për vitin 2020, numri mesatar i punonjësve ka qenë programuar 112 punonjës gjithsej, ndërsa sipas statistikave të punës rezulton se numri mesatar i të punësuarve në të vitit 2020 është realizuar 110 punonjës. Fondi i pagave është 86,968,000 lekë, pra realizimi është 1,617,674 lekë më pak se programi.

Sipas programit ekonomik për vitin 2021, numri mesatar i punonjësve ka qenë programuar 112 punonjës gjithsej, ndërsa sipas statistikave të punës rezulton se numri mesatar i të punësuarve në të vitit 2021 është realizuar 105 punonjës. Fondi i pagave është 87,029,000 lekë, pra realizimi është 950,930 lekë më pak se programi.

Sipas programit ekonomik për vitin 2022, numri mesatar i punonjësve ka qenë programuar 117 punonjës gjithsej, ndërsa sipas statistikave të punës rezulton se numri mesatar i të punësuarve në të vitit 2022 është realizuar 108 punonjës. Fondi i pagave është 85,951,461 lekë, pra është realizuar 100 %. Sa më sipër është në kundërshtim me.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqet nr. 37 – 38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

13.1 Rekomandimi: Nga Drejtori i Përgjithshëm dhe Sektori i Burimeve Njerëzore të merren masa për plotësimin e nevojave për punonjës të ARRSH - së referuar parashikimeve të programit ekonomik.

Në vijimësi

14. Gjetje nga Auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me rekrutimet e punonjësve rezulton se:

- Për mënyrën e përzgjedhjes së kandidatëve për punë nga Burimet Njerëzore gjatë periudhës objekt auditimi, janë rekrutuar 24 punonjës, nga të cilët në 15 raste është shpallur vakanca e vendit të punës në faqen web dhe janë kryer procedurat e rekrutimit, pra në 62,5 % të tyre.

- Nga auditimi rezulton se në asnjë rast nuk ka patur konkurrencë, pra ka patur vetëm një kandidat për çdo pozicion pune.

- Gjatë periudhës objekt auditimi në total janë dhënë 39 masa disiplinore, nga këto 28 “Vërejtje”, 4 masa “Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna”, 1 masë “Kalim në një detyrë të një niveli apo klase më të ulët” dhe 6 masa “Pushim nga puna”. Nga auditimi i procedurës së dhënies së masave disiplinore konstatohet se nuk ka procedura transparente, pasi nuk ka të dhëna lidhur me mënyrën e marrjes të këtyre masave dhe nuk ka komision apelimi. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i punës i Republikës të Shqipërisë”, i ndryshuar me ligj nr. 136/2015, datë 05.12.2015, neni 11, 12, 37 dhe 37.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqet nr. 37 – 38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

14.1 Rekomandimi: Nga Drejtori i Përgjithshëm dhe Sektori i Burimeve Njerëzore, të merren masa për ndjekjen me përgjegjësi të procedurave të rekrutimit të punonjësve të rinj, dhe hartimi dhe miratimi i rregulloreve për emërimin dhe procedurat e lëvizjeve të stafit të ARRSH.

Në vijimësi

14.2 Rekomandimi: Nga Drejtori i Përgjithshëm dhe Sektori i Burimeve Njerëzore, të merren masa për ndjekjen me përgjegjësi dhe transparencë të procedurave të dhënies së masave disiplinore, si dhe ngritjen e komisionit përkatës të apelimit.

Në vijimësi

15. Gjetje nga Auditimi: Sipas DT rezulton se kriteri i përzgjedhjes së fituesit është përcaktuar oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto duke përdorur sistemin me pikë. Në fakt, referuar nenit 87 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, pika 4 citohet se: “Kriteret për shpalljen e kontratës fituese nuk i japin autoritetit ose entit kontraktor një liri të pakufizuar zgjedhjeje. Ato garantojnë mundësinë e konkurrencës efektive dhe shoqërohen nga specifikime, të cilat lejojnë që informacionet e dhëna nga ofertuesit të verifikohen për të vlerësuar nëse ofertat përmbushin kriteret për shpalljen e kontratës fituese ...”. Gjithashtu, referuar VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 45 Kriteret për shpalljen e ofertës fituese, pika 3 citohet se: “Për punët/mallrat/shërbimet, që kanë specifikime të thjeshta, standarde teknike të mirënjohura dhe janë lehtësisht të gjendura në treg, oferta ekonomikisht më e favorshme bazohet në çmimin si i vetmi element i ndryshueshëm ndërmjet ofertave”. Përzgjedhja e metodës bazuar në kosto nuk është në përputhje me parimet kryesore të Ligjit të Prokurimit Publik. Kjo do të thotë se nga ana e AK do të duhet të ishin përcaktuar vetëm kriteret e veçanta të kualifikimit dhe oferta ekonomikisht më e favorshme të përzgjidhej në bazë të çmimit dhe jo të koston pasi punimet e ndërtimit janë me standarde të njohura kombëtare e ndërkombëtare e përveç çmimit OE pjesëmarrës, praktikisht nuk kanë se me çfarë të konkurrojnë tjetër. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, neni 87, pika 4 si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 45 Kriteret për shpalljen e ofertës fituese, pika 3.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet nr. 39 – 64 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

15.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të ARRSH të merren masa të menjëhershme për rishikimin në procedurat e prokurimeve të zhvilluara nga ana e ARRSH, përfshirë ato në proces, të kriterit të vlerësimit të ofertës fituese me pikë si më sipër pasi kjo metodë nuk rrit efikasitetin dhe efikasitetin e procedurave, nuk arrin të sigurojë mirë përdorim të fondeve publike dhe ulje të shpenzimeve procedurale, nuk nxit pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë, nuk nxit konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë dhe si e tillë krijon kushte për përdorim pa EEE të fondeve publike.

Menjëherë

16. Gjetje nga Auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me procedurat e prokurimit të zhvilluara rezulton se janë vendosur kriteret të paargumentuara teknikisht dhe ligjërish për sa i takon numrit të punonjësve të kërkuar, numrit dhe kualifikimeve të stafit kryesor teknik dhe atij mbështetës si dhe numrit dhe kapacitetit të mjeteve në disa raste. Konkretisht janë vendosur kriteret si më poshtë:

Kriteri: “Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë fuqi punëtore minimalisht ... persona.”

NJP në këtë rast, përveçse ka cituar bazën ligjore (nenin 77, pika 4 të Ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”) është shprehur ndër të tjera se:

“Numri i punonjësve është përcaktuar bazuar në afatin, orët e punës dhe pagën minimale të lejuar, që duhen për të përmbushur zbatimin e kontratës ... ”

Në fakt, sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, konkretisht procesverbaleve të argumentimit të kriterëve rezulton se nuk ka ndonjë llogaritje analitike në raport me grafikun e punimeve, kapacitet e mjeteve si dhe normativat përkatëse se prej nga ka rezultuar një numër të punësuarish në lidhje me këtë kontratë pavarësisht faktit nëse ky numër mund të jetë ose jo i mjaftueshëm.

Kriteri: “Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, si më poshtë: ..

Kriteri: “Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe stafin mbështetës (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë: ...

Konstatohet se argumentimi i bërë për stafin në cilësinë e drejtuesit teknik është i njëjtë me atë të dhënë edhe për stafin mbështetës (copy – paste) dhe gjithashtu nuk është e argumentuar kërkesa për diferencimin mes stafit të kërkuar si pjesë e licencës së shoqërisë dhe atyre si staf mbështetës me kontratë, jo domosdoshmërisht në licencën e shoqërisë.

Kriteri: “Operatoret ekonomike duhet te paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ...

Në fakt, referuar preventivit dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion nuk rezulton i argumentuar teknikisht në çdo rast domosdoshmëria e disponimit të niveleve të kërkuara të kategorive të licencave.

Kriteri: “Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, konkretisht procesverbaleve të argumentimit të kriterëve rezulton se nuk ka një sqarim konkret për të argumentuar numrin llojin dhe kapacitetet e mjeteve të vendosura.

Kriteri: “Operatori ekonomik duhet të disponojë programin “PLS CADD and TOWER”, për projektimin e linjave elektrike.

Në lidhje me këtë kriter NJP nuk ka argumentuar domosdoshmërinë që lidhet me disponimin e këtij programi pasi programi i kërkuar është një software i cili, sipas citimit të bërë nga ana e NJP, është për projektimin e linjave elektrike, kur kontrata në fjalë është e llojit Punë.

Kriteri: “Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

Kriteri: “Operatori ekonomik duhet të ketë realizuar gjatë 5 (pesë) viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së përlogaritur për QMT, sipas relacionit teknik. Ku përfshihet edhe qendër monitorimi trafiku (ndërtimi dhe pajisja, kontrolli dhe monitorimi në rrugë, tunele dhe autostrada të kësaj kategorie) të realizuara në një kontratë të ngjashme.”

Në fakt vendosja e këtij kriteri është në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ‘Për miratimin e rregullave të prokurimit publik’, neni 39, pika 5 pasi kjo dispozitë ligjore ka parashikuar saktësisht se cilat janë dëshmitë që do të merren në shqyrtim nga Autoritetet Kontraktore për të vlerësuar përvojën e mëparshme. Në lidhje me punët e ngjashme AK duhet të kishte kërkuar të tilla në raport vlerën e parashikuar të kontratës që prokurohet, pra në raport me fondin limit dhe jo për kategori të veçanta zërash në preventiv, apo për një zë i cili sipas relacionit teknik ka një vlerë prej 306,752,162.48 lekë, ose gati 13 % të të gjithë vlerës së parashikuar të kontratës.

Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Neni 1, “Objekti”, pika 1 dhe 2, Neni 2 “Qëllimi”, Neni 3 “Parime të përgjithshme”, Neni 21 “Autoriteti ose enti kontraktor”, Neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 1, germa a, b dhe c, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ‘Për miratimin e rregullave të prokurimit publik’, Neni 39 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike”, pika 2 dhe 4 si dhe Neni 39, pika 5, germa a dhe b, Neni 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, pika 1 dhe 2.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet nr. 39 – 64 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

16.1 Rekomandimi: Nga ana e ARRSH të merren masa për vendosjen në procedurat e prokurimit të kriterëve të argumentuara teknikisht dhe ligjërisht si dhe në raport me nevojat e investimit me qëllim përdorimin e fondeve me efektivitet, efijencës dhe economicitet.

Menjëherë

17. Gjetje nga Auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me procedurat e prokurimit të zhvilluara rezulton se për atë me objekt *‘Ndërtimi i Unazës së jashtme Tiranë, Loti 4’*, pavarësisht faktit se BOE i shpallur fitues ka deklaruar në ofertën e tij në SPE se garancia e punimeve do të jetë 3 vite nga data e kolaudimit të punimeve, kontrata e lidhur sipas aktit me nr. 7354/6 prot., datë 11.11.2021, në Kushtet e Veçanta të Kontratës, neni 11 *Garancia e defekteve*, ka cituar se kjo periudhë do të zgjas 2 vite. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020, *“Për prokurimin publik”*, i ndryshuar, Neni 122, pika 1. (Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet nr. 39 – 64 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

17.1 Rekomandimi: Nga ana e ARRSH të merren masa për modifikimin e kontratës së lidhur sipas aktit nr. 7354/6 prot., datë 11.11.2021, të Kushteve të Veçanta të Kontratës, konkretisht neni 11 *Garancia e defekteve*, duke ndryshuar periudhën e garancisë nga 2 në 3 vite, aq sa ka ofruar fituesi i kësaj procedure BOE E... P... & P...U & N... K.... 2.

Menjëherë

18. Gjetje nga Auditimi: Sipas dokumentacionit të ngarkuar në SPE nga ana e OE fitues rezulton se në 2 raste, konkretisht në procedurat me objekt:

1. Ndërtimi i Unazës së jashtme Tiranë, Loti 2

Nga ana e BOEnuk përmbushet kriteri në lidhje me disponimin e licencave sipas përqindjes së punimeve të marra përsipër, kjo pasi sipas kontratës së bashkëpunimit të përkohshëm mes shoqërive me nr. 5428 rep. 1206 kol., datë 15.09.2021, nga ana e OE I... K... janë marrë përsipër të kryhen 95 % e punimeve nën kategorinë e licencës NS-19 *Sisteme kundër zhurmës* për të cilën NJP ka përllogaritur shumë prej 121,541,840 lekë. Referuar vlerës përkatëse, OE I... K... i takon një vlerë punimesh prej 115,464,748 lekë ($0.95 \times 121,541,840$), ose kategoria D e licencës NS-19. Në fakt kjo shoqëri disponon kategorinë C të NS-19 e si e tillë kjo kompani nuk përmbush kriterin në lidhje me disponimin e licencës profesionale në raport me punën e marrë përsipër dhe si e tillë duhet të ishte s’kualifikuar.

2. Përmirësimi i sinjalistikës horizontale, vertikale dhe pajisjeve të sigurisë rrugore në akset e Rajonit Verior, Loti 1.

Në përfundim të procedurës së prokurimit është shpallur fitues OE J... me të cilin sipas shkresës me nr. 4122/6 prot., datë 31.05.2022 është lidhur kontrata përkatëse e sipërmarrjes së punimeve me vlerë 217,200,000 lekë me TVSH. Sipas dokumentacionit të ngarkuar në SPE si dhe atij të ndodhur në dosje, OE D... është deklaruar si nënkontraktor në fazën e ofertës me një angazhim në drejtim të realizimit të kontratës prej 40 %. Pas shpalljes fitues, me aktin nr. 3558 rep. 1695 kol., datë 20.05.2022 është lidhur kontrata e sipërmarrjes (Kontratë sipërmarrje për kryerje punimesh) mes OE J... dhe OE D... sipas të cilës palët kanë ndarë mes tyre edhe zërat e punimeve. Nisur nga volumet dhe vlerat përkatëse të punimeve të marra përsipër nga ana e nënkontraktorit të punimeve, rezulton se ky i fundit nuk plotëson kriterin në lidhje me disponimin e licencave sipas zërave respektivë të marrë përsipër në kontratën e sipërmarrjes. Konkretisht OE D... nuk disponon licencën NS-6/D *Sinjalistika rrugore jo ndriçuese*, pasi sipas përqindjes dhe volumeve të marra përsipër rezulton një vlerë në diapazonin e punimeve mes 51,000,000 – 100,000,000 lekë. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020, *“Për prokurimin publik”*, i ndryshuar, Neni 80, *“Parimet e procesit të përzgjedhjes”*, Neni 3 *“Parime të përgjithshme”*, Neni 92, *“Shqyrtimi i Ofertave”*, Pika 3, VKM nr. 285, datë 19.5.2021 *‘Për miratimin e rregullave të prokurimit publik’*, neni 82 *“Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”*, pika 2, Neni 89 *“Nënkontraktimi”*, pika 1 si dhe Rregulloren e Përgjithshme të punës.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet nr. 39 – 64 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

18.1 Rekomandimi: Nga ana e ARRSH të merren masa për kualifikimin e operatorëve të cilët përmbushin plotësisht dhe saktësisht kriteret e vendosura me qëllim shmangien e përdorimit pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet të fondeve.

19. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt *Ndërtim rruga Korçë – Ersekë Loti 2 (pjesa e dytë)*, konstatohet se, me qëllim përmbushjen e kriterëve të vendosura, nga ana e OE A...K, në zbatim të nenit 73 *Sistemet e Kualifikimit* si dhe nenit 84 *Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera*, është nënshkruar një marrëveshje me datë 08.04.2022 me shoqërinë B...I sipas të cilës OE A...K do të mbështetet në kapacitetin ekonomik dhe financiar të OE B...I pasi ky i fundit ka një xhiro vjetore 2018 – 1,000,278,099 lekë, 2019 – 1,296,437,763 lekë dhe 2020 – 1,254,864,003 lekë. Pra duke qenë se sipas kriterëve të AK xhiro mesatare vjetore e OE duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës, pra sa fondi limit ose shuma 2,165,325,695.08 lekë, dhe OE A...K ka një xhiro vjetore 2018 – 1,536,228,476 lekë, 2019 – 1,370,910,610 lekë dhe 2020 – 1,215,643,833 lekë, atëherë, pjesëmarrësi A...K ka përdorur OE B...I për të përmbushur kriterin e xhiros vjetore të kërkuar. Nga dokumentacioni i ngarkuar në SPE rezulton se OE B...I, tek i cili OE A...K ka deklaruar se do të mbështetet në kapacitetet e tij financiare, nuk është dëshmuar për mbështetje në staf teknik, makineri, pajisje, kryerja zërash punimesh. Referuar kuadrit ligjor e rregullator të Prokurimit Publik, operatorët ekonomikë dëshmojnë për kapacitete dhe aftësi të natyrave të ndryshme, të cilat, për ta konsideruar OE të kualifikuar, këto dëshmi duhet të jenë në përputhje me punët/shërbimet/furnizimet e marra përsipër. Thënë sa më sipër, OE A...K nuk duhet të mbështetet në xhiron vjetore të OE B...I për sa i takon kapaciteteve ekonomiko financiar, pasi vet OE B...I nuk ka marrë përsipër të kryejë punime. Në interpretim të kuadrit ligjor si më sipër, kërkesat e Autoriteteve Kontraktore vendosen më qëllimin e vetëm që të garantohet se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, pra njohjen e gjendjes financiare e cila çon në një konkluzion mbi mundësinë e përmbushjes ose jo me sukses të kontratës. Pra xhiroja vjetore është një tregues për atë OE që e disponon dhe e përdor për atë pjesë të kontratës që merr përsipër apo tek i cili mund të mbështetet OE pjesëmarrës në procedurë. Praktikisht A...K ka marrë përsipër të kryejë të gjitha punimet e kontratës, duke përdorur xhiron mesatare vjetore të një operatori tjetër ekonomik. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 77 *Kërkesat për kualifikim*, pika 1, germa a, b dhe c, pika 3, VKM nr. 285, datë 19.5.2021 ‘Për miratimin e rregullave të prokurimit publik’, neni 43 *Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare*, pika 1, 5 dhe 6.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet nr. 39 – 64 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

19.1 Rekomandimi: Nga ana e ARRSH të merren masa për kualifikimin e operatorëve të cilët përmbushin plotësisht dhe saktësisht kriteret e vendosura me qëllim shmangien e përdorimit pa efektivitet, efizienz dhe ekonomikitet të fondeve.

20. Gjetje nga Auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se me Urdhër nr. 169 datë 06.08.2021 është ngritur Grupi i Punës për hartimin e Termave të Referencës (ToR) për Qendrën e Monitorimit të Trafikut (QMT), nga ana e të cilit janë hartuar këto terma, pjesë e dosjes së procedurës së prokurimit. Këto terma referenca i kanë diktuar firmës sipërmarrëse hartimin e detyrës së projektimit në lidhje me këtë qendër monitorimi. Në fakt, sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se vlera e punimeve në shumën prej 368,102,594.97 lekë me TVSH është caktuar pa një referencë konkrete por vetëm (kjo pavarësisht citimit të preventivit ku është shprehur se vlera krahasuese i është referuar projekt zbatimit të tunelit të Llogorasë, seksioni Elektromekanike) duke përfshirë 4 kategori si më poshtë:

Nr.	Përshkrimi i punimeve	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera
1	Pajisjet E&M, kostot e përgjithshme + Projekt	lump sum	1	34,366,039. ²³	34,366,039. ²³
2	Sistemi i Ventilimit të Tunelit	lump sum	1	90,457,610. ⁷¹	90,457,610. ⁷¹
3	Sistemet mekanike	lump sum	1	24,228,992. ³¹	24,228,992. ³¹
4	Sistemi Elektrik	lump sum	1	157,699,520. ²³	157,699,520. ²³
SHUMA					306,752,162.⁴⁸
TVSH					61,350,432.⁵⁰
TOTAL					368,102,594.⁹⁷

Në këtë rast AK ka përzgjedhur *Kontratë për punë publike* dhe mënyra e prokurimit ka qenë *Punime me matje* dhe jo *Kontratë me çelësa në dorë* e për këtë arsye nuk duhet të ishte përfshirë në këtë kontratë edhe projektimi i kategorive si më sipër nga ana e sipërmarrësit. Sa më sipër është në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 'Për miratimin e rregullave të prokurimit publik', neni 12 Metoda të zbatueshme në përllogaritjen e vlerës së kontratës, pika 4, Neni 13 Studimi paraprak i tregut, Neni 39 Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike, pika 1.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet nr. 39 – 64 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

20.1 Rekomandimi: Nga ana e ARRSH të merren masa, për ato raste në të cilat për reference merren kontratat e mëparshme, që përllogaritja e vlerës së fondit limit të investimeve të kryhet bazuar në zërat konkretë të këtyre praktikave të mëparshme dhe jo në kategori preventivash pasi kategorizimi nuk përshkruan saktë zërat konkretë që përfshin.

Në vijimësi

20.2 Rekomandimi: Nga ana e ARRSH të merren masa për të identifikuar dhe ndjekur saktë rastet në të cilat duhen ndjekur metoda e prokurimit *Punime me matje* apo *Kontratë me çelësa në dorë* me qëllim realizmin e një procedure prokurimi efikase.

Në vijimësi

21. Gjetje nga Auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me procedurën e prokurimit dhe të zbatimit të kontratës me objekt *Plotësimi, rakordimi dhe vazhdimi i punimeve Sheshi Shqiponja – Lumi i Tiranës, Loti 1 dhe QMT*, në përfundim të procedurës është shpallur fitues OE S... me të cilin sipas aktit nr. 9729/7 prot., datë 24.12.2021 është lidhur kontrata përkatëse e punimeve me Titullarin e AK me vlerë të kontratës 2,736,853,766 lekë me TVSH. Nga ana e Titullarit të AK janë caktuar mbikëqyrësit e punimeve z. G. N. me nr. licence MK.2352/1 dhe znj. D. Sh. me nr. licence MK.0910/2. Në fakt rezulton se nga ana e inxhinierëve të caktuar nuk disponohen disa prej kategorive të licencës NP-12 *Punime inxhinierike mjedisore*, NS-5 *Impiante të sinjalistikës ndriçuese të trafikut*, NS-12 *Pajisje termike, teknologjike dhe të kondicionimit*, NS-13 *Pajisje të linjave telefonike dhe telekomunikacionit*, NS-14 *Pajisje të brendshme, elektrike, të telefonisë, radiotelefonike, televizive*, dhe NS-18 *Punime topogjeodezike*. Me shkresën e administruar në ARRSH me nr. 11742/2 prot., datë 30.12.2021 nga ana e sipërmarrësit të punimeve është njoftuar fillimi i punimeve në datën 24.12.2021. Sipas korrespondencave rezulton se në datën 24.12.2021 është bërë akti i dorëzimit të sheshit (i cili ka rezultuar pjesërisht i lirë në momentin e dorëzimit të tij), është mbajtur akti i piketimit të objektit si dhe procesverbali i fillimit të punimeve. Këto tre akte rezultojnë të jenë firmosur nga ana e përfaqësuesit të AK znj. A. S., nga ana e mbikëqyrësit të përkohshëm z. G. N., sipërmarrësi i punimeve z. L. S... si dhe Drejtuesi Teknik i OE S... z. T. B.. Sipas aktit me nr. 769/2 prot., datë 09.03.2022 është lidhur kontrata e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve me OE A... E ... E... me përfaqësues ligjor znj. E. Ç. me vlerë të kontratës 21,600,000 lekë me TVSH. Sipas shkresës nr. 9729/7 prot., datë 28.12.2021 i është dorëzuar nga ana e Drejtorit të Drejtorisë së Ndërtimit dhe

Mirëmbajtjes Plani i Zbatimit të Kontratës Drejtorisë Juridike dhe Përputhshmërisë së Standardeve.

Sipas raporteve mujore të hartuara nga ana e mbikëqyrësit të punimeve rezulton se nga ana e OE S... nuk është angazhuar si drejtues teknik ing. T. B., sipas deklaratës së bërë në zbatim të kërkesës 2.3.7 të DT por është vendosur ing. T. M.. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 87, pika 4.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet nr. 39 – 64 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

21.1 Rekomandimi: Nga ana e ARRSH të merren masa për përzgjedhjen në cilësinë e mbikëqyrësve të përkohshëm të kontratave të punimeve të atyre punonjësve të cilët disponojnë të gjitha kategoritë dhe nivelet e nevojshme të licencave për të realizuar një shërbim efektiv dhe të plotë, në përputhje me nevojat që dikton edhe natyra e investimeve.

Në vijimësi

21.2 Rekomandimi: Nga ana e ARRSH të merren masa për tu siguruar se nga ana e sipërmarrëse janë angazhuar mjete dhe staf sipas deklarimeve të bëra nga ana e OE gjatë fazës së ofertimit. Zëvendësimet e tyre të shoqërohen me dokumentacionin e nevojshëm e të mjaftueshëm justifikues, duke siguruar kështu edhe një gjurmë të mjaftueshme auditimi.

Në vijimësi

22. Gjetje nga Auditimi: Në rregulloren e brendshme të institucionit, rregullat apo proceset kryesore të përfshira janë ndërtuar kryesisht sipas linjave funksionale të përgjegjësive, por ato nuk përshkruajnë me detaje proceset, rrjedhën dhe identifikimin e punës, përgjegjësinë individuale, afatet e kryerjes, vendimmarrjen individuale, dokumentacionin e miratuar, si edhe veprimtaritë e kontrollit të nevojshme.

Nga auditimi ka rezultuar se, me përjashtim të Drejtorisë Planifikimit të Buxhetit dhe Financës, manualet për proceset kryesore në sektorët dhe drejtoritë e ARRSH janë akoma në proces hartimi.

Qeverisja e ARRSH përfaqëson mënyrën me të cilën ajo drejtohet dhe kontrollohet, por nga auditimi rezulton se Grupi i Menaxhimit Strategjik nuk ka funksionuar mjaftueshëm, mungojnë minutat e takimit, vendimet dhe raportet, të cilat duhet t’u vihen në dispozicion stafit menaxhues të njësisë publike.

Regjistri i riskut është rishikuar çdo vit, por nga auditimi formularëve të plotësuar të regjistrit të riskut ka rezultuar se nuk bëhet dallimi i riskut të mbetur nga ai i qenësishmi (i natyrshëm), dhe se menaxhimi i riskut nuk kryhet në mënyrë sistematike, apo periodike gjatë vitit. Gjithashtu, ka rezultuar se regjistri nuk është plotësuar korrekt, p.sh. kur niveli i riskut nuk ndryshon dhe mbetet i lartë nuk kërkohet marrja e masave të kontrollit, apo kur niveli i riskut ulët kërkohet në mënyrë të panevojshme masa të tilla.

Proceset kryesore sipas objektivave, me qëllim adresimin e risqeve, duhet të vendosin “pronarët” e proceseve të punës, dhe jo Drejtorin e Përgjithshëm si “pronar” të tyre.

Topologjia e riskut nuk është e plotë dhe e qartë, risqet e brendshme duhet të lidhen më shumë me planifikimin, proceset operacionale, burimet njerëzore (kapacitetet e nevojshme), anën ligjore të mbikëqytjes (ndarjen e detyrave, caktimin e përgjegjësive për punën e secilit punonjës).

Në rregulloren e brendshme të ARRSH nuk janë përfshirë mjaftueshëm veprimtaritë e kontrolleve parandaluese, për shkak se rregulloret nuk përshkruajnë me detaje proceset. Gjithashtu, veprimtaritë e kontrolleve menaxheriale të pamjaftueshme kanë sjellë mungesën e përgjegjësive të përcaktuara menaxheriale, siç është rasti i mungesës së marrëveshjes në zbatimin e programit “Për transportin rrugor” ndërmjet ARRSH dhe ministrisë përgjegjëse MEI. Për sa më sipër, për pasojë rezulton në një nivel i pamjaftueshëm implementimi i sistemit financiar dhe kontrollit (MFK). Sa më sipër është në kundërshtim me ligji nr. 10 296,

datë 08.07.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, neni 20, pika 2 shkronja c, neni 21 pika 1, neni 27, ligjin nr. 10 164, datë 15.10.2009 “Për Autoritetin Rrugor Shqiptar”, neni 6 pika 2 si dhe me Urdhrin nr. 108, datë 17.11.2016 i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Manuali për MFK”, pika 2.2.6, dhe pika 2.1 “Përgjegjësia menaxheriale”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqet nr. 65 – 68 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

22.1 Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i ARRSH, në cilësinë e nëpunësit autorizues, të marrë të gjitha masat e nevojshme për rishikimin e rregullores së brendshme, në të cilën të përfshihen me detaje proceset kryesore të veprimtarisë së ARRSH dhe me këtë rast, veprimtaritë e domosdoshme parandaluese të kontrollit. Gjithashtu, të marrë të gjitha masat e nevojshme për funksionimin e një sistemi të shëndoshë financiar dhe të kontrollit, duke siguruar menaxhimin sistematik të risqeve që cenojnë veprimtarinë e ARRSH, si edhe funksionimin sistematik dhe të nevojshëm të grupit të menaxhimit strategjik (GMS).

Në vijimësi

22.2 Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i ARRSH, të marrë të gjitha masat e nevojshme për krijimin dhe funksionimin e marrëveshjes me ministrinë e linjës MEI, për administrimin e programit “Transporti Rrugor”, me qëllim përcaktimin e përgjegjësive përkatëse menaxheriale të secilit institucion pjesëmarrës.

Në vijimësi

23. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi rezulton se Njësia e Auditit të Brendshëm nuk funksionon në mënyrë të decentralizuar si një veprimtari e pavarur funksionalisht dhe është pjesë përbërëse e ekzekutivit në formën e sektorit dhe në varësinë e drejtorit të përgjithshëm të ARRSH, i cili miraton planin e angazhimeve të AB. Misioni i AB është të japë siguri të arsyeshme për titullarin e njësisë publike, në mënyrë të pavarur dhe objektive për sistemin e kontrollit të brendshëm. Auditimi i brendshëm, duke qenë një strukturë e varur nga Drejtori i përgjithshëm brenda ekzekutivit të ARRSH nuk arrin të kryejë një aktivitet të pavarur dhe objektiv, që jep siguri dhe këshilla, si dhe për t’i shtuar vlerë operacioneve të njësisë publike. Gjatë angazhimeve për zbatimin e rekomandimeve nuk kemi reagime nga subjekti i audituar. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, neni 4 pika 22, ligji nr. 114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, neni 4 pika 19, si dhe me Urdhrin nr. 108, datë 17.11.2016 të Ministrit të Financave “Manuali për MFK”, pika 2.2.10.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqet nr. 65 – 68 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

23.1 Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i ARRSH, të marrë të gjitha masat e nevojshme për kalimin e auditit të brendshëm jashtë strukturës ekzekutive të ARRSH, me qëllim sigurimin e funksionit të decentralizuar të auditimit të brendshëm, si një veprimtari e pavarur funksionalisht dhe që raporton në mënyrë të drejtpërdrejtë tek Bordi.

Në vijimësi

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1. Gjetje nga Auditimi: Në objektin “Ndërtim Rruga mbikalimi TEG dhe rrugët lidhëse të tij” sipas kontratës të lidhur midis Autoritetit Rrugor Shqiptar dhe OE A... B... me nr. 1130 prot. datë 03.02.2021 në lidhje me zbatimin e punimeve me 1,402,652,826 lekë pa TVSH ose 1,683,183,392 lekë me TVSH me afat përfundimi të punimeve 15 muaj dhe ky afat i ndryshuar me amendimin e kontratës nr. 3091/2 prot. datë 18.03.2022, deri më 02.11.2022, nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion, konkretisht:

- *Projekti fillestar;*
- *Projekti i Zbatimit pjesor (Vizatimet sipas faktit);*
- *Pagesat pjesore nga Situacioni nr. 1 deri Situacioni nr. 4;*

- *Librezat e masave pjesore deri në situacionin përmbledhës nr. 4 ;*
- *Ndryshimet e miratuara me Vendimet e Këshillit Teknik;*
- *Korrespondencat mes Autoritetit Rrugor Shqiptar (ARRSH) dhe Kompanisë konsulente që kryen supervizionimin BOE “P... C...” sh.p.k & E... C... G...” sh.p.k & “E....G” sh.p.k & “I....S” sh.p.k.*

si dhe nga verifikimi i kryer në terren në prezencë të përfaqësuesve shtetërorë të KLSH dhe Konsulentit (supervizori i punimeve) rezultuan se janë përfshirë në librezat e masave volume pune të pakryera në fakt në shumën prej 12,131,741 lekë pa TVSH në 3 zëra punimesh të përshkruara në Akt konstatimin Nr. 21. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, Udhëzimin nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, Pika 8.1, Udhëzimi nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3, Kontratën e shërbimit e lidhur midis ARRSH dhe BOE P... C... & E... C... G... & E....G & I....S me nr. 301/2 prot. datë 03.02.2021 me objekt: “Supervizion Punimesh, Ndërtim Rruga mbikalimi TEG dhe rrugët lidhëse të tij” Neni 7 pika 1 “Detyrimet e Përgjithshme të Kontraktorit”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet nr. 39 – 64 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1 Rekomandimi: ARRSH në bashkëpunim me mbikëqyrësin e punimeve të marrë masa për zbritjen e punimeve të certifikuara më tepër dhe rakordimin e tyre, të vlerës **12,131,741 lekë pa TVSH** që përbën dëm ekonomik, në situacionet pasardhës deri në atë përfundimtar, përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve OE A... B... me të cilin është lidhur kontrata nr. 1130 prot., datë 03.02.2021 për zbatimin e punimeve.

Menjëherë

C. MASA PËR ELEMENIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE

1. Gjetje nga Auditimi: Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion për periudhën objekt auditimi, duke ju referuar vendimeve të Gjykatave, ARRSH rezulton të jetë palë debitore në 18 raste me subjekte të ndryshme në vlerën 373,116,044 lekë. Në dy nga këto raste, nga ana e debitorëve është vendosur urdhër sekuestro në llogaritë e Thesarit me vlerën 41,942,661 lekë. Sa më sipër, situata e krijuar lidhur me detyrimet ndaj palëve të treta dhe urdhër sekuestrot e llogarive të Thesarit, rrezikojnë performancën e ARRSH, përmbushjen e funksioneve primare, pagesën e punonjësve e të detyrimeve të tjera, në kushtet e bllokimeve të vazhdueshme të llogarive të saj, gjë e cila mund të rezultojë në pezullim të detyrimeve operacionale.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet nr. 27 – 36 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1 Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm dhe Sektori i Financës të analizojnë efektin financiar negativ me vlerë 373,116,044 lekë, shkaqet të cilat kanë sjellë këtë situatë dhe të marrin masa lidhur likuidimin e këtyre detyrimeve, të cilat sjellin si pasojë sekuestrim të llogarive thesarit të ARRSH.

Menjëherë

2. Gjetje nga Auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet se procedura e largimeve nga puna është e parregullt, konstatim ky i cili mbështetet edhe nga argumentimi si më poshtë. Konkretisht rezulton se në proceset gjyqësore në të cilat ARRSH është palë, për periudhën objekt auditimi janë në proces 7 çështje gjyqësore Gjykatën e Shkallës të Parë Tiranë dhe në Gjykatën e Apelit Tiranë, ku 4 çështje janë humbur dhe 3 janë

në proces. Për periudhën objekt auditimi, lidhur me këto procese ARRSH ka paguar ish – punonjësit e saj në vlerë prej **3,233,034 lekë** si dëmshpërblim për ndërprerje të paligjshme të marrëdhënieve të punës dhe shpenzime përmbarimore, duke shkaktuar kështu efekt financiar negativ. Sa më sipër është në kundërshtim me ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i punës i Republikës të Shqipërisë”, i ndryshuar me ligj nr. 136/2015, datë 05.12.2015, neni 155. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqet nr. 37 – 38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1 Rekomandimi: Nga Drejtori i Përgjithshëm, Drejtoria Juridike dhe Përputhshmërisë së Standardeve dhe Sektori i Burimeve Njerëzore të Autoritetit Rrugor Shqiptar, të merren masa për analizimin e efektit negativ në vlerën **3,233,034 lekë** dhe për ndjekjen me përgjegjësi të procedurave të shkëputjes të marrëdhënieve të punës me punonjësit e saj, dhe të procedurave gjyqësore për dëmshpërblimet që mund të vijnë si rezultat i zgjidhjes së kontratës së punësimit pa shkaqe të arsyeshme, humbje të cilat janë në vlera të konsiderueshme për ARRSH.

Në vijimësi

3. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratës të tipit *Me çelësa në dorë* me objekt *Stabilizimi i qëndrueshmërisë të trupit të rrugës në aksin rrugor Vlorë – Orikum (zona Jonufër – Nimfa)*, të lidhur mes ARRSH si Autoritet Kontraktor dhe BOE G... C... & G... L... sipas shkresës me nr. 5002/8 prot., datë 03.06.2021, rezulton se nga krahasimi i zërave të likuiduar e me ato të situacionuara e të pasqyruara në librezën e masave paraqiten diferenca në volume me pasojë përdorim pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet fondet në shumën prej 10,376,373.5 lekë pa TVSH si rrjedhojë e përdorimit të çmimeve të preventivit të hartuar nga ana e projektuesit mbi ato të parashikuara nga manuali teknik i çmimeve të punimeve të ndërtimit në fuqi dhe/apo punimeve të pakryera në fakt. Gjithashtu, konstatohet se projekti i hartuar nga ana e projektuesit të kontraktuar nga BOE G... C... & G... L... nuk i është referuar parashikimeve ligjore në drejtim të hartimit të preventivit të punimeve. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, neni 5/1, pika 1, pika 3, neni 7/1, neni 12, Udhëzimi nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, pika 8.1, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Udhëzimin nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3 si dhe Kreu II, Pika 3. (Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet nr. 39 – 64 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1 Rekomandimi: Nga ana e ARRSH, në rastet e kontratave të llojit *Me çelësa në dorë*, përpara miratimit të projektit nga ana e institucionit, të merren masat e nevojshme për respektimin, nga ana e projektuesve të të gjitha detyrimeve që parashikon kuadri ligjor e rregullator i projektimit, kjo me qëllim shmangien e përdorimit pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet i fondeve.

Në vijimësi

4. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratës të tipit *Me çelësa në dorë* me objekt *Rrëshqitje e Borshit* Kontratë me çelësa në dorë, të lidhur mes ARRSH si Autoritet Kontraktor dhe OE G... sipas shkresës me nr. 3731/5 prot., datë 28.05.2021, rezulton se nga krahasimi i zërave të likuiduar e me ato të situacionuara e të pasqyruara në librezën e masave paraqiten diferenca në vlerë me pasojë përdorim pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet fondet në shumën prej 82,030,528 lekë pa TVSH si rrjedhojë e çmimeve ndryshe nga sa ka parashikuar manuali teknik i çmimeve të punimeve të ndërtimit në fuqi në momentin e realizimit të kontratës dhe/apo punimeve të pakryera në fakt. Sipas evidencave konstatohet se projekti nuk është i miratuar nga ana e projektuesit C....S pasi nuk është i sigluar dhe nuk ka emrat e hartuesve të tij por vetëm atë të OE G.... Nga një analizë e preventivit të ndodhur në dosje vërehet se zërat janë paraqitur me çmime. Nga krahasimi i preventivit të përdorur nga

ana e punonjësve të ARRSH për përlogaritjen e vlerës së fondit limit dhe atij të hartuar nga ana e sipërmarrësit të punimeve rezulton se dokumenti i parë, i hartuar nga ana e BOE 4...9 & I....S, ka parashikuar volume pune për një gjatësi shkarjeje prej 50 ml dhe dokumenti i dytë për një gjatësi prej 84 ml, por në këtë të fundit një pjesë e volumeve janë në sasi më të vogla duke bërë që nga ana e sipërmarrësit të ofrohet një projekt preventiv me çmime më të larta për njësi duke rritur kështu koston totale. Konkretisht, rezultatet nga auditimi i ndryshimeve të vlerave për çdo kategori punimesh pasqyrohen më të detajuara në Aneksin nr. 3.3.

OE G..., në këtë rast:

1. Nuk ka hartuar projektin sipas parashikimeve dhe deklarimeve të bëra në fazën e zhvillimit të procedurës (hartimin e projektit të zbatimit nga ana e shoqërisë C....S) e duke sigluar një projekt preventiv jo sipër licencave që disponon për projektim punimesh ndërtimi;
2. Nuk ka hartuar projekt-preventivin e punimeve të zbatimit në përputhje me kuadrin ligjor që disiplinon punimet e ndërtimit, këtë përmes heqjes nga preventivi të shumë zërave dhe kalimit të shumës korresponduese në zëra të tjerë me çmime shumë herë më të larta se ato që parashikon VKM përkatëse;

Rezultatet e efektit financiar pasqyrohen në Aneksin nr. 3.4. Ky projekt preventiv i është nënshtruar oponentëve teknikë nga ana e Institutit të Ndërtimit i cila ka kthyer përgjigje sipas shkresës së administruar në ARRSH me nr. 7668 prot., datë 25.08.2021 e më pas projekti ka marrë miratimin përmes VKT nr. 32 me nr. 7668/1 prot., datë 30.08.2021. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 *“Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”*, i ndryshuar, neni 5/1, pika 1, pika 3, neni 7/1, neni 12, Udhëzimi nr. 2, datë 13.05.2005 *“Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”*, Kreu II, pika 8.1, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 *“Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”*, i ndryshuar me Udhëzimin nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënparagrafët 3.2 dhe 3.3 si dhe Kreu II, Pika 3. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet nr. 39 – 64 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1 Rekomandimi: Nga ana e ARRSH, në rastet e kontratave të llojit *Me çelësa në dorë*, përpara miratimit të projektit nga ana e institucionit, të merren masat e nevojshme për respektimin, nga ana e projektuesve të të gjitha detyrimeve që parashikon kuadri ligjor e rregullator i projektimit, kjo me qëllim shmangien e përdorimit pa efektivitet, eficientë dhe ekonomikitet i fondeve.

Në vijimësi

5. Gjetje nga Auditimi: Në objektin *“Rehabilitimi i Segmentit Rrugor Mbikalimi Pallati me Shigjeta – Rreth rrotullimi Shqiponja Loti 1”* sipas kontratës të lidhur midis ARRSH dhe S... & B... N... me nr. 5469/7 prot., datë 22.10.2019 në lidhje me zbatimin e punimeve me vlerë 1,776,111,282 lekë pa TVSH ose 2,129,438,058 lekë me TVSH me afat përfundimi të punimeve 24 muaj dhe ky afat i ndryshuar me amendimin e kontratës nr. 9300/2 prot., datë 15.10.2021, deri më 16.04.2022, nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion, konkretisht:

- *Projekti fillestar; Projekti i Zbatimit pjesor (Vizatimet sipas faktit); Pagesat pjesore nga Situacioni nr. 1 deri Situacioni nr. 16; Librezat e masave pjesore deri në situacionin përmbledhës nr. 16 ; Ndryshimet e miratuara me Vendimet e Këshillit Teknik; Korrespondencat mes ARRSH dhe Kompanisë konsulente që kryen supervizionimin OE A... E... E....*

si dhe nga verifikimi i kryer në terren rezultuan se janë përfshirë në librezat e masave volume pune të pakryera në fakt në vlerën 8,490,090 lekë pa TVSH në 3 zëra punimesh të përshkuara në Akt konstatimin nr. 22. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 *“Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”*, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, Udhëzimin nr. 2, datë 13.05.2005 *“Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”*, Kreu II,

Pika 8.1, Udhëzimi nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3, Kontratën e shërbimit e lidhur midis ARRSH dhe OE A... E... E... me nr. 2128/5 prot., datë 24.06.2019 me objekt: “Supervizion Punimesh, Rehabilitimi i Segmentit Rrugor Mbikalimi Pallati me Shigjeta – Rrethrotullimi Shqiponja Loti 1”, Neni 7 pika 1 “Detyrimet e Përgjithshme të Kontraktorit”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet nr. 39 – 64 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1 Rekomandimi: ARRSH në bashkëpunim me mbikëqyrësin e punimeve, të verifikojnë dokumentacionin e plotë të dosjes teknike si dhe punimet faktike të realizuara në terren për volumet e përmendura, në kontratën e sipërmarrjes së punimeve të lidhur mes BOE “S...” sh.p.k & “B... N...” sh.p.k sipas aktit me nr. 5469/7 prot. datë 22.10.2019, për zbatimin e punimeve civile.

Menjëherë

D. MASA DISIPLINORE

Në mbështetje të shkronjës (c) neni 15 - Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni nr. 37 të Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, i ndryshuar, si dhe Kontratës kolektive për punonjësit e ARRSH, kërkojmë nga Drejtori i Përgjithshëm fillimin e procedurave për dhënie masë disiplinore për punonjësit të cilët janë konstatuar me shkelje nga KLSH në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT